

Përkthyer nga: EULEX0525L

NË GJYKATËN THEMELORE NË PEJË

P.NR. 346/12

DATA: 23 MAJ 2013

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Pejë, në kolegjin penal të përbërë nga Gjyqtari Malcom Simmons si Kryetar i Trupit Gjykes dhe gjyqtarët Darius Sielicki dhe Elmaze Syka si anëtarë të panelit si dhe Proces-mbajtsja Christine Sengl në çështjen penale ndaj;

N.M.;

R.Z.,;

X.Z. dhe

M.N.

të akuzuarë me Aktakuzë të ngritur nga Prokuroria PP.114/12 datë 31 korrik 2012, dhe të konfirmuar me datë 17 shtator 2012, si e ndryshuar me Aktvendim të kësaj Gjykate me datë 04 Dhjetor 2012 sipas së cilës, në pajtim me nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme KPPK), Pikat e Akuzës 3 dhe 4 ndaj R.Z. dhe X.Z. ishin të rënda, me pikat e akuzës si në vijim:

1. N.M.

Pika 1: Në periudhën kohore në mes të qershorit 2010 dhe 27 prillit 2011 në Prishtinë duke vepruar në cilësi të një personi zyrtar si Prokuror Publik i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës- dhe me qëllim të fitimit të paligjshëm material për vetëveten e tij,. X.Z. dhe R.Z. duke kërkuar

shumën prej 50.000 €, ai ka shpërdorur pozitën e tij zyrtare brenda kornizës së hetimit në lëndës nr. 87/10 ku ai kishte zhvilluar hetime ndaj P.M në lidhje me veprat: Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose Autorizimit (neni 339 i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme KPK), veprës Mashtrim sipas nenit (261 të KPK-së) dhe Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare (neni 348 të KPK) supozuar të jenë kryer nga ky i dyshuar në vitin 2006 dhe 2009, ai ka ndërmarrë veprimet në vijim të paligjshëme në këmbim të pagesës nga P.M të shumës së lart-cekur të të hollave: (1) siguroi ndërprerjen e masës së Arrestit Shtëpiak të shqiptuar për P.M.; (2) ofroi ndërprerje të hetimit në lëndën penale nr.PPS 87/10; (3) zbulimit të informacione zyrtare nga hetimi në lëndën numër PPS 87/10 te X.Z. dhe R.Z. duke i'u ndihmuar atyre të tërheqin/pranojnë të holla në shumën prej 30.250 € nga P.M; (4) dhe me kërkesën ë R.Z. dhe X.Z. ai ka lejuar P.M. të lë shtëpinë e tij përkundër faktit se ai ishte nën Arrest Shtëpiak.

Në këtë mënyrë ai ka kryer veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas nenit 339 paragrafi 1 dhe 3 të KPK-së.

Pika 2: Në periudhën kohore para 11 shtatorit 2011 në Prishtinë, duke vepruar në cilësi të personit zyrtar-Prokuror Publik në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës-dhe me qëllim të përfitimit material si të paligjshëm për vetëveten e tij dhe një person tjetër, M.N., ai ka Shpërdorur pozitën e tij zyrtare mbi zbulimin e informacioneve te M.N. nga hetimet në lëndën penale numër PPS 99/10 të zhvilluara ndaj V.L., A.L. dhe L.K. dhe lënda numër PPS.65/10 hetimit të kryer ndaj V.L., A.G. et al dhe që hetimet policore ishin në vazhdim dhe s'shpejti do të inicoheshin zyrtarisht nga Prokurori ndaj këtyre të dyshimëve dhe poashtu arresti i tyre ishte planifikuar; në mënyrë që t'i mundësojë asaj qasje te këta të dyshimtë dhe të bëjë ata të paguajnë një shumë të paspecifikuar të të hollave në këmbim për ndërprerje të hetimeve;

Kështuqë ai ka kryer veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas nenit 339 (1) të KPK-së.

Pika 3: Me 2 prill 2012 në X në shtëpinë e tij, adresa X ai posedonte armë-pistole "Crvena Zastava", modeli M-70, kalibri 7.65 x 17mm pa numër serik, një karikator me plumba 7.65 x 17 mm dhe një plumb të vetëm të revolverit 7.65 x 17 mm-pa Lejen Valide të Autorizimit të Armës për armën në posedim;

Në këtë mënyrë ai ka kryer veprën penale Mbjajtje në Pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të pautorizuar të armëve, sipas nenit 328 (2) të KPK-së.

2. R.Z.

Pika 1: Në periudhën kohore në mes të qershor 2010 dhe 27 prill 2011 në X dhe X, duke vepruar në bashkë-kryerje R.Z. dhe X.Z. kanë kërkuar nga P.M. një avantazh të padrejtë të shumës prej 50.000€ dhe pastaj kanë pranuar shumën prej 30.250 eurosh nga L.N., (20.000€) P.M. (5,250 euro) dhe G.H. (50.000 euro), në lidhje me shfrytëzimin të ndikimit të tyre të padrejtë mbi vendim-marrjen të një personi zyrtar-Prokuror Publik në Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës N.M., dhe kështuqë ata i ofruan P.M. to veprojë s'bashku me këtë Prokuror me qëllim të: 1) sigurojë ndërprerjen e masës së Arrestit Shtëpiak të shqiptuar ndaj P.M.; 2) të sigurojë ndërprerjen e hetimit në lëndën e evidencuar PPS 87/10; 3) të mundësojë rivendosjen e P.M. në postin e tij të mëparshme të punës *Likuidator* në X. dhe 4) të lejojë P.M. të lë shtëpinë e tij përkundër faktit se ai ishte nën Arrest Shtëpiak.

Në lidhje me këtë ai ka kryer vepër penale të Ushtrimit të Ndikimit sipas nenit 345 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Pika 2: Në periudhën kohore në mes të qershor 2010 dhe 27 prill 2011 në X dhe X, duke vepruar në bashkë-kryerje me R.Z. dhe X.Z. me dashje nxitën personin tjetër, Prokurorin Publik të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës N.M. të kryejë veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit në atë mënyrë që duke vepruar me qëllim të përfitimit të paligjshëm material për vetëveten e tij dhe X.Z. dhe R.Z. duke i kërkuar shumën e të hollave prej 50.000 eurosh, ka shpërdorur pozitën e tij zyrtare dhe atë në kuadër të kornizës së hetimit të rastit numer PPS 87/10 hetimit që ai kishte kryer kundër P.M. në lidhje me veprat penale : Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose Autorizimit (neni 339 të KPK-së), Mashtrim (neni 261 KPK) dhe Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare (neni 348 KPK) gjoja të kryera nga ky i dyshimt në vitin 2006 dhe 2009, ai ka ndër marr veprime të paligjshme në vazhdim të shkëmbim për pagesën nga P.M. të shumës së alrt-

cekur të të hollave: (1) siguroi ndërprerjen e masës së Arrestit Shtëpiak të shqiptuar ndaj P.M.; propozoi ndërprerjen e hetimit në lëndën penale numër PPS 87/10; (3) ka zbuluar informacione zyrtare nga hetimit i ratit numër PPS 87 /10 te R.Z. dhe X.Z. duke i'u mundësuar atyre të marrin nga P.M. shumën në të holla prej 30.250 euro; (4) ka lejuar P.M. të largohet nga shtëpia e tij përkundër faktit se ai ishte nën masën e Arrestit Shtëpiak;

Kështuqë ai ka kryer veprë penale të Nxitje të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas nenit 339 (10 dhe (3) lidhur me nenet 23 dhe 24 të KPK-së.

3. X.Z.

Pika 1: Në periudhën kohore në mes të qershorit 2010 dhe 27 prill 2011 në Prishtinë dhe Gjakovë, duke vepruar në bashkë-kryerje me R.Z. dhe X.Z. kanë kërkuar nga P.M. një avantazh të paligjshëm të shumës në të holla prej 50.000 euro dhe pastaj kanë pranuar shumën prej 30.250 euro nga L.N. (20.000€), P.M. (5.250 euro) dhe G.H. (5.000€), në lidhje me ushtrimin e ndikimit të tyre të padrejtë mbi vendim-marrjen të një personi zyrtar Prokuror Publik i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës N.M., dhe kështuqë ata i propozuan P.M. të ndërlidhet me këtë Prokuror me qëllim të; (1) sigurojë ndërprerjen e masës së Arrestit Shtëpiak mbi P.M.; (2) sigurojë ndërprerjen e hetimit në rastin numër PPS 87/10: (3) të mundësojë rivendosjen e P.M. në postin e tij të mëparshëm si *Likuidator* në X. dhe (4) të lejojë P.M. të largohet nga shtëpia e tij përkundër faktit se ai ishte nën masën e Arrestit Shtëpiak;

Në këtë mënyrë ai ka kryer veprën penale të Ushtrimit të Ndikimit sipas nenit 345 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Pika 2: Në periudhën kohore nga mesi i qershorit 2010 dhe 27 prill 2012 në X dhe X, duke vepruar në bashkë-kryerje R.Z. dhe X.Z. me dashje kanë shtyrë personin tjetër, Prokurorin Publik të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës N.M. të kryejë veprën penale Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit duke vepruar me qëllim të përfitimit material të paligjshëm për vetëveten e tij si dhe R.Z. dhe X.Z. R.Z. duke kërkuar shumën në të holla prej 50.000 euro, ka shpërdorur pozitën e tij zyrtare në atë brenda kornizës së hetimit në lëndën numër PPS 87/10 të cilën ai e kishte kryer ndaj P.M. në lidhje me veprat penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit (neni 339 KPK), Mashtrim (neni 261 KPK) dhe

Falsifikim të Dokumenteve Zyrtare (neni 348 KPK) gjoja të kryera nga ky i dyshimt gjatë vitit 2006 dhe 2009, ai ndërmerri veprimet e metutjeshme të paligjshme në këmbim për pagesën nga P.M. për shumën e lart-cekur të të hollave: (1) siguroi ndërprerjen e masës së Arrestit Shtëpiak të shqiptuar ndaj P.M.; (2) ofroi ndërprerje të hetimit të rastit numër PPS 87/10; (3) zbuloi informacione zyrtare nga hetimi në lëndën numër PPS 87/10 tek R.Z. dhe X.Z. duke i mundësuar atyre rrëmbimin/tërheqjen e shumës së të hollave prej 30.250 euro nga P.M. dhe (4) lejoi P.M. të largohet nga shtëpia e tij përkundër faktit që ai ishte nën masën e Arrestit Shtëpiak;

Në këtë mënyrë ai ka kryer vepër penale të Nxitjes në Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas nenit 339 (1) dhe (3) lidhur me nenet 23 dhe 24 të KPK-së.

4. M.N.

Pika 1: Me 11 shtator 2011 në Hotel X., me dashje ka asistuar personin tjetër - Prokurorin Publik të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) N.M. - të kryejë vepër penale Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit në atë që ajo e para të sigurojë nga N.M. informacionin për hetimet në lëndën penale PPS.99/10 të zhvilluar ndaj V.L., A.L., L.K. dhe për lëndën numër PPS.65/10 të kryer ndaj V.L., A.G. ET ALIA, derisa hetimet vazhdonin, dhe s' shpejti the zyrtarisht do të inicioheshin nga Prokurori ndaj tyre dhe që arresti i tyre ishte planifikuar, pastaj ajo ka shkëmbyer këtë informacion te V.L. dhe i tha atij se hetimet do të ndërpreheshin nëse të gjithë të dyshimtit do të të shkonin me atë në Zvicër dhe të i rregullojnë pagesat të ndonjë shume të paspecifikuar të të hollave për atë dhe N.M.;

Kështuqë ajo ka kryer vepër penale të Ndimeses në Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas nenit 339 (1) lidhur me nenin 25 të KPK-së.

Pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore publike të datave 03, 04, 05, 12 dhe 13 dhjetor 2012, te datave 8, 9, 10, 15, 16 dhe 17 Janar 2013, 12, 13, 14, dhe 19 shkurt 2013, 11, 13 dhe 18 mars 2013, 03 prill 2013 dhe 16, 17 dhe 23 maj 2013 në të cilat Prokurori C.M. përfaqësoi prokurorinë, pala e dëmtuar P.M. dhe V.L. për më tepër ose ishin të pranishëm apo të ftuar sipas ftesave të gjyqit, avoakti B.T. u paraqit në anën e N.M., Z.B. për R.Z. dhe K.S. për X.Z. si dhe H.M. u paraqit në anën e M.N. në të cilat seanca ishin të pranishëm të gjithë

të pandehurit gjatë shqyrtimit, pas shqyrtimit dhe votimit me 16 dhe 23 2013 dhe shpalli/njoftoi në publik si në vijim:

AKTGJYKIMIN

1. N.M.

Sipas Pikës 1:

Është

FAJTOR

Sepse

Në mes të qershorit 2010 dhe 27 prill 2011 në Prishtinë , N.M., përgjatë gjithë kohës materiale si Prokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës derisa vepronte në cilësi të një personi zyrtar, në lëndën penale PPS 87/10 një hetim përfshirë P.M., ai ka shfrytzuar përparësinë e pozitës së tij zyrtare dhe autorizimit dhe në këtë mënyrë ka tejkaluar kufijtë e kompetencës së tij, me qëllim të përfitimit të paligjshëm material në shumën prej 50.000 euro për vetëveten e tij dhe R.Z. e X.Z. R.Z. i propozuan/ofruan ndërprerje të hetimit në lëndën numër PPS 87/10 ndaj P.M., siguruan ndërprerjen të Arrestit Shtëpiak të shqiptuar ndaj P.M. si dhe zbuloi informacione konfidenciale nga shkresat e lëndës PPS 87/10 tek R.Z. dhe X.Z. duke i mundësuar R.Z. dhe X.Z. të tërheqin nga P.M. përfitim material në shumën prej 30.250 euro në këtë drejtim nga i cili ai tutje shpërdoroi

pozitën e tij zyrtare duke lejuar P.M. të largohet nga vendbanimi në të cilin kishte qenë duke jetuar sipas kushteve të dhëna/detyruara me Aktvendim për Arrest Shtëpiak, në thyerje të kushteve të atij Aktvendimi.

Në këtë mënyrë kryen vepër penale Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas nenit 339 (2) KPK dhe nenit 422 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK¹)

Sipas Pikës 2.

Është

FAJTOR

Sepse

Para 11 shatorit 2011 N.M. përgjatë gjithë kohës si Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës duke vepruar në cilësi të një personi zyrtar, me qëllim të përfitimit material të paligjshëm për vetëveten e tij ka keqpërdorur pozitën zyrtare dhe autoritetit duke zbuluar te M.N. informacione zyrtare nga shkresat e lëndës numër PPS 99/10, në hetimin ku ishin të përfshirë V.L., A.L. dhe L.K. dhe pastaj më tutje zbuloi informata zyrtare të M.N. nga shkresat e lëndës numër PPS 65/10, një hetim ku ishin të përfshirë V.L. dhe A.G., me qëllim që M.N. do të i kontaktojë të dyshimtit në këto hetime, mbi të cilat ajo kontaktoi V.L. dhe me udhëzimet e tij propozoi ndërprerjen e hetimeve në këmbim për ata të paguajnë një shumë të paspecifikuar dhe të papërcaktuar të parave.

Në këtë mënyrë ai ka kryer vepër penale Shpërdorim të Pozitës Zyrtare apo Autoritetit sipas nenit 339 (1) të KPK-së dhe nenit 340 (2) të KPRK-së.

Sipas Pikës 3

Është

¹ Ligji numër 04/L-082 në fuqi nga 01 janar 2013

FAJTOR

Ngase për afërsisht rreth orës 06 pasdite me 02 prill 2012 në shtëpinë e tij në X adresa X, ai paligjshëm mban posedon pistole "Crvena Zastava", modeli M-70 të Kalibrit 7.65 x 17mm kalibri pa numër serik, një karikator me 8 fishekë të kalibrit 7.65 x 17 mm kaliber për të cilën armë ai nuk posedon Kartën Valide të Autorizimit siç kërkohet me ligj². Në këtë mënyrë ai ka kryer vepër penale **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** nenit 328 (2) dhe nenit 374 (1) të KPRK-së.

2. R.Z.

Sipas Pikës 1.

Është

FAJTOR

Ngase

Në periudhën në mes të qershor 2010 dhe 27 prill 2011 në X. dhe X., R.Z. duke vepruar në bashkë-kryerje me X.Z. R.Z. kanë kërkuar nga P.M. një shumë të padrejtë avantazh/epërsi të të hollave prej 50.000 euro dhe kanë pranuar përfitimin material në shumën totale prej 30.250 euro në arritjen e kompromisit me pagesën nga 20.000 euro prej L.N., 3,000 euro nga P.M., 5,000 euro nga G.H. dhe nga P.M. një shumë një shumë të kosiderueshme të miellit që realizon një vlerë të shitjes me pakicë në 2,350 euro, të gjitha në konsiderim në lidhje me detyrimin në ushtrimin e ndikimit të padrejtë nga R.Z. dhe X.Z. mbi vendimmarrjen e N.M., Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe një personi zyrtar, me qëllim të realizimit në emër të P.M. ndërprerjen e Arrestit Shtëpiak të P.M. masë e cila i ishte caktuar nga Gjykata ndaj P.M. sikurse edhe ndërprejen e hetimit ndaj P.M. në lëndën penale 87/10; si dhe ri-vendosjen/kthimin e P.M. në postin e tij paraprak si *Likuidator* na X., dhe më tutje të lejojë P.M. të largohet nga vendbanimi adresa e cila është e dhënë me kushtet e caktuara me Aktvendim për masën e Arrestit Shtëpiak.

² Ligji Nr.03/ L-143

Kështuqë ai ka kryer veprën penale të Ushtrimit të Ndikimit sipas nenit 345 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe sipas nenit 340 (2) të KPRK.

Sipas Pikës 2.

Është

FAJTOR

Ngase

Në mes të qershor 2010 dhe 27 prill 2011 në Prishtinë dhe Gjakovë R.Z. duke vepruar në bashkë-kryerje me X.Z. R.Z., me dashje kane nxitur/shtytë N.M. - Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe person zyrtar, të kryejë vepër penale Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose Autoritetit meç rast N.M. mori epërsi në pozitën e tij zyrtare dhe autoritetit dhe në këtë mënyrë duke tejkaluar kufijtë e kompetencave të tij e me qëllim të përfitimit material të paligjshëm në shumën e të hollave prej 50.000 euro për vetevetën, R.Z. dhe X.Z., brenda kontekstit të hetimit të tij në lëndën PPS 87/10, ai siguroi ndërprerjen e Arrestit Shtëpiak të caktuar ndaj P.M. duke i ofruar ndërprerje të hetimit të përmendur; zbuloi informacione konfidenciale te R.Z. dhe X.Z. nga shkresat e lëndës dhe në lëtë mënyrë i mundësoi R.Z. dhe X.Z. të marrin nga P.M. një përfitim material të paligjshëm në shumën e të hollave prej 30.250 euro dhe lejun P.M. të largohet nga adresa në të cilën banonte sipas kushteve të imponuara me Aktvendim mbi Arrestin Shtëpiak.

Në këtë mënyrë ai ka kryer veprën penale të Nxitjes së Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas nenit 340 (2) dhe neni 422 (1) lidhur me nent 31 dhe 32 (1) të KPRK-së.

3. X.Z.

Sipas Pikës 1.

Është

FAJTOR

Sepse në qershor 2010 dhe 27 prill 2011 në X. dhe X., X.Z. duke vepruar në bashkë-kryerje me R.Z. R.Z. duke kërkuar nga P.M. një shumë avantazh të të hollave prej 50.000 euro dhe ka përfituar përfitim material në shumën e përgjithshme të të hollave prej 30.250 euro duke bërë kompromis me shumën prej 20.000 euro nga L.N., 3000 euro nga P.M., 5,000 euro nga G.H. dhe nga P.M. një shumë të dukshme të miellit që realizon një vlerë me pakicë prej 2,350 euro, të gjitha marrë parasysht për shfrytëzimin e një ndikimi të padrejtë nga X.Z. dhe R.Z. mbi vendim-marrjen e N.M. -Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe një personi zyrtar, me qëllim të realizimit në emër të P.M. ndërprerjen e tij të Arrestit Shtëpiak masë e cial i ishte caktuar nga Gjykata për P.M. sikurse ndërprerjen e hetimit ndaj P.M. në lëndën penale numër PPS 87/10; dhe ri-vendosjen e P.M. në postin e tij të mëparshëm si *Likuidator* në X, dhe më tutje të lejojë P.M. të lë vendbanimin në të cilin banonte sipas kushteve të të paraqitura me Aktvendim mbi Arrestin Shtëpiak.

Në këtë mënyrë ai ka kryer veprën penale të Ushtrimit të Ndikimit sipas nenit 340 (2) të KPRK-së dhe nenit 345 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Sipas Pikës 2.

Është

FAJTOR

Sepse

Në mes të qershorit 2010 dhe 27 prill 2011 në X. dhe X., X.Z. duke vepruar në bashkë-kryerje me R.Z., me dashje shtytën N.M. -Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe person zyrtar të kryejë veprën Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose Autorizimit përmes së cilës i përmenduri N.M. fitoi përparësi të pozitës zyrtare dhe autoritetit duke i tejkaluar kufijtë e kompetencave me qëllim të përfitimit material të paligjshëm në shumën e të hollave prej 50.000 euro për veten, X.Z. dhe R.Z., ka leqërdorur pozitën e tij zyrtare dhe atë në kontestin e zhvillimit të hetimit të tij në lëndën penale numër PPS 87/10, siguroi ndërprerjen e masës së Arrestit Shtëpiak të caktuar ndaj P.M.; propozoi ndërprerje të

hetimit; zbuloi te X.Z. dhe R.Z. informacione konfidenciale nga shkresat e lëndës dhe në këtë mënyrë mundësoi X.Z. dhe R.Z. t'i tërheqin nga P.M. një përfitim material në shumën prej 30,250 euro dhe lejoi P.M. të largohet nga adresa e vendbanimit në të cilën ai ishte duke banuar sipas kushteve të regjistruara me Aktvendim për masën e Arrestit Shtëpiak.

Në këtë Mënyrë ai ka kryer veprën penale të Shtytjes së Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas nenit 340 (2) dhe nenit 422 (1) të KPRK-së lidhur me nënet 31 dhe 32 (1) të KPRK.

Translation below by: 0369L/Përkthyer më poshtë nga: 0369L

4. M.N.

Nën Pikën 1

është

FAJTORE

Sepse

Më 11 Shtator 2011 në Hotelin X. ajo me dashje i ndihmoi N.M., Prokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për të kryer veprën penale të Shpërdorimit të Detyrës Zyrtare ose Autorizimit të të cekurit N.M., përderisa duke vepruar në cilësinë e personit zyrtar, me dashje për të përfituar në mënyrë të kundërligjshme dobi pasurore për veten, e shpërdori pozitën e tij zyrtare dhe autorizimin duke i zbuluar M.N. informata zyrtare nga shkresat e lëndës PPS 99/10, në hetim që përfshin V.L., A.L.n dhe L.K., dhe, më tej, i zbuloi M.N. informata zyrtare nga shkresat e lëndës me numër PPS 65/10, në hetim që përfshin V.L., A.G. (dhe të tjerët), me ç' rast ai u pajtua me M.N. se ajo do të i kontakton të dyshuarit në atë hetim, dhe, me udhëzimet e tij, të ofrojë përfundimin e hetimeve përkatëse në këmbim të dobisë pasurore, ku ajo pasi që e kontaktoi V.L., një person të cilin e njihte, e njoftoi atë për hetimet dhe e këshilloi që ai dhe të dyshuarit e tjerë të e takojnë atë në Zvicër ku, në këmbim të pagesës të një

shume të pacaktuar dhe të pa specifikuar të parave, N.M. do të i ndërpriste hetimet në fjalë ndaj tyre, duke ia mundësuar N.M. që të kryejë vepër penale.

NË KËTË MËNYRË ajo e kreu veprën penale të Asistencës në Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas Nenit 3 (2) të KPRK-ë dhe Nenit 339 (1) në lidhje me Nenin 25 të KPK-së.

PRANDAJ, me arsyetim të lartpërmendur, Gjykata i shqipton dënimet në vijim:

1. N.M.

Duke qenë i dënuar për veprën penale në fjalë sipas Pikës 1 dënohet me periudhë të burgimi prej 4 (katër) viteve.

Duke qenë i dënuar për veprën penale në fjalë sipas Pikës 2 dënohet me periudhë të burgimit të 1 (një) viti dhe me gjobë të shumës së 10, 000 (dhjetë mijë) Eurove.

Duke qenë i dënuar për veprën penale në fjalë sipas Pikës 3 dënohet me periudhë të burgimit prej 3 muajve.

Në pajtim me Nenin 71 (1) dhe (2) nën-paragrafët (2) dhe (4) të KPP-së, dënimi unik është me 5 (pesë) vite burgim dhe gjobë në shumë të 10, 000 (dhjetë mijë) Euro për t'u paguar brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

2. R.Z.

Duke qenë i dënuar për veprën penale në fjalë sipas Pikës 1 dënohet me periudhë të burgimit të 1 (një) viti dhe 6 (gjashtë) muajve dhe me gjobë në shumë të 10, 000 (dhjetë mijë) Eurove.

Duke qenë i dënuar për veprën penale në fjalë sipas Pikës 2 dënohet me periudhë të burgimit prej 3 (tri) viteve.

Në pajtim me Nenin 71 (1) dhe (2), nën-paragrafët (2) dhe (4) të KPP-së, dënimi unik është me 4 (katër) vite burgim dhe gjobë në shumë të 10, 000 (dhjetë mijë) Euro për t'u paguar brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

3. X.Z.

Duke qenë i dënuar për veprën penale në fjalë sipas Pikës 1 dënohet me periudhë të burgimit të 1 (një) viti dhe 6 (gjashtë) muajve dhe me gjobë në shumë të 10, 000 (dhjetë mijë) Eurove.

Duke qenë i dënuar për veprën penale në fjalë sipas Pikës 2 dënohet me periudhë të burgimit prej 3 (tri) viteve.

Në pajtim me Nenin 71 (1) dhe (2) ,nën-paragrafët (2) dhe (4) të KPK-së, dënimi unik është me 4 (katër) vite burgim dhe gjobë në shumë të 10, 000 (dhjetë mijë) Euro për t'u paguar brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

4. M.N.

Duke qenë e dënuar për veprën penale në fjalë sipas Pikës 1 dënohet me periudhë të Burgimit prej 6 (gjashtë) viteve dhe me gjobë në shumë të 10, 000 (dhjetë mijë) Eurove Euro për t'u paguar brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

Në pajtim me Nenin 73 (1) të KPK-së, periudha e kaluar në paraburgim e N.M. nga 2 Prilli 2012 deri më 19 Shkurt 2013 dhe nga 8 Marsi 2013 deri më 15 Mars 2013, e R.Z. nga 2 Prilli 2012 deri sa Aktgjykimi të merr formën e prerë dhe X.Z. nga 3 Prilli 2012 deri sa Aktgjykimi të merr formën e prerë do të llogaritet kundër dënimit.

Në pajtim me Nenin 56 (2) të KPK-së, N.M. i ndaloheq që të e ushtrojë ndonjë administrim publik ose detyrë të shërbimit publik për periudhë kohore të tre viteve pas periudhës së shqiptuar të burgimit, pasi që të i ketë shërbyer.

Në pajtim me Nenin 69 (3) dhe Nenin 374 (3) të KPRK-së, revolja "Crvena Zastava", e modelit M-70, kalibrit 7.65x17mm pa numër serik, një karikatorë me 8 plumba 7.65x17mm dhe një armë e vetme revoleje 7.65x17mm e gjetur në posedim të N.M. do të i konfiskohet menjëherë.

Në pajtim me Nenin 493 të KPPK-së, pika 1 (një) deri tek 14 (katërbëdhjetë) dhe 24 (njëzet e katër) gjithëpërfshirëse të cilat u konfiskuan gjatë bastisjes së shtëpive të R.Z. dhe X.Z. më 2 Prill 2012 mund të zbatohen për të e plotësuar dobinë pasurore të kundërligjshme që R.Z. dhe X.Z. e kishin grumbulluar.

Në pajtim me Nenin 102 (1) të KPPK-së, të pandehurit do të i paguajnë shpenzimet e procedurës në shumën e cila do të përcaktohet nga Gjykata me një Aktvendim të posaçëm.

Palët e dëmtuara mund të paraqesin ndonjë kërkesë për kompensim përmes Gjykatave civile.

ARSYETIMI

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	XX
	Kodi Penal në	
	Fuqi	XX
	Kodi i Procedurës Penale në	
	Fuqi	XX
	Kompetenca	XX
II.	AKTAKUZA	XX
	Ndryshimi i	
	Aktakuzës	XX
	Aktakuza e	
	Ndryshuar	XX
	Akuzat	XX
III.	MARRJET PARASYSH LIDHUR ME VLERËSIMIN E PROVAVE	XX
	Barra e	
	provave	XX
	Provat e Dëshmitarit	
	Bashkëpunues	XX
IV.	SHQYRTIMI	
	GJYQËSOR	XX
	Rasti i	
	P.M.	XX

	Rasti	i	V.L.	et	
	al.....				XX
	Te				
	Pandehurit.....				XX
V.	VLERËSIMIN				I
	PROVAVE.....				XX
	Te				
	Pandehurit.....				XX
	Provat				
	Telefonike.....				XX
	Komentet				
	Hyrëse.....				XX
	Rasti			i	
	P.M.....				XX
	Rasti	i	V.L.	et	
	al.....				XX
VI.	GJETJET	MBI	PËRGJEGJËSINË	E	TË
	AKUZUARIT.....				XX
	N.M.....				XXX
	R.Z.....				XXX
	X.Z.....				XXX
	M.N.....				XXX
VII.	DËNIMI.....				XXX
XI.	PËRJASHTIMI				NGA
	ZYRA.....				XXX
XII.			KONFISKIMI		I
	ASETEVE.....				XXX

XIII. KONFISKIMI I ARMËVE TË
ZJARRIT.....XXX

XIV. SHPENZIMET E PROCEDURËS
PENALE.....XXX

XV. PALËT E DËMTUARA
.....XXX

MJETI
LIGJOR.....XXX

SHTOJCA I Dëshmitarët të cilët i dhanë dëshmitë në Gjykatë

SHTOJCA II Provat e parashtruara nga Palët

Shtojcat e këtij dokumenti e përmbajnë pjesën përbërëse të këtij Aktgjykimi.

I. Hyrje

i. Kodi Penal në Fuqi

Neni 3 (2) i Kodit Penal të Republikës së Kosovës parasheh se në rastet e ndryshimit të ligjit në fuqi në një rast të caktuar para vendimit përfundimtar, duhet të zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin.

ii. Kodi i Procedurës Penale në Fuqi

Në seancën më 7 Janar 2013, Gjykata Supreme e Kosovës e lëshoi një Mendim³ Ligjor ku ceku se në të gjitha procedurat penale në të cilën shqyrtimi gjyqësor kishte filluar para se të hyjë në fuqi Kodi i Procedurës Penale i ri, do të zbatohet Kodi i Procedurës Penale i vjetër. Ky qëndrim ishte konfirmuar në Ndryshimin e Mendimit⁴ të datës 23 Janar 2013.

iii. Kompetenca e Gjykatës dhe e Trupit Gjygues

³ 93/2013.

⁴ 56/2013.

Në pajtim me Nenin 23 (1) të KPPK-së, Gjykatat e Qarkut kanë kompetencë për të i gjykuar në shkallën e parë veprat penale të dënueshme me burgim së paku me pesë vite ose të atyre të dënueshme me burgim Afatgjatë.

Në rastin aktual të pandehurit ishin akuzuar me veprat të cilat përfshinin Shpërdorimin e Pozitës Zyrtare në kundërshtim me Nenin 339, paragrafin 3 të KPK-së, vepër e dënueshme me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vite.

Sipas Aktakuzës veprat penale ishin kryer brenda kompetencës të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Asnjë çështje nuk ishte ngritur nga ana e Palëve në fillim të shqyrtimit gjyqësor lidhur me kompetencën e kësaj Gjykate.

Më 3 Janar 2012, Kryetari i Asamblesë të Gjyqtarëve të EULEX-it, në pajtim me Nenin 3 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it (Ligji nr. 03/L053), i lëshuar me Aktvendim për të e marrë sipër lëndën.

Me arsye, Trupi Gjykues i Gjykatës të Qarkut në Peja/Pec ishte përbërë me korrektësi nga një panel i përzier prej dy Gjyqtarëve të EULEX-it dhe një Gjyqtari Vendor, në përputhje me Nenin 4.7 të Ligjit mbi Kompetencat.

Asnjë çështje nuk ishte ngritur nga ana e Palëve në fillim të shqyrtimit gjyqësor lidhur me përbërjen e trupit gjykues. Megjithatë, në fund të shqyrtimit gjyqësor R.Z. dhe X.Z. e parashtruan një kërkesë për përjashtimin e Gjyqtarëve të EULEX-it nga trupi gjykues mbi bazën se Gjyqtarët e EULEX-it nuk kanë kompetencë në Kosovë. Ajo kërkesë u hodh poshtë.

II. AKTAKUZA

i. Ndryshimi i Aktakuzës

Aktakuza ishte ndryshuar me Aktvendim të kësaj Gjykate, me anë të së cilës më 4 Dhjetor 2012 në pajtim me Nenin 34 të KPPK-së, Kryetari i Trupit Gjykues i shkurtoi pikat 3 dhe 4 ndaj R.Z. dhe X.Z.

ii. Aktakuza e Ndryshuar

N.M. ishte akuzuar me tri pikë në Aktakuzën e ndryshuar.

Pika 1: Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas Nenit 339 S 1 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës.

Pika 2: Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas Nenit 339 S 1 të Kodit Penal të Kosovës.

Pika 3: Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Nenit 328 S 2 të Kodit Penal të Kosovës.

R.Z. ishte akuzuar me dy pika në Aktakuzën e ndryshuar.

Pika 1: Ushtrim të Ndikimit sipas nenit 345 S 1 lidhur me Nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës.

Pika 2: Shtytje për Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas Nenit 339 S 1 dhe 3 lidhur me Nenin 23 dhe 24 të Kodit Penal të Kosovës.

X.Z. ishte akuzuar me dy pikat në Aktakuzën e ndryshuar.

Pika 1: Ushtrim të Ndikimit sipas Nenit 345 S 1 lidhur me Nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës.

Pika 2: Shtytje për Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit sipas Nenit 339 S 1 dhe 3 lidhur me Nenin 23 dhe 24 të Kodit Penal të Kosovës.

M.N. ishte akuzuar me një pikë në Aktakuzën e Ndryshuar: Asistencë për të e Shpërdorur Pozitën Zyrtare ose Autorizimin sipas Nenit 339 S 1 lidhur me Nenin 25 të Kodit Penal të Kosovës.

iii. Akuzat

Neni 339

Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose Autorizimit

- (1) Një person zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për veten ose për personin tjetër ose të një organizate biznesi ose për të shkaktuar ndonjë dëm tek personi tjetër ose organizatës të biznesit, e shpërdor pozitën zyrtare të tij ose saj, i tejkalon kufijtë e autorizimeve të tij ose saj ose nuk i zbaton detyrat e tij ose saj zyrtare, do të dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Kur vepra penale e paraparë në paragrafin 1 të Nenit aktual rezulton me një dëm që e tejkalon shumën e 2.500 Euro ose me shkelje të rëndë të të drejtave të ndonjë personi, kryerësi do të dënohet me burgim deri në tri vite.
- (3) Kur vepra penale e paraparë në paragrafin 1 të Nenit aktual rezulton me një përfitim pasuror që e tejkalon shumën prej 5.000 Euro, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në tetë vite.

Neni 345

Ushtrim i Ndikimit

- (1) Kushdo që bën kërkesë, pranon ose merr ndonjë ofertë ose premtim ndonjë përfitim të padrejtë për vete ose ndonjë person tjetër në lidhje me ushtrimin e ndikimit të padrejtë nga ana e kryerësit mbi vendimmarrjen e një personi zyrtar, nëse apo jo ndikimi është ushtruar ose nëse apo jo ndikimi i mbështetur shpjen deri tek rezultati i synuar, do të dënohet me një gjobë ose me burgim deri në dy vite.

Neni 328

Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar i Armëve

(2) Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 EUR ose me burgim prej një deri në tetë vite.

III. MARRJET PARASYSH LIDHUR ME VLERËSIMIN E PROVAVE

i. Barra dhe standardi i provave

Neni 6 (2) i KEDNJ-së e parasheh mundësinë e pafajësisë për të cilën i Akuzuari ka të drejtë. Kjo është e pasqyruar në Nenin 3 (1) të KPPK-së. Kjo mundësi ia vë barrën Prokurorisë për përcaktimin e fajit të të Akuzuarit, barrë e cila mbetet mbi Prokurorinë gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor.

Neni 396 (7) i KPPK-së përcakton se " Gjykata do të shpall qartazi dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara ose të pa vërtetuara, gjithashtu edhe bazat për këtë". Rrjedhimisht, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë lidhur me secilën pikë që iu ngarkohet çdo të Akuzuarit, në qoftë se është plotësuar mbi bazën e provave të tëra, kështu që është e sigurve (theksimi është shtuar) se çdo element i atij krimi është përcaktuar.

Trupi Gjykses në pajtim me Nenin 7 (1), (2) i KPPK-së "...duhet që saktësisht dhe tërësisht të përcaktohen faktet që janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi ligjor" dhe "...e ka për detyrë që me vëmendje të e shqyrtojë dhe maksimalisht me devotshmëri profesionale dhe të i përcaktojë me kujdes të barabartë faktet ndaj të të pandehurve, gjithashtu edhe të atyre që janë...në favor...".

ii. PROVAT E DËSHMITARIT BASHKËPUNUES

Më 1 Qershor 2012 në pajtim me Nenin 300 të KPPK-së, P.M. ishte shpallur si Dëshmitar Bashkëpunues.

Neni 157 (4) i KPPK-së parasheh se "Gjykata nuk ka gjetur ndonjë person fajtor duke u bazuar vetëm mbi provat e dëshmisë të dhënë nga dëshmitari bashkëpunues".

IV. SHQYRTIMI GJYQËSOR

Rasti i P.M.

Dëshmitarët e Fakteve

Prokuroria e ftoi **P.M.** Ai dha deklaratë në Polici më 11 Mars 2011. Ai dha deklaratë të mëtejme më 15 Prill 2011. Ai u mor në pyetje nga Prokurori më 1 Shkurt 2012. Ai u mor në pyetje para Gjyqtarit të Procedurës Paraprake më 22 Maj 2012 kur me një urdhër ishte bërë shpallja e tij si Dëshmitar Bashkëpunues. Ai dëshmoi në këtë Gjykatë më 4, 5, 12 dhe 13 Dhjetor 2012.

Në vitin 2008 ai u caktua Ushtrues i Detyrës së Likuiduesit të Bankës Kreditore. Në vitin 2009 ai u caktua Likuidues i Bankës në fjalë. Ai mbeti në atë detyrë deri më 30 Prill 2010, kur edhe u shkarkua.

Në cilësinë e tij të Likuiduesit të X. të cekur ai i dha dëshmitë në Prokurori në vitin 2010 kundër tetë (8) të pandehurve të cilët ishin anëtarë të bordit të X. Kreditore. Prokurori i atij rasti kishte qenë N.M.

Pas disa muajve nga dhënia e dëshmisë për atë rast, P.M. u ftua në takim në Bankën Qendrore dhe menjëherë u shkarkua. Atij iu tha se vendimi për shkarkimin e tij ishte bërë nga Bordi i X. X. Vendimi ishte nënshkruar nga Guvernatori i X. X., H.R. Ai bëri ankesë ndaj atij vendimi dhe e filloi procedurën në Gjykatën Komunale në duke kërkuar ri-emërimin e tij⁵.

Ai besoi se vendimi për shkarkim ishte lidhur me faktin se ai dha dëshmi në Prokurori në procedurën penale të lartpërmendur.

Ai tha se në Korrik të vitit 2010 kishte qenë duke pirë kafe në një restorant në X., kur e kishte marrë një

⁵ Faqe 18 e Procesverbalit të datës 4 Dhjetor 2012.

thirrje telefonike. Nuk e kishte njohur numrin. Telefonuesi e kishte prezantuar veten si X.Z.

P.M. tha se i njihte R.Z. R.Z. dhe X.Z. qysh para luftës. Në atë kohë ai kishte qenë pronar i kompanisë që bënte biznes me vëllezërit Z. diku rreth një viti. Ai nuk e kishte parë R.Z. R.Z. e as X.Z. R.Z. që nga viti 1999. Duket se në atë kohë raporti i tyre ka qenë i përzemërt, raport biznesi.

Në pjesën më të madhe të provave të tij P.M. iu referua me "Vëllezërit Z." ose "ata". Ai tha se në çdo takim zakonisht ishin të pranishëm që të dytë R.Z. dhe X.Z.. Ai ceku se personi kontaktues i tij zakonisht ishte R.Z. Ai deklaroi se ka pasur disa raste kur ai e kishte kontaktuar ose ai vetë kishte qenë i kontaktuar nga ndonjëri prej vëllezërve, por telefonin pastaj ia kalonin vëllait tjetër. Megjithatë, ai ceku se nëse nuk kishte qenë në mundësi që të bisedojë me R.Z. R.Z. ai në vend të tij do i telefononte X.Z.. Ka qenë edhe vëllai i tretë Z., B.Z., por P.M. rrallë ka pasur ndonjë kontakt me te.

P.M. e konfirmoi se gjatë gjithë kohës së detyrës së tij numri i tij i telefonit ishte X. Ai nuk mundi të e rikujtojë nëse e kishte pasur edhe ndonjë numër tjetër në atë kohë.

Kur ai e dha dëshminë në këtë Gjykatë, tha se nuk mund të i rikujtonte numrat e telefonit as të R.Z. e as të X.Z. Megjithatë, në provat e tij të mëparshme ai e dha numrin e tij të telefonit të shfrytëzuar nga R.Z. X⁶ dhe numrin e telefonit të shfrytëzuar nga X.Z. X⁷.

Ai ceku se X.Z. kishte kërkuar që të takohen. P.M. i kishte thënë X.Z. se kishte qenë duke pirë kafe dhe ju sugjeroi atyre që të iu bashkangjiten. Më pastaj në restorant atij iu bashkangjiten R.Z. dhe X.Z..

Para trupit gjykues më 4 Dhjetor 2012 P.M. dëshmoi se kur ishte takuar me R.Z. R.Z. dhe X.Z. R.Z. ata kishin kërkuar nga ai hua në shumë prej 240, 000 Euro.

⁶ Procesverbali i intervistës me Prokurorin më 1 Shkurt 2013.

⁷ Do.

Ata kishin thënë se donin të e ndërtonin një fabrikë për mbushjen e shisheve. P.M. iu kishte thënë atyre se ishte i papunë dhe se nuk do të mund të iu ndihmonte. Në përgjigje të kësaj, ata i thanë P.M. se është parashtruar një padi ndaj tij dhe se " *Ne e kemi një person që ka kompetencë, një mik i yni dhe se ti duhet të bashkëpunosh me atë person dhe të shikosh sesi do të kishe mundur të ndihmoje rreth huas, por gjithashtu edhe në lidhje me ndonjë bashkëpunim të cilin ai person do e kërkonte nga ti*".

Ai deklaroi se R.Z. dhe X.Z. e kanë pyetur atë për ish Guvernatorin e X. Ata i thanë atij se miku i tyre do të mund të i ndihmonte në ri-emërimin e tij në detyrë të Likuiduesit të X. Megjithatë, P.M. dëshmoi se vëllezërit Z. nuk kishin treguar se kush kishte qenë ai mik në takimin e parë ose çfarë lloj ndihme ky person kishte kërkuar.

Ishte dëshmia e P.M. tek trupi gjykues se disa ditë pas këtij takimi të parë ai e kishte pranuar një thirrje telefonike nga R.Z. i cili kishte kërkuar që të takoheshin përsëri.

P.M. dëshmoi pas takimit me R.Z. dhe R.Z. Kur ai u mor në pyetje nga Prokurori më 2 Shkurt 2012, P.M. deklaroi se ai takim që mbajtur dy ditë pas atij takimi të parë, por dëshmia e tij tek trupi gjykues ishte se takimi ishte mbajtur dy deri në katër ditë më vonë. Vëllezërit Z. i thanë atij se kishin biseduar me mikun e tyre i cili e kishte konfirmuar se ai do të i ndihmonte P.M., por në këmbim të kësaj ai duhet që të i ndihmonte mikut të tyre lidhur me një rast. Ata e përshkruan mikun e tyre si " *person shumë të fuqishëm*". Ata gjithashtu i thanë atij se një Kallëzim Penal do të parashtrohet kundër tij që përmban pretendime se ai kishte pranuar dobi pasurore të kundërligjshme në shumë përafërsisht të 200, 000 Euro. R.Z. dhe X.Z. thanë se miku i tyre " *do të të ndihmon*". P.M. dëshmoi në këtë Gjykatë se vëllezërit Z. i kishin thënë atij se mikut tek i cili ata iu referuan ishte Prokurori Special N.M. Ata i sugjeruan që të takohen me N.M.. P.M. dëshmoi se e njoftoi R.Z. dhe X.Z. R.Z. se ai nuk mendonte se do të mund të i ndihmonte Prokurorit

Special, por ai do të e takojë atë pasi që i është kërkuar nga ai.

P.M. e dha dëshminë se kjo kishte qenë hera e parë që kishte pasur dijeni për një hetim që zhvillohej ndaj tij.

Kur u mor në pyetje nga Prokurori më 1 Shkurt 2012, P.M. dëshmoi se përafërsisht dy ditë pas këtij takimi të dytë me R.Z. dhe X.Z. kur ata diskutuan për një takim të mundshëm me N.M., ai e kishte marrë një thirrje telefonike nga R.Z. i cili i kishte thënë atij
" Prokurori gjithashtu është i kanosur dhe se ai askund nuk lëviz pa mbrojtje të afërt, ai nuk ka mundësi që të ju takon jashtë zyrës së tij, por ju duheni të shkoni tek zyra e tij"⁸.

Disa ditë pas bisedës telefonike ai e kishte pranuar një thirrje telefonike nga një person i cili e prezantoi veten si sekretar i N.M., i cili e kishte ftuar atë në një takim me Prokurorin. Ai nuk kishte pranuar ftesë zyrtare që të merr pjesë në zyrën e Prokurorit.

Në dëshminë e tij dhënë tek trupi gjykues, P.M. ceku se më pastaj ai kishte biseduar me telefon me R.Z. dhe e kishte njoftuar atë rreth takimit të propozuar me Prokurorin në ditën e nesërme. Ai tha se kishte biseduar me R.Z., por ai kishte pasur përshtypje se X.Z. gjithashtu kishte qenë i pranishëm dhe se ai në fakt i kishte njoftuar që të dy vëllezërit Z.

P.M. ishte i pranishëm në zyrat e Prokurorit Special në orën 09:58 më 8 Shtator 2010⁹.

Sekretari e dërgoi atë tek zyra e N.M. ku ai ishte duke e pritur atë. Ai priti diku rreth 15 minuta para se të arrinte N.M. së bashku me Policin Hetues Z.I. Që të tretë qëndruan në zyrë.

Ishte dëshmia e P.M. se gjatë takimit N.M. i kishte thënë atij se kishte nevojë për ndihmë në rastin e tyre kundër ish Guvernatorit të X. N.M. i kishte thënë atij se në këmbim të kësaj ndihme ai do të ri-emërohet në detyrën e tij të mëparshme si Likuidues i X.

⁸ Faqe 22 e Procesverbalit të datës 4 Dhjetor 2012.

⁹ Faqet 795 deri 814 nga dosja e shqyrtimit gjyqësor.

P.M. në përgjigje ceku se ai nuk hezitonte që të ndihmonte, por ai nuk kishte pasur ndonjë informatë përkatëse dhe se nuk ishte i gatshëm që të jep dëshmi të rreme kundër ish Guvernatorit.

N.M. iu përgjigj atij me "Në rregull, por mos harro se një kallëzim penal do të parashtrohet kundër teje".¹⁰

P.M. ceku se nuk kishte frikë nga kjo pasi që ai nuk kishte bërë ndonjë gjë të gabuar dhe se nuk kishte asgjë çfarë të fshihte. N.M. i tha P.M. që "të mendojë rreth kësaj"¹¹. Atij i ishte thënë se pas pak do të kërkojnë nga ai që të kthehet në zyrën e Prokurorit.

P.M. dëshmoi se gjatë takimit të tij me N.M. nuk ishin mbajtur shënimet dhe se nuk i kishin kërkuar që të nënshkruan ndonjë dokument. Ai mendoi se takimi kishte zgjatur rreth 20 minuta. Kjo përputhet me evidentimin e hyrjes dhe daljes nga objekti. Të dhënat e sigurimit regjistruan se ai ishte larguar nga zyrat e PSRK-së në orën 10:50¹².

Gjatë takimit të parë me sa duket asnjë referim nuk ishte bërë nga ana e N.M. e as nga vëllezërit Z..

Me largimin nga Zyra e Prokurorit, P.M. përsëri e ftoi R.Z. për të iu treguar atyre se çfarë kishte ndodhur.

Gjatë asaj bisede, R.Z. tha: "A nuk ju thamë se do të bëhej mirë".¹³

Në dëshminë e tij, P.M. ka thënë se disa ditë në vonë, ai e ka pranuar edhe një telefonatë nga sekretarja e N.M., e cila ka kërkuar nga ai që të paraqitej në prokurori për të dytën herë. Përsëri, ai nuk ka marrë thirrje zyrtare për t'u paraqitur.

P.M. është paraqitur në zyrat e Prokurorisë Speciale më 15 shtator 2010, në orën 09:42. Ai është larguar nga Prokuroria në orën 11:50¹⁴.

¹⁰ Faqe 23 e Procesverbalit të 4 Dhjetorit 2012.

¹¹ Do.

¹² Faqet 795-814 nga dosja e shqyrtimit gjyqësor.

¹³ Faqja 25 e procesverbalit të datës 4 dhjetor 2013.

Në dëshminë e tij, ai ka thënë se, posa ka hyrë në prokurori, ai e ka parë N.M. duke shtypur në kompjuter. Ai ka qenë i vetëm. N.M. pastaj e ka marrë një dokument nga printeri i tij dhe ia ka dorëzuar P.M.. Ai i ka thënë se ishte një listë e personave që duhej të arrestoheshin në rastin e X. P.M. e ka parë se emri i tij ka qenë në listë.

N.M. i ka thënë P.M. se edhe ai qe dashur të arrestohej, por se nuk e kishte bërë këtë *"për shkak të miqve tanë të përbashkët"*¹⁵

Në dëshminë e tij, P.M. ka thënë se, gjatë atij takimi, N.M. e ka pyetur P.M. se a kishte menduar më për rastin kundër guvernatorit të X. X.. P.M. ka thënë se nuk ka pasur dëshmi për të dhënë dhe që, sipas mendimit të tij, do t'i ndihmonin prokurorisë. Në përgjigjen e tij, ai ka thënë se N.M. i ka thënë atij se ai e kishte marrë një kallëzim penal që e implikonte P.M. në një vepër penale. Ai i ka thënë se vetëm ia kishte hedhur një sy atij kallëzimi. Ai i ka thënë P.M. se ai do të duhej *"të vazhdonte t'u ndihmonte dhe asistonte miqve tanë, vëllezërve Z., dhe se gjithçka do të bëhej mirë"*¹⁶. Gjatë atij takimi, ata kanë qenë të vetëm në zyrë. Më vonë atyre u është bashkëngjitur shkurtimisht Z.I..

Pas takimit të dytë me N.M., P.M. e ka thirrur R.Z. në telefon dhe e ka informuar se ishte larguar nga prokuroria. R.Z. ka thënë: *"Shumë mirë. Do të shihemi"*¹⁷.

Një ditë apo dy më vonë, P.M. është takuar me R.Z. dhe X.Z. në X. Gjatë atij takimi, R.Z. dhe X.Z. ia kanë kërkuar P.M. 50,000 euro që hetimi kundër tij të pushohej dhe që ai të kthehej në pozitën e tij të mëparshme si likuidator i X.X.

¹⁴ Faqja 739 e procesverbalit së shqyrtimit gjyqësor.

¹⁵ Faqja 25 e procesverbalit të datës 4 dhjetor 2012.

¹⁶ Faqja 26 e procesverbalit të datës 4 dhjetor 2012.

¹⁷ Faqja 29 e procesverbalit të datës 4 dhjetor 2012.

R.Z. dhe X.Z. kanë thënë se shuma prej 50,000 eurove do t'i jepej N.M.. Ata kanë thënë se N.M. i duheshin paratë për ta dërguar djalin e tij për mjekim jashtë vendit.

Duke iu referuar gjendjes shëndetësore të djalit të N.M., ata i kanë thënë P.M.: *"Ai bërtet shumë kur qëndron ulur në tavolinë dhe flakë tutje çfarë t'i bie në dorë pa kurrfarë kontrolli"*¹⁸

P.M. i ka pyetur vëllezërit Z. se si mund të riemërohej në postin e tij të mëparshëm si likuidator? Vëllezërit Z. i kanë thënë se të gjithë personat kyçë në rastin e X. X., përfshirë N.K., Zevendësguvernatorin e X., do të thirreshin për t'u paraqitur para prokurorit pas pak kohësh. Ai ka thënë se prokurori do t'i kishte të gjithë ata "në dorë".¹⁹

P.M. i ka thënë R.Z. dhe X.Z. se ai nuk mund ta ndihmonte prokurorin, sepse nuk kishte prova që do të mund t'i ndihmonin atij. Ai ka thënë se, megjithatë, ka qenë i interesuar që të riemërohej në postin e tij të mëparshëm si likuidator i X..

Në dëshminë e tij, P.M. ka thënë se ua ka ofruar vëllezërve Z. 20,000 euro. Shuma prej 27,000 eurosh ceket në procesverbalin e marrjes së tij në pyetje më 1 shkurt të vitit 2012²⁰. Duke iu drejtuar vëllezërve Z., P.M. ka thënë *"për ta nuk kishte asgjë"*.²¹

¹⁸ Faqja 29 e procesverbalit të datës 4 dhjetor 2012.

¹⁹ Faqja 27 e versionit në gjuhën angleze.

²⁰ Faqja 11 e versionit në gjuhën angleze.

²¹ Faqja 22 e versionit në gjuhën angleze të procesverbalit të marrjes në pyetje të prokurorit më 1 shkurt 2012.

Si përgjigje ndaj ofertës së tij për t'i paguar 20,000 euro, R.Z. dhe X.Z. kanë thënë: "Në rregull, ne do të flasim me prokurorin dhe do të të tregojmë çfarë të bësh më tej".²²

Dy apo tri ditë pas atij takimi, R.Z. ka kontaktuar me P.M. dhe ka kërkuar takim. Të pranishëm në atë takim kanë qenë P.M., R.Z. dhe X.Z. R.Z. i ka thënë P.M. se N.M. e kishte refuzuar ofertën e tij prej 20,000 eurove dhe e kishte përsëritur kërkesën e tij të mëhershme për 50,000 euro. Në dëshminë e tij, P.M. ka thënë se vëllezërit Z. i kanë thënë se N.M. i duhej ajo sasi e parave, sepse paratë do të ndaheshin midis tre njerëzve, duke e përfshirë një avokat nga X. dhe disa persona nga X., emrat e të cilëve nuk janë përmendur.

P.M. i ka informuar vëllezërit Z. se nuk kishte arritur t'i siguronte paratë. Ata i kanë se hetimi do të vazhdonte, por se do të bënin ç'të mundnin për ta gjetur një zgjidhje.

Disa ditë pas atij takimi, R.Z. i ka telefonuar P.M. dhe ka kërkuar edhe një takim. Gjatë atij takimi, R.Z. dhe X.Z. edhe njëherë e kanë përmendur faktin se djali i N.M. ishte i sëmurë dhe kanë thënë: "Ne po bëjmë ç'është e mundur që të ndihmojmë. Ne duhet t'i gjejmë ca para në formë të huas për prokurorin publik..."²³ Ata kanë kërkuar hua nga ai. P.M. nuk i kujtohet se në çfarë shume. Ai ka thënë se nuk ka kishte para për të dhënë hua.

Në dëshminë e tij, P.M. ka dhënë thënë se, pas kësaj, R.Z. e ka thirrur vazhdimisht për nja 2 apo 3 ditë. Ata kanë rëndë dakord që të takoheshin sërish.

Në dëshminë e tij, P.M. ka dhënë thënë se ka biseduar me L.N. dhe e ka pyetur se a mund t'ia huazonte 20,000 euro. Ai ka

²² Fundi i faqes 3 të procesverbalit të datës 5 dhjetor 2012

²³ Fundi i faqes 3 të procesverbalit të datës 5 dhjetor 2012

thënë se i ka treguar atij kur i ka kërkuar paratë se për çfarë i duheshin ato.

L.N. është pajtuar që t'ia huazonte paratë P.M.. P.M. ka thënë se shuma prej 20,000 eurove ishte menduar si hua. Ai ka thënë se këto para ishin menduar t'i jepeshin N.M. për ta mjekuar djalin e tij dhe që R.Z. t'ia kthente ato pastaj L.N. më 31 dhjetor të vitit 2010.

Qëllimi i palëve ishte që një avokat ta hartonte një marrëveshje për huamarrje. Në dëshminë e tij, ai ka dhënë thënë se kurrfarë marrëveshje nuk ishte hartuar.

Në dëshminë e tij para kësaj gjykate se, P.M. ka thënë se ai dhe L.N. janë takuar me R.Z. diku mes 25 dhe 30 korrikut të vitit 2010. Në deklaratën e tij të datës 1 shkurt 2012, ai ka thënë: "Nëse nuk gaboj", takimi është mbajtur midis datave 26 dhe 30 korrik 2010 në një restorant afër zyrës kadastrale në X..

Ai ka thënë se X.Z. nuk ka qenë i pranishëm në takim kur L.N. ia ka dhënë paratë R.Z.

P.M. është pyetur se pse kishte kërkuar nga L.N. që t'ua jepte paratë vëllezërve Z. Në dëshminë e tij, ai ka thënë se paratë ishin menduar të merreshin nga N.M. Ai ka thënë se e kishte aranzhuar një huamarrje, sepse e kishte parë rrezikun me të cilën po përballlej dhe po përpiqej ta mbronte veten nga një akuzë penale e pabazuar. Ai ka qenë i frikësuar se situata do të përkeqësohej po t'mos bashkëpunonte me vëllezërit Z..

Kur huaja nuk është paguar më 31 dhjetor të vitit 2010, P.M. ka folur me R.Z. dhe ka kërkuar që huaja të paguhej menjëherë. L.N. është takuar me P.M., R.Z. dhe X.Z. në X. L.N. është pajtuar me shtyrjen e afatit për kthimin e huas për një muaj.

Duke folur për R.Z. dhe X.Z., P.M. ka dëshmuar se në fillim të muajit gusht të vitit 2010 "ata" kanë filluar ta thërrisnin përsëri. Ata kanë thënë se 20,000 euro nuk mjaftonin dhe se kishin nevojë për para. Ai u ka thënë ta linin rehat. Kështu, krahas 20,000 eurove të marra nga X.Z., P.M. ka thënë se i ka marrë 3,000 euro nga Banka X²⁴ dhe ia ka dhënë R.Z. P.M. e ka vënë mjetin motorik të tij dhe disa gjësende shtëpiake si garanci për huan.

P.M. dhe R.Z. janë pajtuar se këto para ishin menduar si hua, ndërsa R.Z. Z. ka thënë se do ta paguante kamatën e huas. Paratë e marra hua nuk janë kthyer kurrë. Sërish, nuk është hartuar asnjë marrëveshje formale.

Në dëshminë e tij, P.M. ka thënë se i ka thirrur vëllezërit Z. sërish më 31 janar të vitit 2011 për paratë që duhej t'i kthenin. Ai ka thënë se ata e kanë informuar se nuk i kanë pasur paratë dhe kanë propozuar takim. Ai ka thënë se nuk ka pranuar që të takohej, meqë ka menduar se nuk do t'ia vlente nëse ata nuk i kishin paratë.

Pastaj, më 24 shkurt të vitit 2011, në orën 3 pasdite përafërsisht, P.M. e ka pranuar një thirrje nga policia, me ç'rast është udhëzuar që të paraqitej për një takim me zyrtarin hetues më 28 shkurt të vitit 2011 në orën 10 paradite. Personi me të cilin kishte biseduar P.M. i kishte thënë atij që të paraqitej në zyrën e Z.I. Ai nuk ka marrë thirrje zyrtare.

Pasi e ka pranuar thirrjen telefonike, P.M. e ka thirrur R.Z. Të nesërmen, ai është takuar me R.Z. dhe X.Z. në X. Ata i kanë thënë P.M. se nga ai do të kërkohej që të jepte deklaratë. Ata i kanë thënë P.M. se do të bisedonin me "mikun" e tyre dhe se

²⁴ Faqet 740 - 762 të dosjes së shqyrtimit gjyqësor.

do t'i merrnin "të gjitha informatat". Ata kanë thënë: "Miku ynë nuk do të bëjë asgjë që nuk është e mirë për ty". Ata kanë thënë se e kanë informuar atë dhe personat e tjerë që do të merreshin në pyetje.

Në dëshminë e tij, P.M. ka thënë se, kur ka arritur në zyrën e hetuesit më 28 shkurt 2011, në orën 10 paradite, siç ishte udhëzuar, atij i është thënë se takimi ishte shtyrë deri në orën 1 pasdite.

Të pranishëm në takim kanë qenë avokati i tij B.M. dhe Z.I.. Marrja në pyetje ka zgjatur për afro tri orë dhe në fund të takimit Z.I. i ka thënë: "Je i arrestuar". Kur P.M. ka pyetur se për çfarë arsyesh po arrestohet, Z.I. thjesht ka deklaruar se vendimi ishte i N.M. P.M. ka thënë se Z.I. kishte premtuar se ai do të lirohet brenda njëzetekatër orëve.

P.M. është dërguar në qendrën e paraburgimit. Gjatë mbajtjes së tij në paraburgim, nga Mbretëria e Bashkuar ka arritur vëllai i tij, S.M. S.M. e ka angazhuar avokatin T.G.. S.M. ka shkuar në qendër të paraburgimit me T.G.

P.M. ka thënë se ia ka treguar T.G. tërë rrëfimin, përfshirë kërkesën për 50,000 euro.

Më 2 mars të vitit 2011, P.M. është paraqitur para Gjykatës së Qarkut në X, kur është caktuar arresti shtëpiak për 30 ditë.

Prokurori i rastit, N.M., nuk e ka intervistuar asnjëherë P.M. para seancës për shqyrtimin e paraburgimit.

Disa ditë pas lirimit të tij nga paraburgimi, gjersa ende ka qenë në arrest shtëpiak, P.M. ka folur me telefon me R.Z. R.Z. dhe X.Z. kanë ardhur në shtëpinë e tij. I pranishëm në këtë takim ka qenë edhe S.M.. Duke iu referuar bisedës me S.M.,

R.Z. ka thënë se e kishte informuar N.M. për kërcënimet e bëra nga S.M. dhe se, në përgjigjen e tij, N.M. pati thënë: "Nëse është ashtu, atëherë ai do të qëndrojë edhe 24 orë të tjera".²⁵ P.M. ka dëshmuar se R.Z. ka aluduar se ishte gjoja faji i S.M. që vëllai i tij ishte në paraburgim. Në dëshminë e tij P.M. ka thënë se vëllai i tij është ndjerë i fyer nga kjo dhe se atij i është dashur që ta qetësonte.

Nja 2-3 ditë pas atij takimi, P.M. ka kontaktuar me policinë, për t'i informuar ata për tërë rrëfimin që kishte të bënte me R.Z., X.Z. dhe N.M..

Në dëshminë e tij, P.M. ka thënë se një natë, gjersa ishte në arrest shtëpiak, R.Z. dhe X.Z. kanë ardhur në shtëpinë e tij dhe e kanë ftuar atë që t'u bashkëngjitej për kafe. P.M. u ka thënë se nuk mund të largohet nga shtëpia, sepse ishte në arrest shtëpiak. P.M. ka thënë se R.Z. është përpjekur ta thërriste N.M. në telefon. R.Z. i ka thënë personit në telefon: "Jemi në shtëpinë e mikut tonë. A mund ta marrim për një kafe?"²⁶ Ai nuk ka mundur ta dëgjonte personin me të cilin po fliste R.Z. R.Z. e ka informuar atë se mund të largohet nga shtëpia. Ai ka thënë se N.M. kishte thënë: "Më informoni kur ta kryeni". P.M. ka thënë se kishte refuzuar të largohet nga shtëpia.

Disa ditë pas vizitës, P.M. i ka thirrur "ata" dhe ka kërkuar nga vëllezërit Z. që ta aranzhonin që ai t'ia jepte një deklaratë prokurorit. Ai ka thënë se "ata" kanë kontaktuar me të dhe se ai ka thënë se ai duhet të paraqiste kërkesë me shkrim përmes avokatit të tij. Ai e ka bërë këtë dhe e ka marrë thirrjen zyrtare nga prokurori të datës 13 prill 2011.

²⁵ Faqja 16 e procesverbalit të datës 5 dhjetor 2013.

²⁶ Faqja 17 e procesverbalit të datës 5 dhjetor 2012.

Pas pranimit të thirrjes së prokurorit, P.M. ka kontaktuar me R.Z. dhe e ka informuar atë për thirrjen. Ai e ka pyetur R.Z. se si mund të merrte pjesë në takimin me prokurorin, kur i ishte caktuar urdhër për arrest shtëpiak. Atij i është thënë se kjo do të rregullohej, por se P.M. do t'i duhej t'i paguante 5000 euro si "kompensim".²⁷

Më 19 prill të vitit 2011, i pashoqëruar dhe në automjetin e tij, P.M. së pari ka shkuar në zyrën e avokatit të tij T.G. dhe, prej aty, ata të dy kanë shkuar në zyrën e N.M.

P.M. ka thënë se, në atë rast, N.M. e ka pyetur "*Si janë miqtë tanë*"?²⁸

Gjatë asaj interviste, N.M. ka marrë një telefonatë. P.M. e ka dëgjuar N.M. duke thënë: "*Është këtu. Gjithçka është në rregull*".²⁹

Procesverbalet zyrtare tregojnë se ai ka mbërritur në PSRK në orën 10:25 më 19 prill të vitit 2011. Ai është larguar nga PSRK ja në orën 13:25.³⁰

Kur ai është larguar nga prokuroria, ai e ka thirrur R.Z. Përshtypja e tij e qartë ka qenë se kishte qenë R.Z. ai me të cilin N.M. kishte biseduar gjatë intervistës.

Në dëshminë e tij, P.M. ka thënë se, diku kah fundi i marsit të vitit 2011³¹, ai ka kontaktuar me R.Z. dhe ka kërkuar që ata t'ia kthenin huat në shumën totale prej 2,8000 eurove para datës 5 prill 2011.

²⁷ Faqja 17 e procesverbalit të datës 5 dhjetor 2012.

²⁸ Faqja 19 e procesverbalit të datës 5 dhjetor 2012.

²⁹ Idem.

³⁰ Faqja 739 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

³¹ Faqja 19 e procesverbalit të datës 5 dhjetor 2012.

Më 28 mars të vitit 2011, N.M. ka paraqitur në gjykatë një kërkesë për zgjatje të paraburgimit. Kërkesa është aprovuar me një aktvendim të Gjykatës së Qarkut të X të datës 31 mars 2011 dhe pastaj është vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës.

P.M. ka thënë se ka kontaktuar me R.Z. Edhe R.Z., edhe X.Z. kanë shkuar në shtëpinë e tij. Gjatë atij takimi, ai u ka thënë që t'i mbanin paratë, por t'ia hiqnin arrestin shtëpiak.

Ai pastaj ka folur me R.Z., i cili e ka informuar se arresti shtëpiak ishte hequr. Ai ka thënë se vendimin për heqjen e arrestit shtëpiak e ka marrë të nesërmen.

Ai pastaj ka biseduar me X.Z. dhe e ka falënderuar atë për aranzhimin e heqjes së arrestit shtëpiak.

Kur është hequr arresti shtëpiak, R.Z. ka kërkuar edhe një hua. P.M. i ka thënë se nuk i kishte paratë. Megjithatë, djali i P.M. ishte pronar i një mulliri të miellit. P.M. është pajtuar që t'i jepte R.Z. miell në vlerë prej 2,250 - 2,350 eurosh.

P.M. ka thënë se vëllezërit Z. i kanë dhënë atij se po bënëin ç'ishte e mundur që t'i ndihmonin N.M. që ta dërgonte djalin e tij për trajtim mjekësor.

Pasi kishte dhënë një deklaratë në polici në të cilën e kishte shpalosur rrjedhën e ngjarjeve që kishin të bënëin me vëllezërit Z., në konsultim me policinë, P.M. ka kontaktuar me R.Z. dhe i ka thënë atij se do t'i ofronte 50,000 euro për t'u përkujdesur që hetimi kundër tij të merrte fund. R.Z. ka thënë se do të kontaktonin me N.M. Pas dy ditësh, R.Z. ka kontaktuar me P.M. dhe i ka thënë se N.M. nuk donte t'i merrte paratë, sepse P.M. i kishte informuar avokatët për diskutimet e tyre.

Më 10 mars të vitit 2011, R.Z. ka kontaktuar sërish me P.M. dhe këtë herë i ka kërkuar 5,000 euro. Edhe R.Z., edhe X.Z. kanë qenë të pranishëm kur R.Z. i ka kërkuar paratë. Ai ka thënë se do t'i kthente paratë më 14 mars të vitit 2010. Për ta fituar besimin e tyre, P.M. është pajtuar që t'ua jepte atyre paratë që i kishte marrë hua nga G.H.. Ai ka thënë se i ka treguar G.H. "shkurtimisht" për rrethanat për të cilat po i kërkonte paratë.

G.H. i ka thënë se ishte takuar me R.Z. dhe se ia kishte dhënë atij 5,000 euro. P.M. i ka thënë G.H. se do t'i kthente paratë.

P.M. nuk ka folur kurrë me N.M. për paratë, as personalisht, as me telefon.

Në dëshminë e tij, P.M. ka thënë se gjatë takimeve me vëllezërit Z. ata ia kanë treguar SMS-të që ata i kanë thënë se ishin dërguar nga N.M. apo që ia kishin dërguar atij. Ata nuk e kanë lejuar që ta lexonte përmbajtjen [e tyre]. Ai ka thënë se, gjatë takimeve të tjera, vëllezërit Z. e kanë thirrur N.M. dhe e kanë përmendur faktin se po takoheshin me një "mik". Në një rast, vëllezërit Z. ia kanë treguar P.M. një fotografi që ishte regjistruar në njërin nga telefonat mobilë të tyre dhe që ata i kishin thënë se ishte bërë në tempullin e Bektashinjve. Në fotografi shihej N.M. dhe një djalë i ri.

P.M. ka thënë: *"Në shumicën e takimeve që i kam pasur me vëllezërit Z., ata kanë folur me prokurorin në praninë time"*³²

Në një rast, ai ka folur me telefon me njërin nga vëllezërit Z., i cili i ka thënë se kishin qenë me një "mik". Telefoni pastaj i është dhënë këtij personi, i cili ka folur me P.M. Ky

³² Faqja 19 e procesverbalit të datës 12 dhjetor 2012.

person e ka pyetur P.M. se si ishte. P.M. ka thënë se e ka njohur zërin e N.M. N.M. i ka thënë P.M. *"Mos u mërzit, gjithçka do të bëhet mirë"*.³³ Atij nuk i është kujtuar se kur është zhvilluar kjo bisedë.

Organi i akuzës e ka thirrur L.N. Ai është marrë në pyetje nga prokurori më 23 mars të vitit 2012. Ai e ka dhënë dëshminë e tij para kësaj gjykate më 9 janar të vitit 2013. P.M. është mik i tij.

Në dëshminë e tij, L.N. tha se në verën e vitit 2010 P.M. e ka pyetur nëse ai do të mund t'ia huazonte atij 20,000 euro. Ai ka dëshmuar para kësaj gjykate se P.M. i ka thënë se atij i duheshin paratë për shkak të një *"akuze"* që po përgatitej kundër tij. Ai ka thënë se P.M. i ka thënë atij se paratë i duheshin për *"për t'iu shmangur aktakuzës"*.

L.N. ka thënë para kësaj gjykate se arsyeja pse a ka dhënë para hua vëllezërve Z. ka qenë se P.M. besonte sa ata mund ta rivendosnin në pozitën e tij të mëparshme si likuidator i X. Megjithatë, kur është marrë në pyetje nga prokurori më 23 mars të vitit 2012, ai ka thënë se P.M. *"frikësohej se do të arrestohej"*. Në atë rast, prokurori ka kërkuar nga ai që ta shpjegonte arsyen pse P.M. kishte kërkuar që t'ua jepte 20,000 euro vëllezërve Z. Duke u përgjigjur, ai ka thënë se P.M. i kishte thënë atij: *"Ata do ta kryejnë këtë punë për mua, dhe i kanë kërkuar këto para nga unë"*. Megjithatë, më vonë, gjatë marrjes në pyetje, prokurori e ka pyetur L.N. nëse paratë që u ishin dhënë vëllezërve Z. kishin qenë kompensim për *"ndonjë lloj favori"*. Duke u përgjigjur, L.N. ka thënë: *"P.M. më ka thënë se vëllezërit Z. do t'mund ta kthenin në postin e tij të"*

³³ Faqja 21 e procesverbalit të datës 12 dhjetor 2012.

mëparshëm përmes disa njerëzve të tjerë. Sipas tij, unë i kam dhënë këto para vetëm për këtë qëllim"³⁴.

L.N. ka rënë dakord dhe, së bashku me P.M., është takuar me R.Z. dhe X.Z. në X.

Ai ka dëshmuar se nuk është takuar as me R.Z. as me X.Z. para asaj date. Në lidhje me huan, ai ka thënë: *"Ka shkuar përmes P.M., sepse ata nuk i kam njohur fare. Edhe po të jetoja 100 vjet, kurrë nuk do t'i jepja para hua askujt që nuk e njoh"*.

L.N. ka thënë se nuk i ka kushtuar vëmendje të veçantë bisedës dhe se nuk i kujtohej se çfarë ishte thënë saktësisht. Është zhvilluar njëfarë diskutimi në lidhje me interesat afariste të Z. Megjithatë, atij i kujtohet se i kishte dëgjuar vëllezërit Z. duke thënë se ata kishin *"njerëz me ndikim në X dhe se ata mund të kryenin punë të mëdha"*.³⁵

Në dëshminë e tij dhënë para kësaj gjykate, ai ka thënë se janë përmendur *"prokurorë publikë"*³⁶. Megjithatë, kur është marrë në pyetje nga prokurori, L.N. është pyetur: *"A mos kanë përmendur vëllezërit Z. se çfarë njerëz me ndikim..."*. Duke u përgjigjur, L.N. ka thënë: *"Jo mua"*. Ai ka thënë se takimi ka zgjatur 15-20 minuta.

Në të vërtetë, kur është marrë në pyetje nga prokurori, L.N. është pyetur: *"A kanë përmendur vëllezërit Z. apo P.M. diçka për përfshirjen e ndonjë zyrtari të shtetit në këtë rast?"* Duke u përgjigjur, ai ka thënë: *"Tërë çfarë kanë thënë ata ka qenë: "Kemi njerëz në X që mund ta kryejnë punën", por asgjë për emrat apo funksionet e atyre njerëzve"*.³⁷

³⁴ Faqja 373 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

³⁵ Faqja 372 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

³⁶ Faqja 3 e procesverbalit të datës 9 janar 2013.

³⁷ Faqja 373 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

Ai ka rënë dakord që t'ua jepte vëllezërve Z. 20,000 euro hua [me kusht] që kjo shumë të kthehej para vitit të ri. Garantues i huas ka qenë P.M.

L.N. ka thënë se është ranë dakord që aranzhimet në lidhje me huan të viheshin në një kontratë të shkruar. Ai mohoi të jetë paraparë pagesa e ndonjë kamate për huan.

Ai ka thënë se i është dashur të paraqitej në zyrën e avokatit P.P. për ta nënshkruar kontratën. Megjithatë, duket se ditën kur është dashur të paraqitej në zyrën e avokatit, ai e ka pranuar një thirrje nga P.M., i cili i ka thënë se vëllezërit Z. nuk ishin paraqitur në zyrën e avokatit. Ai asnjëherë nuk ka nënshkruar kontratë.

L.N. ka thënë se nja katër ditë pas takimit të tyre të parë në X, ai ia ka dhënë R.Z. 20,000 në të holla të gatshme, gjersa po qëndronin të ulur në veturën e P.M., i cila ishte parkuar para muzeut të qytetit në X.

Ai tha se, kur ishte bërë e qartë se paratë nuk do të paguheshin siç ishte rënë dakord, ai dhe P.M. janë takuar me R.Z. dhe X.Z. Ky takim ka ndodhur para vitit të ri. Ata kanë dakord për një shtyrje të afatit për shlyerje të kredisë.

L.N. ka thënë se vëllezërit Z. nuk e kanë përmendur t'ia kenë dhënë paratë dikujt tjetër.

Në dëshminë e tij, L.N. ka thënë se komunikimi midis tij dhe vëllezërve Z. është zhvilluar përherë përmes P.M. Ai asnjëherë nuk është takuar me asnjërin nga vëllezërit Z. pa praninë e P.M. Ai ka thënë se vëllezërit Z. asnjëherë nuk kanë refuzuar t'i kthejnë të hollat e marra hua. Ata thjesht nuk i kanë kthyer ato.

Vëllezërit Z. ende nuk i kanë kthyer të hollat e marra hua.

L.N. ka thënë se P.M. i ka thënë atij: *"Ata na kanë mashtruar"*. Ai ka thënë: *"Ata i kanë kërkuar paratë për t'më kthyer në vendin e mëparshëm të punës"*.

Organi i akuzës e ka thirrur G.H.. Ai është marrë në pyetje nga prokurori më 26 mars të vitit 2012. Ai e ka dhënë dëshminë e tij para kësaj Gjykate më 10 janar të vitit 2013.

Ka një lidhje familjare të ngushtë midis P.M. dhe familjes së G.H. Ata janë fqinjë.

G.H. ka thënë se në mars të vitit 2011, P.M. i ka telefonuar atij dhe i ka thënë: *"Më duhet t'i gjej 5000 euro menjëherë, ti e di në çfarë sítuate jam"*. Ai ka qenë në arrest shtëpiak në atë kohë. G.H. i ka thënë atij se nuk i ka paratë, por se do t'i gjente.

G.H. ka thënë se P.M. i ka thënë atij se vëllezërit Z. kanë qenë të lidhur me prokurorin e rastit³⁸ në të cilin ai ka qenë i akuzuar. Ai po ashtu ka thënë se P.M. i ka thënë se kishte të bëjë me paraburgimin. Në dëshminë e tij para kësaj gjykate, ai ka thënë se P.M. i kishte thënë se prokurori në fjalë ishte N.M. Ai i ka thënë se P.M. i ka treguar se paratë ishin për N.M. Megjithatë, kur është intervistuar nga prokurori në maj të vitit 2012, ai nuk e ka përmendur prokurorin me emër. Në fakt, me këtë rast, ai është pyetur nëse e kishte dëgjuar emrin e N.M. Duke u përgjigjur, ai ka thënë: *"Tingëllon i njohur, por nuk më kujtohet"*.

G.H. është pajtuar që t'jua dorëzojë paratë atyre personave. P.M. i ka thënë G.H. që paratë t'ia jepte R.Z.. Ai ia ka dhënë G.H. numrin e telefonit të R.Z. Ai ka thënë se nuk e njeh R.Z.

³⁸ Procesverbali i marrjes në pyetje i datës 26 mars 2012.

Më 10 mars të vitit 2011, G.H. e ka tërhequr shumën prej 6,500 eurove nga xhirollogaria në bankën Raiffeisen në emër të P.D., të cilën ai e kontrollonte³⁹. Ai ka thënë se, nga kjo shumë, 1500 euro ishin menduar për qëllime të tjera.

G.H. ka thënë se, gjersa ai po priste në bankë për t'i tërhequr paratë, ai i ka marrë disa thirrje nga R.Z., i cili e ka pyetur se a i kishte paratë. Ata janë pajtuar që të takoheshin tek pompa e benzinës X në X.

G.H. ia ka dhënë R.Z. 5,000 euro në të holla të gatshme. Gjatë takimit të tyre të shkurtër, R.Z. i ka thënë G.H.: "*Po përpiqem t'i ndihmoj P.M. në lidhje me arrestin shtëpiak të tij*". R.Z. e ka shkruar dhe nënshkruar një dokument⁴⁰, me anë të të cilit dëshmohej se të hollat ishin pranuar.

G.H. e ka njohur X.Z., meqë ata kishin punuar së bashku në fabrikën X në X nga viti 1982 deri në vitin 1990. G.H. ka thënë se X.Z. nuk ka qenë i pranishëm gjatë atij takimi. Megjithatë, ai e ka parë dikë të ulur në veturën e R.Z., por nuk ka qenë në gjendje që ta identifikonte atë person.

G.H. ka thënë se, kur ata janë takuar, R.Z. ka thënë se ishte në nguti. Kur është intervistuar nga prokurori në mars të vitit 2012, G.H. ka thënë se ai ka qenë në nguti. Kur kjo i është thënë atij gjatë gjyqimit, ai ka thënë se ata të dy kanë qenë në nguti.

R.Z. i ka thënë atij se por shkonte në X për t'u takuar me dikë në lidhje me arrestin shtëpiak të P.M. Ai ka thënë se paratë ishin për atë qëllim.

³⁹ Faqja 737 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

⁴⁰ Faqja 735 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

Ai ka thënë se R.Z. e ka përmendur "prokurorin" gjatë atij takimi.

Ai ka thënë se takimi me R.Z. ka zgjatur përafërsisht 10 minuta.

Në dëshminë e tij, G.H. ka thënë se P.M. i ka thënë atij se i duheshin 5,000 euro për t'ua dhënë "atyre". Organi i akuzës ka pretenduar se fjala ka qenë për R.Z. dhe X.Z. G.H. ka thënë se ai nuk është takuar me X.Z. në lidhje me çështjen që po shqyrtohej në këtë procedurë. Në të vërtetë, kur ky ia ka dhënë paratë R.Z., R.Z. i ka thënë: "Po përpiqem t'i ndihmoj P....". Megjithatë, G.H. ka thënë se P.M. i ka përmendur edhe R.Z. edhe X.Z. në lidhje me çështjet nën shqyrtim.

G.H. ka thënë se, kur ia ka dhënë fletëpagesën e nënshkruar P.M., ai përsëri e ka përmendur faktin se vëllezërit Z. kanë qenë të lidhur me prokurorin në rastin e tij. Ai ka thënë se P.M. e ka përmendur N.M..

Përafërsisht 1-2 muaj më vonë, P.M. e ka kthyer shumën prej 5,000 eurove.

G.H. ka thënë se, në një rast, kur e kishte vizituar P.M. në shtëpinë e tij, edhe R.Z., edhe X.Z. kanë qenë të pranishëm. Megjithatë, ata janë larguar pasi arritjes së tij.

Organi i akuzës e ka thirrur S.K.. Prokurori e ka marrë në pyetje atë më 27 mars të vitit 2012. Ajo e ka dhënë dëshminë e saj para kësaj gjykate më 15 janar të vitit 2013.

Që nga qershori i vitit 2007, ajo ka qenë e punësuar si asistente e prokurorëve në PSRK. Ajo ka qenë në pushim të lehonisë nga shkurti deri më gusht të vitit 2010 përafërsisht. Pas kthimit të saj nga pushimi i lehonisë dhe për një periudhë

afro tremujore, ajo ka punuar për prokurorë të ndryshëm. Pas kësaj, dhe para arrestimit të tij, ajo ka punuar për N.M.. Ajo nuk ka punuar vetëm për N.M., por edhe për prokurorët e tjerë.

Puna e saj ka përfshirë dosjimin, përkthimin dhe detyrat administrative të tjera, përfshirë dërgimin e thirrjeve për të pandehur dhe dëshmitarë. Ajo ka punuar në rastin e ish-gubernatorit të X. Ajo është marrë me shkresat e lëndës që kanë pasur të bënin me P.M.

Edhe pse duket se ka qenë praktikë normale që të pandehurve dhe dëshmitarëve t'u dërgoheshin thirrjet me shkrim, nuk ka qenë e pazakonshme që personat të thirreshin edhe përmes telefonit. Në ato raste, personi të cilit i është dërguar thirrja normalisht e ka nënshkruar thirrjen pas arritjes së tij/të saj në PSRK. Ajo ka thënë se kjo nuk ka qenë praktikë e pazakonshme.

Në fillim ajo ka thënë se nuk i kujtohej nëse kishte lëshuar thirrje me shkrim për P.M. apo jo. Asaj nuk i kujtohej se sa thirrje ia kishte dërguar P.M.

Në dëshminë e saj para gjykatës ajo ka thënë se nuk mund të jetë e sigurt nëse P.M. ishte ftuar me shkrim apo kontaktuar përmes telefonit. Kur është marrë në pyetje nga prokurori në mars 2012 ajo ka thënë se nuk e ka thirrur P.M. asnjëherë në telefon për të kërkuar nga ai të vijë në zyrat e PSRK-së.

Ajo ka dhënë dëshmi se në një rast ajo ka thirrur P.M. të paraqitet para hetuesit të policisë, Z.I. Ajo mendon se ky ishte rasti i vetëm kur ajo kontaktoi P.M. me telefon.

Ajo ka dëshmuar se P.M. është takuar me N.M. në një "seancë" në zyrat e PSRK-së. Ajo mendoi se ka qenë në 2011. Asaj nuk i kujtohej nëse P.M. ishte paraqitur në zyrat e PSRK-së më shumë

se një herë. Asaj nuk i kujtohej nëse P.M. dhe N.M. kishin folur jashtë seancës.

S.K. dëshmoi se nuk i kujtohej sa herë ishte paraqitur P.M. në zyrat e PSRK-së. Asaj nuk i kujtohej nëse N.M. kishte kërkuar ndonjëherë nga ajo të kontaktojë P.M. të paraqitet në PSRK për një takim joformal.

Duke iu referuar lëndës kundër Guvernatorit të X. ajo ka thënë se asnjëherë nuk e ka parë listën e personave që do të arrestoheshin.

S.K. ka dëshmuar se e njohte R.Z. si shok të N.M.. Ajo kishte marr vesh emrin e X.Z. vetëm kur e ka lexuar në gazeta pas arrestimit të N.M.

Dëshmia e saj ishte se anëtarëve të stafit u caktohen numra unik të telefonit. Ajo tha se i kujtohej në një rast kur R.Z. telefonoi në numrin privat të zyrës së N.M. dhe kërkoi të flasë me të. Ajo tha që R.Z. ia tregoi emrin asaj. Asaj nuk i kujtohej çka, çfarëdo qoftë, ka thënë R.Z. më tutje më atë rast. Kur është marrë në pyetje nga prokurori në mars 2012, duke iu referuar këtij rasti ajo ka thënë se e ka pyetur R.Z. R.Z. nëse ai dëshironte të linte porosi dhe në përgjigje ai ka thënë "*Jam R.Z.i, shoku i tij, thuj të më thërret*".

Prokurori paraqiti si provë ekstrakte nga ditari personal i S.K.. Në dëshminë e saj ajo tha se shënimet i kishte bërë si *aide memoire*. Ajo konfirmoi dy shënime në ato ekstrakte. Shënimi i parë thoshte "*Për N.M. 13.40 R.Z.*". Data e shkruar me dorë në krye të faqes ishte 20 shtator 2010. S.K. e konfirmoi se ishte shkrimi i saj.

S.K. dëshmoi se shënimi kishte të bënte më rastin kur ajo

kishte marrë porosinë nga R.Z. kur ai kishte telefonuar numrin zyrtar privat të N.M. të cilit i referohej në dëshminë e saj.

Shënimi i dytë thoshte "R.Z.- 28.03.2012 11.25". Përsëri ajo e konfirmoi se e kishte bërë atë shënim⁴¹. Kjo vizitë konfirmohet me regjistrat zyrtar⁴².

Ajo tha se shënimi i referohej një rasti më 28 mars 2012 kur R.Z. u shfaq te zyrat e PSRK-së ku kërkoi një takim me N.M.n. Ajo tha se e informoi N.M. lidhur me mbërritjen e R.Z. dhe ai u pajtua të takohej me të. Ajo nuk ka qenë e pranishme gjatë atij takimi. Ajo nuk e dinte sa kohë zgjati ky takim.

Sipas regjistrave zyrtar ai takim zgjati 15 minuta.

Sipas regjistrave zyrtar, R.Z. vizitoi zyrat e PSRK-së më 12 maj 2011 në ora 14:30 po ashtu. Ai u largua nga zyrat 7 minuta më vonë⁴³.

Asaj i kujtohej kur T.G. vizitoi zyrën e N.M. në disa raste lidhur me lëndën.

Prokuroria thirri L.Z-M. Ajo ishte marrë në pyetje nga prokurori më 27 mars 2012. Ajo dha dëshmi para kësaj gjykate më 16 janar 2013.

Në mes gushtit 2006 dhe shtatorit 2010 ishte e punësuar në PSRK si zyrtare ligjore. Ajo kishte punuar për prokurorë të ndryshëm.

Ajo dëshmoi se hetimi lidhur me ish Guvernatorin e X. kishte qenë arsyeja kryesore pse ajo dha dorëheqje në shtator 2010.

⁴¹ Faqet 738 dhe 739 të dosjes së shqyrtimit kryesor.

⁴² Faqe 739 e dosjes së shqyrtimit kryesor.

⁴³ Faqe 739, dosja e shqyrtimit kryesor.

Ishte marrë vendim herët gjatë hetimit që të vazhdohej kundër ish Guvernatorit dhe bashkëpunëtorëve më të ngushtë të tij. Dy zyrtarët ligjorë që punonin në lëndë ishin L.Z-M. dhe S.S. Fillimisht ishte caktuar një zyrtar ligjor i Eulex-it por më vonë ishte hequr nga lënda.

L.Z-M. dëshmoi se ishte e shqetësuar rreth drejtimit që lënda kishte marrë. Sipas mendimit të saj provat nuk mbështetnin pretendimet. Ajo besonte se provat ishin duke u manipuluar për të justifikuar vazhdimin e paraburgimit të ish Guvernatorit të X. Ajo ia shfaqti shqetësimet e saja N.M. dhe eprorëve të tij. Ajo ishte këshilluar që të vazhdoi të punojë në lëndë dhe të ndjekë udhëzimet e N.M. Ajo dha dorëheqje nga pozita e saj. Dëshmia e saj ishte se zyrtari ligjor i Eulex-it me emrin F.L. ndau shqetësimet e saj. Ajo tha se kur ai u shpreh lidhur me këto shqetësime ai u hoq nga lënda.

Asaj iu kujtua të ketë parë në dosje të lëndës një listë të personave që do arrestoheshin. Asaj nuk i kujtoheshin emrat në listë.

Ajo tha se S.K. i kishte thënë se P.M. ishte ftuar në zyrat e PSRK-së dhe se ai u paraqit në dy raste. Ajo tha se S.K. i kishte thënë se P.M. kishte pasur biseda joformale me N.M. dhe Z.I. përpara datave kur ai ishte ftuar zyrtarisht. Regjistrimet zyrtare shënojnë se P.M. kishte vizituar zyrat e PSRK-së më 8 dhe 15 shtator 2010⁴⁴.

Prokuroria thirri S.H.. Ajo ishte marrë në pyetje nga prokuroria më 10 prill 2012. Ajo dha dëshmi para kësaj gjykate më 16 janar 2013.

⁴⁴ Faqet 819 dhe 829 të dosjes së shqyrtimit kryesor.

Në mes shtatorit 2010 dhe marsit 2011 ajo kishte punuar si zyrtare ligjore në PSRK. Ajo kishte punuar për prokurorë të ndryshëm përfshirë dhe N.M.

Ajo kishte punuar në lëndën që përfshinte ish Guvernatorin e X. Ajo ishte informuar nga L.Z-M. se I.A. kishte kërkuar analizë të lëndës. Ajo kishte rishikuar lëndën së bashku me L.Z-M. dhe kishin përpiluar një analizë të provave. Sipas mendimit të saj provat ishin të pamjaftueshme për të mbështetur akuzat e propozuara. Raporti i tyre i ishte dhënë N.M.

S.H. dëshmoi se në shkurt 2011 ajo kishte përpiluar Aktvendimin për fillimin e hetimeve në lëndën kundër P.M.. Ajo ishte siguruar se ekzistonin prova të mjaftueshme kundër P.M. për të justifikuar lëshimin e një Aktvendimi të tillë. Ajo tha se drafti i ishte dërguar Eulex-it dhe më pas ishte ndryshuar.

Asaj nuk i kujtohej se kishte parë në dosjen e lëndës listën e personave që do të arrestoheshin. Ajo mendoi se po që se ekzistonte një listë e tillë do ta shihte.

Ajo tha se nuk e kishte parë P.M. në zyrat e PSRK-së asnjëherë. Asaj nuk iu kujtua ndonjë takim joformal të ketë ndodhur me P.M. në zyrat e PSRK-së.

Ajo u largua nga PSRK në mars 2011.

Prokuroria thirri S.M. Ai ishte marrë në pyetje nga prokurori më 10 prill 2012. Ai dha dëshmi para kësaj gjykate më 16 dhe 17 janar 2013.

Ai është vëllai i P.M. Ai përshekroi se kanë marrëdhënie të ngushtë.

S.M. tha se nuk kishte dijeni për ndonjë raport biznesi në mes P.M. dhe R.Z. dhe/ose X.Z.

Ai dëshmoi se gjatë tërë kohës thelbësore dhe deri në korrik 2011 kishte jetuar në Angli. Ai tha se ka qenë në kontakt ditor me familjen e tij. Ai mbante kontakt me vëllain e tij. Ai tha se gjatë një bisede me vëllain e tij, P.M. iu referua një "iniciative" kundër tij me N.M. përmes "vëllezërve" Z. që përfshinte ryshfetin prej 50,000 Euro.

Dëshmia e tij ishte se gjatë bisedave telefonike, P.M. e kishte informuar atë se ishte duke u shantazhuar nga R.Z., X.Z. dhe N.M. të cilët, tha ai, kërkonin 50,000 Euro që t'a bëjnë lëndën të zhdukët.

Kur ai dha dëshmi para kësaj Gjykate ai fillimisht tha se L.N. i dha paratë vëllezërve Z.. Ishte i qartë, qëllimi ishte "të trajtohej djali i N.M."⁴⁵

S.M. dëshmoi se më 28 shkurt 2011 ai pranoi një thirrje telefonike nga djali i P.M. i cili e informoi atë se P.M. ishte arrestuar. Menjëherë udhëtoi në Kosovë, ku arriti më 1 mars 2011.

Në dëshminë e tij tha se me të arritur në X foli me R.Z. në telefon. Ai tha se iu "falënderua" atij për arrestimin e P.M. dhe kërkoi kthimin e parave që ai kishte pranuar, brenda 24 orëve. R.Z. i tha se ishte në X. Ai tha se R.Z. mohonte se kishte të bënte çfarëdo qoftë me arrestimin e P.M.. Ai tha se do të kontaktonte me N.M.⁴⁶.

⁴⁵ Faqet 27 dhe 28 të procesverbalit të datë 16 janar 2013.

⁴⁶ Shih emailin po ashtu dërguar nga Sokol Mirashi më 3 prill 2012 [faqet 763-768 të dosjes së shqyrtimit kryesor].

S.M. dëshmoi se gjatë bisedës telefonike, R.Z. kërkoi nga ai që t'ia zgjaste afatin për kthimin e huas ose të "tërhiqte akuzën". Ata u pajtuan të takohen pas kthimit të R.Z. nga X.

S.M. dëshmoi se udhëzoi një avokat, T.G., të përfaqësojë P.M. Ai shkoi në zyrën e N.M. por s'pati mundësi të flasë me të.

S.M. u paraqit në gjykatë me rastin e zëvendësimit të paraburgimit me arrest shtëpiak. Ai dëshmoi se e pa N.M. jashtë sallës së gjykatës. Tha se e injoroi N.M.

Ai tha se dy ditë pasi u lirua P.M. në arrest shtëpiak ishte i pranishëm në një takim në shtëpinë e P.M. në të cilën ishin të pranishëm ai, P.M., R.Z. dhe X.Z.. Ai tha se R.Z. i tha se për shkak të kërcënimeve që ia ka bërë R.Z. kur ata kanë folur ai duhet të fajësohej për zgjatjen e paraburgimi të R.Z. edhe për 24 orë. R.Z. tha se N.M. kishte thënë "meqë të është kërcënuar S., P. do të vuajë edhe 24 orë arrest"⁴⁷ R.Z. tha se N.M. kishte thënë se nëse S.M. bën kërcënime tjera ai do të arrestojë S.M.

S.M. dëshmoi se R.Z. kishte thënë se çdo gjë do të jetë në rregull dhe se "ata" do të flasin me N.M. por se ata duhet të paguajnë 50,000 Euro nëse pretendimet do të "zhduken".

Dëshmia e tij ishte se gjatë takimit R.Z. dhe X.Z. të dy kanë thënë se ata janë udhëzuar nga N.M. që të informojnë P.M. se do të ndërpresin lëndën ndaj P.M. për një pagesë prej 50,000 Euro. Ata thanë se kanë afërsi të ngushtë familjare me N.M. Ata thanë se për shkak të miqësisë së tyre mund të zhdukin lëndën.

R.Z. e përmendi djalin e N.M. Ai tha se djali i tij ishte i

⁴⁷ Faqe 471 të dosjes së shqyrtimit kryesor

sëmurë dhe se N.M. propozoi ta dërgoi në X për trajtim. Për këtë arsye atij i nevojiteshin para. S.M. tha se ai ofroi të ndihmoi për të gjetur një ekspert të përshtatshëm në X.

S.M. tha se ai kërkoi të takojë N.M. R.Z. tha se N.M. nuk kishte dëshirë të takonte atë sepse ai duket se e kishte ofenduar N.M. kur nuk e kishte përshëndetur atë kur u takuan jashtë gjykatës në ditën e seancës për paraburgim të P.M.

S.M. dëshmoi se në përfundim të atij takimi ai u ka thënë vëllezërve Z. se do të shkojë në X të takojë avokatin e P.M., T.G. dhe një avokat tjetër udhëzuar me herët nga P.M. Në përgjigje R.Z. tha se ai dhe X.Z. do të udhëtojnë në X të takohen me N.M. R.Z. sugjeroi të takohen më vonë në Prishtinë. S.M. ia dha R.Z. numrin e tij të telefonit. Ishte numër i parapaguar. Mendoj se numri ishte X.

S.M. dëshmoi se udhëtoi në Prishtinë po atë ditë ku pagoi tarifën. Ai tha se nuk u ka treguar avokatëve lidhur me përfshirjen e vëllezërve Z. apo N.M. në veprat e pretenduara.

Gjatë kohës në Prishtinë ai pranoi një thirrje telefonike nga R.Z. i cili kërkoi të takoheshin. Janë takuar në një kafe. Ai tha se X.Z. ka qenë i pranishëm po ashtu.

Gjatë atij takimi R.Z. tha se ka folur me N.M.. R.Z. tha *"Do të ishte më mirë të na paguash ne 50,000 Euro që ta pushojmë lëndën se sa t'ia jepni ato para avokatëve"*.⁴⁸

S.M. dëshmoi se P.M. i kishte thënë atij se ai i kishte huazuar 20,000 Euro nga L.N. për t'ua dhënë vëllezërve Z. Këto para duhej dhënë N.M. për trajtimin e djalit të tij. Ai tha se është hua, që do të paguhet nga vëllezërit Z. brenda 4 muajve.

⁴⁸ Faqe 31, procesverbali i 16 janarit 2013.

Ai tha se nuk e dinte nëse P.M. do të merrte diçka pas për këtë hua. Megjithatë, në përgjigje të pyetjes lidhur me statusin e 20,000 Eurove nga L.N. S.M. tha "Kjo ka pasur të bëj me zhdukjen e lëndës kundër vëllait tim ku në atë rast nuk do të ktheheshin nga vëllezërit Z.". Ai dëshmoi po ashtu se në një rast kur ata janë takuar, R.Z. ka thënë se paratë do të "zhdukin" lëndën ndaj P.M. S.M. dëshmoi se X.Z. përsëriti dhe vërtetoi çdo gjë që vëllai i tij tha dhe ky besoi se N.M. ishte "lideri" i tyre.⁴⁹

Ai tha se e dinte se P.M. kishte huazuar 5,000 Euro nga G.H.. Ai tha se P.M. i ka thënë se këto para kanë qenë për qëllim të trajtimit të djalit të P.M.

Ai tha që e dinte se P.M. ua ka dhënë vëllezërve Z. edhe një shumë prej 3,000 Euro. Ai tha se P.M. nuk i ka thënë atij nëse kjo ishte hua apo, në të vërtetë, pse ua kishte dhënë atyre këto para.

Prokuroria thirri **T.G.** Ai është marrë në pyetje nga prokurori më 11 prill 2012. Ai dëshmoi para kësaj gjykate më 12 shkurt 2013.

Ai dëshmoi se më 4 mars 2011 ishte udhëzuar nga S.M. të përfaqësojë P.M. i cili ishte në paraburgim në atë kohë. Lënda ndaj P.M. ishte PPS 87/10.

Më 4 mars 2011 T.G. vizitoi P.M. në qendrën e paraburgimit në Prishtinë. Ai e përfaqësoi P.M. në seancën pasuese mbi paraburgimin kur paraburgimi u zëvendësua me arrestin shtëpiak.

T.G. dëshmoi se gjatë seancës mbi paraburgimin P.M. i kishte

⁴⁹ Faqe 32, procesverbali i 16 janarit 2013.

thënë atij "Ekzistojnë arsye pse prokurori publik më ka paraburgosur". T.G. tha se i ka thënë P.M. të mos ia përmend këtë gjykatësit.

Dëshmia e tij ishte se në takimin e parë P.M. i ka thënë se dikush që është duke vepruar në emër të prokurorit i ka kërkuar 50,000 Euro.

Kur është marr në pyetje T.G. në prill 2012 ai nuk ka thënë kush i ka kërkuar P.M. 50,000 Euro. Megjithatë, më vonë në dëshminë e tij ai ka thënë se P.M. ka deklaruar se nuk ua ka dhënë 50,000 Euro "këtyre vëllezërve"⁵⁰. Ai tha edhe pse P.M. ia ka përmendur emrat e këtyre vëllezërve atij nuk i kujtoheshin emrat e tyre.

Kur dha dëshmi para kësaj gjykate ai tha se ishin këta dy vëllezërit që kërkuan 50,000 euro në emër të prokurorit.

T.G. dëshmoi se gjatë pushimit në seancën për paraburgim ai foli me N.M.. Ai i tha tij se P.M. ka deklaruar se "dikush ka kërkuar para në emër të Prokurorit Publik". N.M. e mohoi të ketë kërkuar para.

Atij nuk i kujtohej P.M. të ketë përmendur t'ia ketë dhënë ndonjë shumë parash tjetërkujt.

Gjatë njërit prej takimeve të tyre P.M. i thotë T.G. se N.M. ka vënë presion në të që të jep dëshmi në lëndën ndaj ish Guvernatorit të X. Ai kishte refuzuar të thotë se dinte diçka.

Dëshmia e tij ishte se gjatë kohës në paraburgim P.M. kishte ardhur në zyrën e tij pa shoqërimin e zakonshëm të policisë. T.G. i kishte thënë P.M. se mund të arrestohej për shkelje të

⁵⁰ Faqe 6, 12 shkurt 2013.

kushteve të arrestit shtëpiak. Në përgjigje P.M. kishte thënë "mos u bë merak kjo është rregulluar".

T.G. dhe P.M. shkuan së bashku në zyrën e prokurorit ku P.M. dha deklaratë. Kur u morr në pyetje nga prokurori në prill 2012 T.G. dëshmoi se N.M. nuk dukej i befasuar që P.M. kishte ardhur pa përcjelljen e policisë⁵¹. Kur ai dëshmoi para kësaj gjykate ai tha se N.M. e dinte se P.M. kishte udhëtuar nga shtëpia e tij pa përcjelljen e policisë.

T.G. dëshmoi se kur përfundoi intervista N.M. e pyeti P.M.n rreth dy vëllezërve. Kur dëshmoi në prill 2012 T.G. tha se P.M. u përgjigj "në mënyrë ironike" se ishin në rregull. T.G. nuk i kujtohej nëse P.M. kishte përmendur emrat e këtyre "vëllezërve".

T.G. dëshmoi se P.M. i kishte thënë atij se kishte folur me kryeprokurorin I.K.. P.M. ia dha T.G. kopjen e kërkesës së tij të datës 5 tetor 2011 të parashtruar Kryetarit të Gjykatësve të EULEX-it dhe Kryeprokurorit të EULEX-it që lëndën ta marrin përsipër dhe të diskualifikohet N.M. nga lënda PPS. 87/10.

Një rast i ri si pasojë ishte filluar ndaj P.M. nën numrin e lëndës PPS 02/12.

Më 13 janar 2012 në lëndën 02/12 një ftesë ishte nënshkruar nga ose në emër të N.M. për P.M. të paraqitet në zyrat e PSRK-së në ora 10:30 më 2 shkurt 2012⁵² në cilësinë e të dyshuarit.

Më 27 janar 2012 lënda 02/12 ishte transferuar⁵³ në zyrën e prokurorit të qarkut dhe si rrjedhojë është pushuar.

⁵¹ Procesverbal i marrjes në pyetje, 11 prill 2012.

⁵² Faqe 2914, dosja e shqyrtimit kryesor.

⁵³ Faqe 2915, dosja e shqyrtimit kryesor.

T.G. tha se S.M. nuk i kishte thënë atij rreth pretendimeve që përfshinte N.M. dhe vëllezërit Z.. Në fakt ai tha se foli me S.M. për disa minuta.

T.G. dëshmoi se e respektonte N.M. Në të vërtetë, ai bile e kishte rekomanduar N.M. të emërohet ambasador.

Avokati i R.Z. që quhet P.P. Ai nuk kishte dhënë deklaratë më përpara në polici apo në prokurori. Ai dha dëshmi para kësaj gjykate më 14 shkurt 2013.

P.P. është avokat. Ai dëshmoi se në vitin 2010 ishte kontaktuar nga R.Z. dhe L.N. Secili iu referua një kontrate që propozohej të përpilohej nga P.P. lidhur me një hua në shumën prej 20,000 Euro nga L.N. te R.Z.

P.P. dëshmoi se nuk i kishte diskutuar kushtet e kontratës së propozuar as me R.Z. apo me L.N.

Ai tha se kishte kërkuar nga R.Z. t'ia sjellë atij Vërtetimin e Pronës. Kur erdh në gjykatë P.P. solli me vete Vërtetimin e Pronës të mbyllur. Nuk i kujtohej kush ia kishte dhënë atij.

P.P. dëshmoi se nuk dëgjoi asgjë tjetër nga R.Z. dhe as nga L.N. dhe kontrata nuk ishte përpiluar asnjëherë.

Ai dëshmoi se ishte kontaktuar nga P.M. i cili u interesua rreth draft kontratës. Ai tha se P.M. e pyeti nëse e kishte përpiluar kontratën në mes R.Z. dhe L.N.. Megjithatë, ai tha se kishte përshtypje se P.M. kishte prurë L.N.n dhe R.Z. së bashku. Ai nuk mund të shpjegonte se si e kishte formuar atë përshtypje.

2. Lënda V.L., A.L., L.K.

Më 28 maj 2010 një kallëzim penal i nënshkruar nga aksionarë të ndryshëm të X. për Biznes i ishte dërguar policisë. Personat e akuzuar në atë raport përfshinin A.G. dhe V.L. Kësaj dosjeje iu dha numri i lëndës PPS 65/10.

Më 23 qershor 2010 N.M. i dërgoi në atë kohë shefit të PSRK I.A. një memo me titull "Informata për veprimet e ndërmarra në lëndën PPS 23/09". Në këtë dokument N.M. informoi eprorin e tij rreth veprimeve hetuese që tashmë kishin ndodhur. Ai arriti në përfundim se duhet të fillohen hetime të ndara ndaj të gjithë të dyshuarve të cilët ishin identifikuar në kallëzimet penale të policisë. Ai mendonte, një nga këto rastet e veçanta duhet të jetë rasti ndaj V.L., L.K. dhe A.L.

Më 20 korrik 2010 policia e Kosovës ia dorëzoi N.M. një Memorandum Zyrtar Nr. 017-TFAK/2010. Ai raport përmbante pretendime ndaj V.L., L.K. dhe A.L. Kësaj dosjeje iu dha numri i lëndës PPS 99/10.

Më 4 tetor 2011 N.M. nxori Aktvendim mbi Fillimin e Hetimeve në lëndën penale PPS 99/10 ndaj V.L., A.L. dhe L.K. ku ata ishin dyshuar për kryerje të veprës penale Shpërdorim i Pozitës Zyrtare dhe i Autorizimit (Neni 339 të KPK) dhe Përvetësim gjatë Ushtrimit të Detyrës (Neni 340 të KPK).

Më 2 dhjetor 2011 N.M. nxori Aktvendim mbi Fillimin e Hetimeve në lëndën penale PPS 65/10 ndaj V.L., A.L. dhe L.K.

Prokuroria thirri V.L.. Ai u mor në pyetje nga prokurori më 12 prill 2012. Kishte një ballafaqim në mes V.L. dhe M.N. më 29 maj 2012. V.L. dha dëshmi para kësaj gjykate më 8 janar 2013.

V.L. deklaroi se në vitin 2005, së bashku me A.L. dhe L.K. morën përsipër menaxhimin e X. Në vitin 2007 banka X e Re të X. Këto dy banka si rrjedhojë u bashkuan dhe u bënë banka X. Deri në korrik 2009 ai kishte qenë anëtar i bordit të X. Prej 1 gusht 2009 është Drejtor Menaxhues i X. për Biznes.

Në vitin 2009 V.L. dëgjoi thashetheme për një hetim të PSRK lidhur me pretendimet për praktika të paligjshme gjatë marrjes së X dhe më vonë shitjen e saj X. Ai e kuptoi se hetimi kishte të bënte me të, me A.L. dhe L.K. Ai ishte i informuar po ashtu lidhur me ankesa që ishin bërë nga disa aksionarë rreth mënyrës së përzgjedhjes së tij.

V.L. dëshmoi se hetuesit e vizituan atë në X në disa raste. Ai udhëzoi stafin e tij të bashkëpunojnë plotësisht. Ai tha se hetuesit intervistuan udhëheqësit e departamenteve të ndryshme në bankë.

V.L. dëshmoi se takoi M.N. në vitin 2011. Në verë të vitit 2011 kur ata diskutuan disa marrëveshje financiare lidhur me një projekt që përfshinte një kompani që quhet X. Ky takim ndodhi në zyrën e tij. Ishte i pranishëm drejtori i X po ashtu. Nuk u morën vesh të takohen përsëri.

Më vonë atë ditë ai u takua rastësisht me M.N. dhe drejtorin e X. Prapë foli me drejtorin e X dhe përsëriti leverdinë e X. në asistimin e projektit. Nuk i kujtohej çfarë, nëse ka pasur ndonjë, bisedë që ka pasur me

Në shtator 2011 ai pranoi një thirrje telefonike nga M.N.. Ajo kërkoi nja takim. V.L. i sugjeroi M.N. të vijë të zyra e tij. Megjithatë, M.N. kërkoi takim jashtë zyrës së tij. Ajo tha se donte të diskutonte një çështje "të besuar". Për këtë arsye si duket ajo sugjeroi të takohen në hotelin X.

Kur u takuan në hotel M.N. deklaroi se e dinte se V.L. ishte "profesional". Ajo tha se e dinte gjithashtu se ishte "kokëfortë". Ajo tha se e dinte se ai kishte probleme dhe tha se do të arrestohej.

V.L. dëshmoi se gjatë takimit të tyre M.N. iu referua pretendimeve që përfshinin marrjen e X. së X dhe ankesat e bëra nga aksionarët e X.

Gjatë takimit të tyre M.N. sugjeroi që V.L. të kontaktojë A.G., Kryetarin e Bordit të X., dhe t'i thotë atij të mos i telefonojë N.M.. V.L. e dinte që A.G. kishte provuar disa herë të takojë N.M. dhe kishte provuar të kontaktojë atë me telefon. Sipas tij M.N. e kishte bërë këtë koment në mënyrë që të bindë atë për marrëdhënien e saj me N.M.. Në të vërtetë, ai dyshoi se N.M. ishte prapa takimit me M.N.. Për më tepër, gjatë atij takimi M.N. tha disa herë se kishte raport shumë të mirë me N.M.. Ajo tha se për shkak të marrëdhënieve të saja me N.M. ajo mund të *"çonte lëndën që të mbyllet"*.

Është interesant, gjatë atij takimi M.N. përmendi se N.M. ishte duke punuar me një prokuror gjerman.

Gjatë atij takimi M.N. ia prezantoi V.L. kartën e biznesit që supozohet të jetë e një prokurori zviceran dhe i tha atij se kishte udhëtuar me avion nga X për qëllimin e vetëm të diskutimit të lëndës së tij.

M.N. sugjeroi që V.L. dhe "shokët" të tij të udhëtojnë në X për të *"përfunduar punën"*. Ai e kuptoi se do të takonin M.N. në X. V.L. dëshmoi se M.N. nuk përmendi emra në veçanti por, duke marrë parasysh temën e diskutimit, ai e kuptoi se ajo i referohej A.L. dhe L.K.

Duket se takimi zgjati 45 minuta - një orë.

V.L. dëshmoi se ai informoi A.L., L.K. dhe A.G. për takimin e tij me M.N..

Më 11 shkurt 2012 V.L. pranoi një thirrje për t'u paraqitur në zyrat e PSRK-së.

Më 30 mars 2012 ai u intervistua nga N.M.. Gjatë marrjes në pyetje të pranishëm ishin edhe një ekspert, avokati i tij, T.R., një procesmbajtës dhe Z.I.

V.L. dëshmoi se gjatë marrjes në pyetje ai u pyet nga N.M. pyetje lidhur me pretendimet për X. Marrja në pyetje zgjati rreth katër orë.

V.L. është takuar me N.M. vetëm një herë.

V.L. dëshmoi se ai ia raportoi thelbin e takimit me M.N. prokurorit publik të qarkut A.Lu..

Më 13 shkurt 2012 një kërkesë⁵⁴ për diskualifikimin e N.M. nga lëndët e prokurorisë PPS 99/10 dhe 65/10 kundër V.L., A.L. dhe L.K. iu dërgua Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, adresuar për vëmendjen e S.J. dhe një kopje I.K., Kryeprokurorit të Shtetit, dhe J.N., Kryeprokurores së EULEX-it. Kjo kërkesë ka arritur në zyrën e prokurorisë më 15 shkurt 2012.

Prokuroria thirri A.L.. Ai u mor në pyetje nga prokurori më 13 prill 2012. Ai dha dëshmi para kësaj gjykate më 13 shkurt 2013.

⁵⁴ Faqet 729 - 734, dosja e shqyrtimit kryesor.

Me profesion u prezantua si Drejtor Gjeneral i X.

Ai dëshmoi⁵⁵ se në maj ose në qershor 2010 vëllai i tij A.Lu. pyeti rreth një kërkesë për kredi e cila ishte bërë nga R.Z. dhe X.Z.. Kredia ishte për kompaninë e tyre R.Z. i X. A.Lu. i tha se i ishte afruar N.M. lidhur me kredinë.

Në provat shihet se kredia ishte aprovuar nga dega e X. në X por nuk ishte aprovuar nga komisioni për kredi i X.. A.L. tha se ai informoi vëllezërit Z. për vendimin e X.

Në fillimi të 2010 ai zbuloi se i ishte nënshtruar një hetimi kriminal.

Në shtator 2010 oficerët e policisë intervistuan atë në zyrën e tij në bankë. Në tetor 2010 ai pranoi një thirrje telefonike nga policia ku kërkuan që ai të paraqitej në stacion të policisë për të dhënë deklaratë. Si rrjedhojë ai dha një deklaratë në cilësi të dëshmitarit.

Ai dëshmoi se gjatë vitit 2010 banka pranoi shumë kërkesa nga policia për zbulime financiare dhe të dhëna tjera. Ai ishte i shqetësuar nga natyra publike e hetimit të policisë në aktivitetet e X. të cilat mundën të kenë ndikim negativ në stabilitetin e X. Ai tha se kërkoi të takohet me N.M.n.

Ai dëshmoi se takoi N.M.n në nëntor 2010. Ai kërkoi nga N.M. të udhëzojë një ekspert financiar që të shqyrtojë transaksionet financiare të X. Gjatë asaj bisede N.M. i tha A.L. *"E kam urdhrin për arrest ndaj jush i cili ka qenë në posedimin tim kur është arrestuar H.R., edhe pse kam qenë nën presion për t'iu arrestuar juve gjithashtu por unë nuk ka bërë*

⁵⁵ Procesverbal i marrjes në pyetje, 13 prill 2012.

këtë për shkak të konsideratës që kam për familjen tuaj”⁵⁶

A.L. nuk është intervistuar formalisht nga N.M.

Vonë në 2011-ën apo 2012-ën e hershme i është thënë nga V.L. se ishte kontaktuar nga M.N. e cila i kishte ofruar ndihmë për të ndërprerë hetimet. Do të duhej të mbahej një takim në X.

Ai nuk është takuar asnjëherë me M.N.

Ai e nënshkroi Kërkesën e datës 13 shkurt 2012 për përjashtimin e N.M. nga hetimet në këtë lëndë. Ai dëshmoi se të tre nënshkruesit kanë qenë të përfshirë në draftim. Drafti përfundimtar ishte përgatitur në kompjuterin e tij.

Prokuroria thirri L.K.. Ai u mor në pyetje nga prokurori më 24 prill 2012. Ai dha dëshmi para kësaj gjykate më 13 shkurt 2013.

Aktualisht ai është anëtar i Bordit Menaxhues të X. Ai ka qenë anëtar i Bordit Menaxhues të X. së përmendur në vitin 2011.

Ai dëshmoi se në vitin 2011 zbuloi se ka qenë nën hetime. Ai e kuptoi se ishte bërë një ankesë nga aksionarët e X. për shkak të shitjes së saj në vitin 2007. Ai tha N.M. ishte prokuror që udhëhiqte hetimet. Hetuesit e kishin vizituar bankën dhe kishin intervistuar stafin.

Personalisht nuk ishte kontaktuar nga N.M. në vitin 2011. Ai nuk bëri përpjekje të kontaktojë N.M.

L.K. dëshmoi se në apo rreth shtatorit 2011 V.L. i kishte thënë se kishte pranuar një thirrje telefonike nga M.N. e cila

⁵⁶ Procesverbal i marrjes në pyetje, 13 prill 2012.

kishte kërkuar që të takohen. Ai tha se ishte takuar me V.L. disa ditë pas atij takimi.

Duke iu referuar atij takimi V.L. i tha se M.N. donte të takoheshin në një siç e përshkruajti "mënyrë diskrete" në hotel X. Ai e kuptoi këtë të nënkuptonte se ajo donte të jetë takim i fshehtë. M.N. ishte e njoftuar për hetimet ku ishin të përfshirë ata dhe donte të paraqiste veten se ka një "raport të ngushtë" me N.M.

Gjatë asaj bisede M.N. iu referua një prokurori nga X. M.N. i tha V.L. të i thotë A.G. që të mos kontaktojë N.M.. M.N. ftoi V.L dhe A.G. të takohen me të dhe N.M. në X me qëllim që të "ndërpresin" hetimin.

Ai tha se kishte përshtypje se hetimi do të ndërpritej për përfitim material si shpërblim. Ai tha se V.L. nuk e përmendi ndonjë shumë specifike të parave të jenë përmendur. Kur është intervistuar në prill 2012 ai nuk përmendi para apo, në të vërtetë, ndonjë dobi pasurore. Në fakt, kur është pyetur nga prokurori me atë rast nëse ndonjë përfitim specifik ishte përmendur ai tha "nuk jam i sigurt". Kur dëshmoi para kësaj gjykate dhe kur iu përmend kjo mospërputhje ai tha se thjeshtë ka supozuar se do të ketë shpërblim financiar për ndërprerjen e procedurës.

Ai tha se nuk është intervistuar nga N.M. asnjëherë.

Ai nënshkroi Kërkesën e datës 13 shkurt 2012 për përkushtimin e N.M. nga hetimet në rastin ndaj tij. Ai tha se të tre nënshkruesit kontribuuan në përpilimin e letrës

Prokurori thirri A.Lu. Ai u morr në pyetje nga prokurori më 6 prill 2012. Ai dha dëshmi para kësaj gjykate më 13 shkurt

2013.

Që nga qershori 2010 ai ka qenë Kryeprokuror i Zyrës së Prokurorisë Komunale, tash Kryeprokuror i Qarkut në Prishtinë. Ai është vëllai i A.L.

Ishte dëshmia e tij se në maj 2010, ai mori një telefonatë nga N.M.. Ai e njihte N.M. si koleg dhe kishte marrë pjesë në disa kurse trajnimi me të. Me kërkesë të N.M., ata u takuan për kafe.

A.Lu. dha dëshmi që R.Z. dhe X.Z. ishin të pranishëm në atë mbledhje dhe që N.M. ja prezantoi ata atij. Ai i tha A.Lu. që ata kishin bërë kërkesë për kredi tek banka X. N.M. me sa duket e dinte që i vëllai A.L. punonte në Bankën X sepse ai pyeti A.Lu. nëse ai do ti fliste A.L. dhe ti kërkonte atij që të miratonte kredinë. Shuma në fjalë ishte përafërsisht 2 milion Euro. Ishte dëshmia e tij që ai i tha N.M. që ai do të fliste me vëllain e tij.

N.M. i përshkruajti vëllezërit Z. si vëllezërit e tijë.

Disa ditë pas kësaj mbledhjeje ai pranoi telefonatë nga një prej vëllezërve Z. i cili i tha atij që N.M. kish sugjeruar që ta kontaktonte atë. Ai identifikoi X.Z. si personin që ai më pastaj takoi. Ai i tha X.Z. që ai kish diskutuar çështjen me të vëllamë që e kish informuar atë që kredia nuk mund të miratohet. Ai ishte zhgënjyer dhe përsëri kish kërkuar që A.Lu. të flasë me A.L.

Kohë më pas këtij takimi me X.Z., A.Lu. pranoi telefonatë nga N.M. që e pyeti atë se pse kredia nuk ishte miratuar. A.Lu. tha që i shpjegoi arsyet.

Ishte dëshmia e tij që N.M. i tha atij atë, që po qe nevoja, ai do të vinte në hipotekim pronën e tij si garanci për kredinë.⁵⁷

A.Lu. dha dëshmi që disa muaj pas atij diskutimi ai takoi N.M. i cili, duke ju referuar çështjes të kredisë, tha që ai nuk e kish kuptuar që në atë kohë A.L. ishte nën hetim.

Ishte dëshmia e tij⁵⁸ që më apo rreth Majit 2011 A.Lu. i telefonoi N.M. dhe e pyeti nëse ai do të takonte A.L.. N.M. u pajtua. A.Lu. dha dëshmi që foli me A.L. në vijim të takimit të tyre. Atij nuk i rikujtohet data. A.L. i tha A.Lu.t që gjatë atij takimi N.M. i tregoi atij që kishte fletë arrest për të.

A.Lu. dha dëshmi⁵⁹ që ai takoi N.M. më 17 Korrik 2011. Gjatë atij takimi A.Lu. pyeti N.M. për hetimet që përfshinin vëllain e tijë. N.M. i tregoi atij që mund të kishte arrestuar A.L. por për shkak të respektit për familjen e tij nuk e kishte bërë.

A.Lu. shprehu shqetësimin e tij për presionin që ndjente që zbatohet ndaj të vëllait dhe ftoi që N.M. që ja të fajësonte të vëllain ose të ndërpriste hetimin⁶⁰.

A.Lu. dha dëshmi që më apo rreth Tetorit 2011 V.L. shkoi në zyrën e tij dhe i tregoi për takimin me M.N. që kish ndodhur disa ditë më herët. V.L. i tregoi A.Lu. që kish pranuar thirrje telefonike nga M.N. dhe që kish kërkuar që të takohen te Hotel X. V.L. i tregoi A.Lu. që gjatë takimit me M.N. i referoi për hetimin në vazhdimësi kundrejt tij. V.L. i tregoi

⁵⁷ Procesverbali nga shqyrtimi me prokurorin më 6 Prill 2012 [Faqja 433 nga dosja e gjykimit kryesor].

⁵⁸ Procesverbali nga shqyrtimi më 6 Prill 2012.

⁵⁹ Procesverbali nga shqyrtimi më 6 Prill 2012.

⁶⁰ Do.

atij që M.N. dukej që dinte çdo gjë lidhur me çështjen. Ajo ju referua A.G. por A.Lu. nuk i rikujtohej konteksti. V.L. i tregoi atij që M.N. i kish treguar atij kartë biznesi të oficerit policor Zvicëran apo Gjerman i cili punonte me N.M.. Ajo sugjeroi të takohen në Zvicër me qëllim të diskutojnë se si çështja duhej "mbyllur". V.L. i tregoi atij që me gjasë do të jetë e domosdoshme të paguhen para që të ndërpriten hetimet kundrejt A.L., A.G. dhe L.K..

A.Lu. dha dëshmi që e raportoi këtë çështje me Krye Prokurorin I.K. përbrenda disa ditësh të takimit të tij me V.L.

Prokuroria thirri A.G. Ai u shqyrtua nga prokurori më 28 Qershor 2012. Ai u shfaq para kësaj gjykate më 13 Shkurt 2013. Sidoqoftë, palët u pajtuan që deklarata e tij e procedurës paraprake do të mund thjesht të futej në procesverbal.

Që prej 2007 ai ka qenë Kryetari i X.

Ka qenë dëshmia e tij që në Mars 2011 ai ish intervistuar nga policia që po hetonin akuzat për korrupsion në X. Pasi më tej nuk kishte dëgjuar gjë lidhur me çështjen, në Gusht 2011 ai vendosi të kontaktojë prokurorin N.M.

A.G. dha dëshmi që shkoi në zyrat e PSRK dhe kërkoi të flasë me N.M.. Atij ju tha që prokurori nuk qe në dispozicion. Ai la kartën e biznesit por nuk dëgjoi asgjë më. Në Shtator 2011 ai i telefonoi N.M. N.M. i tha atij që ishte me pushime dhe që do ta kontaktojë atë kur të kthehet.

A.G. më pastaj është kontaktuar nga V.L. që i tha atij të mos kontaktojë me N.M. V.L. i tregoi atij për takimin e tij me M.N. gjatë të cilit ajo i kërkoi V.L. ti tregojë A.G. që mos të kontaktojë N.M. Gjatë atij takimi ajo gjithashtu sugjeroi

që të takohen në X.

Duke ju referuar takimit të propozuar në X A.G. tha që kuptimi që kishte ishte që N.M. do të ishte prezent për qëllim të diskutimit për ndërprerjen e hetimeve në këmbim të ndonjë dobie materiale.

A.G. dhe V.L. diskutuan nëse duhej të shkonin për në X. A.G. dha dëshmi që u pajtuan që ata nuk duhej të hynin në ndonjë marrëveshje me prokurorin.

A.G. tha që takoi M.N. në Shkurt apo Mars 2012 për një mundësi komerciale lidhur me bankën.

Ishte dëshmia e tij që në Shkurt 2012 ai ishte fletë thirrur për tek zyrat e PSRK. Ai u ekzaminua nga N.M. në Mars 2012.

Mbrojtësi i N.M. i quajtur B.B. Ai dha dëshmi para kësaj gjykate më 19 Shkurt 2013.

Dëshmia e tij ishte që ai ka njohur N.M. që prej 2010 kur ai u caktua përcjellës policor.

B.B. dha dëshmi se sa herë që një përcjellje caktohet për ndonjë individ kryhet një vlerësim sigurie. Në çështjen e N.M. reziku u vlerësua në "zero". Gjatë gjithë kohës që Oficer B. ishte përgjegjës për N.M. ai nuk kujtohet për ndonjë rast që N.M. ta ketë informuar atë për ndonjë ngjarje që mund të shkaktonte që ai të ngrinte vlerësim rrezikshmërinë.

Ai dha dëshmi lidhur me rastin që ka shoqëruar N.M. tek Restorant X. Ai përshkroi se si është ulur në tavolinë me N.M.n, F.S. dhe personin që e dinte si L. Ai nuk rikujton emrin e tij. Ai tha që gjatë diskutimit Z. L. ju referua të

vëllait që punonte në X.

Ai tha që dy tre ditë pas atij takimi N.M. i kërkoi atij të shkojë në zyrën e tij në një kohë të caktuar sepse po priste një vizitor. Ai tha që kjo nuk ishte e zakonshme. Sidoqoftë, N.M. nuk i tregoi atij se pse nuk e donte atë të ish prezent. Ai tha që arriti në paradhomën e zyrës të N.M. disa minuta para orarit të caktuar. Ai tha që kish ardhur një person me kostum dhe kollare. Ai foli shkurt me N.M. i cili i tha atij që nuk kanë gjë për të diskutuar. Ai tha që peroni në fjalë ishte A.L. Ai tha që ata nuk hynë në zyrën e N.M.. Ai tha që nuk i kujtohej të ketë parë ndonjë dokument në dorën e N.M. Ai tha që A.L. nuk ishte abuziv apo kërcënues në asnjë mënyrë.

B.B. dha dëshmi që në vjeshtë të 2011 ai ishte me N.M. kur ai pranoi një thirrje telefonike nga njëri prej vëllezërve Z. Ai nuk e di se nga cili. Ai tha që vëllai i njëjtë e thirri dy herë. N.M. i tregoi B.B. që vëllezërit i kishin kërkuar ndihmë lidhur me kompaninë. N.M. takoi vëllezërit ndërmjet X dhe X. Ai tha që mendonte që ishin në vështirësi. Ai kurrë nuk ka dëgjuar të përmendin P.M.

B.B. dha dëshmi që N.M. i ka thënë atij që vëllezërit Z. i kishin ofruar ndihmë për trajtimin e djalit të tijë.

Ishte dëshmia e tij që në prezencën e tijë N.M. takoi M.N. disa herë. N.M. i tha atij që ajo ishte një shoqe. Ai e shoqëroi N.M. kur ai takoi M.N. në hotel X apo X. Me sa duket shumica e takimeve ndodhën tek X. Ai nuk kujtohet që M.N. të ketë ardhur në zyrën e N.M.

B.B. dha dëshmi që ai qe përcjellësi i N.M. në ditën e arrestimit të tijë. Ai nuk e pa M.N.

3. Të pandehurit

N.M., R.Z. dhe M.N. ushtruan të drejtën e tyre të mbeten në heshtje dhe të mos japin dëshmi para kësaj Gjykate.

N.M. u ekzaminua nga prokurori më 19 Prill 2012 dhe 10 Korrik 2012.

R.Z. u ekzaminua nga prokurori më 17 Prill dhe 3 Korrik 2012.

M.N. u ekzaminua nga prokurori më 12 Korrik 2012.

X.Z. dha dëshmi para kësaj gjykate më 11, 13 dhe 18 Mars 2013. Ai u ekzaminua nga prokurori më 18 Prill dhe 5 dhe 12 Korrik 2012.

V. VLERËSIMI I DËSHMIVE

1. Të pandehurit

N.M. e shfrytëzoi të drejtën e tij për të heshtur dhe nuk dha dëshmi para kësaj gjykate. Ai ishte marrë në pyetje nga prokurori më 19 prill 2012 dhe 10 korrik 2012.

Ai e pranoi se e njohte R.Z. dhe X.Z. Ai i përshkroi marrëdhëniet e tyre si shokë familjar. Kur ai u intervistua nga prokurori në prill 2012 ai i përshkroi marrëdhëniet e tij me vëllezërit Z. më 2010 dhe 2011 si aspak shoqërore. Ai e përshkroi se ishte bërë vazhdimisht i pakënaqur nga kërkesat e vazhdueshme të vëllezërve Z. për ndihmë financiare. Ai tha se në një kohë ai bile kishte kërcënuar të ndërmyrte veprime ligjore kundër R.Z. për ti ndaluar kërkesat e tij të vazhdueshme për takim.

Si prokuror special do të ishte shumë e lehtë për të që ti shmangej komunikimit me R.Z. ose X.Z. Atij i ishte caktuar një zyrtar për mbrojtje. Në të vërtetë dëshmitë nga komunikimet telefonike në mes të N.M. dhe R.Z. dhe X.Z. dëshmojnë se ata kishin kontakte të shpeshta. Në të vërtetë shumica e këtyre komunikimeve ishin inicuar nga vetë N.M.

Kur ai ishte intervistuar nga prokurori në prill 2012 ai tha se R.Z. dhe X.Z. e kontaktonin shpesh atë në lidhje me problemet që ata kishin me autoritetet. Ai tha se nuk iu kishte ofruar atyre ndihmë por ata vazhdonin ta thërrisnin. Ai pranoi se iu kihte bërë thirrje telefonike vëllezërve Z. por tha se ata kishin lidhje me të birin e tij.

N.M. konfirmoi se djali i tij ishte diagnostifikuar më autizëm. Është e mundshme që disa komunikime ishin bërë me qëllim të diskutimit për djalin e tij. Në të vërtetë në disa komunikime të përgjuara referenca specifike i ishin bërë djalit të N.M.. Megjithatë këto ishin më shumë referenca kalimtare. Të paktën gjatë një bisede ishte përmendur mjeku. Kjo ishte po ashtu një reference kalimtare.

Ai po ashtu dëshmoi se R.Z. dhe X.Z. e kishin kontaktuar atë në lidhje me nje fabrikë që dëshironin ta ndërtonin. Ata i thanë N.M. se dëshironin ta kishin përkrahjen e tij personale.

Kur u mor në pyetje në prill 2012 N.M. u pyet nëse kishte pasur para sysh ndonjë shtet të veçantë në të cilin ai mund të dërgonte djalin e tij për trajtim mjekësor. Ai u përgjigj me jo.

Megjithatë, kur u insistua në këtë çështje ai tha se ishte sugjeruar që ta dërgonte djalin e tij në X apo në X. Ai pastaj

e pranoi atë, në fakt ai kishte pasur kontakte me një spital në X në lidhje me trajtimin e djalit të tij dhe ai po priste konfirmimin për termin.

N.M. e mohoi se ai kishte diskutuar me R.Z. ose X.Z. mundësinë e dërgimit të djalit të tij në Itali për trajtim. Ai tha se vëllezërit Z. i kishin sugjeruar atij një mjek në X. N.M. se më parë e kishte sjell një *sheh* (shërues natural) në shtëpinë e tij.

N.M. mohoi se kishte marrë para nga R.Z. ose X.Z. më 2010 ose 2011 - as si hua e as si pagesë për trajtimin e djalit të tij. Në të vërtetë ai e mohoi të ketë pranuar ndonjë përfitim material nga R.Z. dhe X.Z. Ai më tej mohoi të kishte pranuar gjatë asaj kohe ndonjë para ose përfitim tjetër material prej ndonjë personi tjetër.

N.M. u pyet *"a e di nëse vëllezërit Z. po ashtu e njohnin P.M.n...[më] 2010 dhe 2011"* Në përgjigje ai tha *"Jo, nuk e kam dituar se ata e njohnin atë"*. Megjithatë, në përgjigje të pyetjes tjetër në lidhje me vëllezërit Z. dhe P.M., N.M. tha *"Ata e kanë përmendur atë, ata thanë se e njohnin atë..."* Këto përgjigje ishin plotësisht kontradiktore.

Në të vërtetë, mohimi i tij fillestar se R.Z. dhe X.Z. e njohnin P.M., kundërshtohet nga dëshmitë e tij të mëtejme.

N.M. pastaj dëshmoi se vëllezërit Z. po *"...insistonin se unë i ndihmoja P.M., jo për ta akuzuar atë, sepse P.M. kishte për qëllim që të kthehej në vendin e tij të mëparshëm të punës."*

Pavarësisht mohimit të tij fillestar se ai e dinte se vëllezërit Z. e njohnin P.M. më 2010 dhe 2011, ishte dëshmia e tij se ose para apo gjatë arrestit shtëpiak të P.M. më 2011,

R.Z. e kishte vizituar shtëpinë e tij dhe i kishte thënë "N., të lutem ndihmoje P., ai i ka disa shokë në X ose në X dhe ata do të ndihmojnë ty në lidhje me djalin tënd. Ata kanë para dhe ata po ofrojnë para prej 50,000 Euro". Ai tha se ishte përgjigjur duke thënë "Dil nga shtëpia ime; Nuk dua më ti shohë sytë nëse vjen për ndonjë arsye të tillë". Ai tha se R.Z. i kishte treguar atij se atë e kishte dërguar P.M.

Kjo është në kundërshtim me atë që ka thënë R.Z. P.M. ishte në arrest shtëpiak prej 2 marsit deri më 27 prill 2011. Kur aui ishte marrë në pyetje nga prokurori në prill 2012, R.Z. kishte dëshmuar se gjatë një takimi me P.M., pas lirimit të tij nga arresti shtëpiak, ata e kishin diskutuar sëmundjen e djalit të N.M. Ai tha se P.M. kishte ofruar të paguante shumën prej 50,000 Euro për trajtimin e djalit të N.M. Ai nuk e përmendi të kishte vizituar N.M. apo tja kishte përcjellë këtë ofertë.

X.Z. dëshmoi se ai e kishte informuar N.M. me telefon për ofertën gjoja të bërë të P.M.

Dëshmitë e të dyve, të N.M. dhe R.Z. në lidhje me shumën prej 50,000 Euro për të cilën thanë se ua kishte ofruar P.M., gjersa është në shpërputhje, kundërshtohet nga P.M. Dëshmia e P.M. vërtetohet nga avokati i tij T.G.

Së pari, T.G. dëshmoi se në takimin e tij të parë me P.M. në mars 2011, P.M. i kishte thënë atij se dikush duke vepruar në emër të prokurorit kishte kërkuar 50,000 Euro. Kur T.G. u intervistua në Prill 2012 ai nuk tha se kush kishte kërkuar nga P.M. 50,000 Euro. Mëgjithatë, më vonë në dëshminë e tij se ai nuk u kishte dhënë 50,000 Euro "këtyre vëllezërve". Gjykata vlerëson se ai po i referohej R.Z. dhe X.Z. T.G. e kishte pasur këtë bisedë më P.M. disa muaj përpara se R.Z. kishte

thënë se P.M. i kishte ofruar 50,000 Euro për trajtimin e djalit të N.M.

Së dyti, R.Z. dëshmoi se afërsisht 4 ditë pasi P.M. ishte paraburgosur, ai ishte takuar me N.M. që i kishte thënë se T.G. e kishte informuar atë se P.M. e kishte akuzuar N.M. për kërkesën e ryshfetit prej 50,000 Euro. Ajo bisedë kishte ndodhur para se Z. kishte thënë se P.M., në fakt kishte ofruar 50,000 Euro për trajtimin e djalit të N.M. dhe para se N.M. ti kishte thënë R.Z. të vinte në shtëpinë e tij me ofertën në fjalë.

Kur ai u intervistua në Prill 2012 N.M. ishte pyetur nëse T.G. e kishte përmendur akuzën e bërë nga P.M. se ai kishte kërkuar para. Ai tha se T.G. i kishte thënë atij se dikush po merrte para në emrin e tij. Ai tha *"I kam thënë T.G. 'shënojë këtë me shkrim nëse është e vërtetë, I kam informuar mbikyrësit e mi për këtë'"*. Ai tha *"Besoj se e kam paraqitur këtë tek A., që është sekretar i kryeprokurores së prokurorisë speciale"*. Ai e cilësoi këtë duke thënë *"Besoj se e kam paraqitur këtë tek A., që është sekretar i kryeprokurores së prokurorisë speciale..."*. ai tha se kjo ndodhi më 2012.

Dëshmia e T.G. ishte se dikush ishte duke marrë para "në emrin e tij". N.M. dëshmoi së nëse akuzat do të ishin se ai personalisht do të kishte marrë para, ai do të kishte vepruar ndryshe. Megjithatë kjo ishte saktësisht një akuzë. Kur u intervistua në prill 2012 N.M. e përmendi një takim me L.B. gjatë së cilit ishte përmendur rasti i P.M. dhe L.B. i kishte thënë *"ka thashetheme se ti ke marrë para për ta mbyllur rastin"*.

Duke pasur parasysh llojin serioz të këtyre akuzave të shumta, është shumë e çuditshme se nuk ishte përpiluar ndonjë raport zyrtar nga N.M. për ti informuar shefat e tij.

Faktikisht nuk ekziston ndonjë shënim i ndonjë raporti përpiluar nga ose në emër të N.M. apo të ndonjë personi tjetër zyrtar ku do të thuhet se N.M. e ka paraqitur faktin e ofrimit me ndonjë ryshfet ose përfitim tjetër material në çfarëdo rasti në të cilin ai personalisht do të ishte i përfshirë.⁶¹

Në të vërtetë, P.M. ishte i dyshuar në një hetim penal që zhvillohej nga N.M. N.M. dëshmoi se ai ishte i zemëruar kur R.Z. kishte shkuar në shtëpinë e tij me një ofertë prej 50,000 Euro që R.Z. i kishte thënë atij se ishte dhënë nga P.M. Nëse dëshmia e N.M. do të ishte e vërtetë, është shumë bindëse se ai do ngriste një kallëzim penal kundër P.M. ose të paktën ai do ta paraqiste një raport zyrtar.

N.M. dëshmoi se ai vetëm e kishte takuar P.M. në takim zyrtar në zyret e PSRK dhe *"në asnjë rrethanë tjetër përveç intervistave zyrtare"*.

Përveç asaj vizite, P.M. po ashtu kishte shkuar në zyret e PSRK-së dhe ishte takuar me N.M. më 8 dhe 15 shtator 2010. Takimi i parë kishte zgjatur afërsisht 20 minuta. Takimi I dytë kishte zgjatur më shumë se dy orë, në asnjë rast nuk ishte bërë ndonjë shënim zyrtar.

N.M. mohoi se ai kishte kërkuar nga P.M. të bashkëpunonte në rastin e guvernatorit të mëparshëm të X. Në fakt ai tha se ai *"...sa i përket bashkëpunimit kam pasur mjaft të tjerë"*.

⁶¹ Shiko përgjigjen nga kryeprokurori i tanishëm i PSRK-së në shtyllën A të Vëllimit V të shkresave të lëndës në shqyrtimin gjyqësor.

P.M. dëshmoi se gjatë një takimi me N.M. ai i kishte treguar atij një listë të personave që duhej të arrestoheshin. Emri i tij nuk ishte në listë.

N.M. dëshmoi se në qershor apo korrik 2010 ai e kishte përpiluar një listë të personave që duhej të arrestoheshin në rastin e guvernatorit të mëparshëm të X. Ai e mohoi tia kishte treguar listën P.M. Kjo nuk mund të jetë e saktë. Si do ta dinte P.M. se ekziston një listë e tillë po të mos i ishte treguar atij?

N.M. mohoi ta kishte diskutuar ndonjëherë rastin e P.M. me vëllezërit Z. Kjo ishte gënjeshtër. Vëllezërit Z. kishin njohuri për rastin duke përfshirë faktin se kallëzimi penal ishte gati të ngrihej kundër P.M. Kjo informatë ishte e mundshme që të vinte vetëm nga dikush i lidhur ngusht me rastin. Duke pasur parasysh dëshmitë e këtij rasti duke përfshirë dëshmitë telefonike, gjykata vlerëson që N.M. e ka keqpërdor pozitën e tij zyrtare dhe autoritetin duke ua zbuluar këtë informatë vëllezërve Z.

N.M. dëshmoi se ai ishte kontaktuar nga vëllezërit Z. që kishin kërkuar që të ndërpritej arresti shtëpiak. N.M. i mbante në mend në lidhje me një martesë ku dëshironte të shkonte P.M. N.M. dëshmoi se ai e refuzoi kërkesën e tyre. Ai mohoi ta kishte informuar ndonjërin prej vëllezërve Z. që arresti shtëpiak ishte shqiptuar apo rrejdhimisht ishte hequr. Kjo ishte një gënjeshtër.

Është e qartë nga dëshmitë se N.M. e kishte diskutuar me të dy R.Z. dhe X.Z. faktin e arrestit shtëpiak të P.M. dhe që me kërkesën e apo pjesëmarrjen e tyre, ai e kishte parashtruar një kërkesë në gjykatë për ta ndërprerë arrestin shtëpiak.

N.M. e mohoi se ai kishte thënë se do ta ndihmonte P.M. në hetime nëse ai do ti ndihmonte vëllezërit Z. Kjo ishte po ashtu gënjeshtër.

N.M. dëshmoi se fillimisht ai nuk kishte dijeni për kushtet financiare të vëllezërve Z. Ai tha se ishte në dijeni se vëllezërit Z. kishin bërë kërkesa të shumta për kredi. Ai tha se ata i kishin thënë atij se këto kërkesa për kredi ishin refuzuar.

N.M. e shfaqti një nivel të zemërimit kur i përshkruante marrëdhëniet e tij me vëllezërit Z.

N.M. e pranoi se ai ishte takuar me A.Lu. dhe se kishte kërkuar nga ai që të hulumtonte gjendjen e kërkesave për kredi që ishin bërë nga vëllezërit Z. Ishte dëshmia e tij se ai thjeshtë e kishte pyetur A.Lu. që të vërtetonte se kërkesa për kredi i plotësonte kriteret e nevojshme ligjore. Ai e dha pamjen e të qenit i pasigurt rreth rezultatit të këtyre kërkesave për kredi.

Megjithatë, tri aspekte të deklarimit të dhënë nga N.M. nuk përputhen me deklarimin e dhënë nga A.Lu.

Së, N.M. e përshkroi takimin e tij me A.Lu. si krejtë të rastësishëm. Ai e mohoi se e kishin organizuar takimin. N.M. tha se ai ishte ulur në një restoran dhe A.Lu. ishte duke ecur në drejtim të të njëjtit restoran. Megjithatë, A.Lu. dëshmoi se N.M. i kishte telefonuar atij dhe kishte kërkuar të takoheshin.

Së dyti, N.M. e përshkroi se ai ishte i ulur në restoran me një tjetër prokuror F.H. Ai tha se gjatë bisedës me A.Lu., ai i referohej "dy vëllezërve nga X". Megjithatë A.Lu. dëshmoi se

R.Z. dhe X.Z. ishin po ashtu të ulur në restorant me N.M.. Në fakt kjo nuk përbën ndonjë ndryshim material nëse R.Z. dhe X.Z. ishin të pranishëm në atë takim. N.M. e pranoi se ai kishte folur me A.Lu. për kërkesën për kredi që ishte bërë në emër të R.Z. i X Impex.

Së treti, nëse ai, siç ishte munduar ta përshkruante në dëshminë e tij, N.M. ishte i pasigurt rreth rezultatit të hulumtimit nga A.Lu. për kredinë bankare. Është e çuditshme se ai do të telefononte A.Lu. pas takimit në mes të X.Z. dhe A.Lu. kur A.Lu. e informoi X.Z. se kërkesa për kredi nuk ishte e aprovuar për të hulumtuar se përse kërkesa nuk ishte aprovuar. Ai po ashtu ofroi ta vendoste emrin e tij si garanci për kredinë.

N.M. e mohoi se P.M. kishte qenë në lokalet e PSRK-së pa përcjellje nga policia. Megjithatë ai u pajtua se mund të kishte lëshuar autorizimin për P.M. që të shkonte në zyret e PSRK-së pa përcjellje policore.

N.M. dëshmoi se ai e kishte takuar M.N. në Zagreb 5 - 6 vjet para se të arrestohej. Ai i përshkroi marrëdhëniet e tij me M.N. si intime. Ai tha se e kontaktonte atë mjaft shpesh zakonisht duke i dërguar 20 - 30 SMS mesazhe në ditë.

Ai tha se mendohej ti shmangej qëndrimit vetëm me të. Nëse ai do ta takonte, do të sigurohej që zyrtarët e mbrojtjes së tij të afërt të ishin po ashtu të pranishëm. Ai tha se ajo mund ta kishte vizituar atë në zyret e PSRK më 2011 dhe 2012. Ai tha se ajo qëndronte afërsisht për 20 - 30 minuta.

Shënimet nga libri i hyrje-daljeve tregojnë se në mes të 11 tetorit 2011 dhe 30 marsit 2012 M.N. i kishte vizituar zyret e PSRK-së në 8 raste. Më 11 tetor 2011 ajo qëndroi në ndërtesë

për 40 minuta. Më 26 tetor 2011 ajo qëndroi në ndërtesë për 1 orë. Më 29 dhjetor 2011 ajo qëndroi në ndërtesë për 30 minuta. Më 22 shkurt 2012 ajo qëndroi në ndërtesë për 2 minuta. Më 24 shkurt 2012 ajo qëndroi në ndërtesë për 35 minuta. Më 28 shkurt 2012 ajo qëndroi në ndërtesë për 50 minuta. Më 9 mars 2012 ajo qëndroi në ndërtesë për 1 orë dhe 35 minuta. Më 30 mars 2012 ajo qëndroi në ndërtesë për 15 minuta.

Prokuroria po ashtu i vë në dëshmi biletat e fluturimeve dhe një faturë nga Malesia Reisen për pesë bileta aeroplani prej X për në X. Sipas faturave rezervimi ishte bërë nga M.N. Nuk ka dëshmi që M.N. ti ketë paguar biletat. Megjithatë është fakt se ajo po i bënte rezervimet për bileta fluturimi në emër të N.M. dhe familja e tij sugjeron për nivelin e marrëdhënieve të tyre.

N.M. dëshmoi se M.N. dëshironte që ta takonte atë për çdo ditë gjithmonë me pretekstin e diskutimit për shërimin e djalit të tij.

Rregullimet ishin bërë për N.M. që të udhëtonte në X me djalin e tij. Ai tha se "*afati i fundit*" ishte 4 prill 2012. Kjo ishte dita kur ai u arrestua.

Ai u pyet rreth finacimit të shërimit të propozuar. Në përgjigje ai tha se M.N. i kishte thënë atij se shpenzimet do të mbuloheshin nga Kisha katolike.

Ai tha se asnjëherë nuk e kishte diskutuar ndënjërin prej rasteve të tij me M.N. Ai e mohoi se ai kurr nuk ia kishte përmendur asaj hetimet ku përfshihej V.L., A.L., L.K. ose A.G. Ai e mohoi të kishte folur ndonjëherë me M.N. rreth takimit të mësipërm. Ai e mohoi tija kishte treguar asaj ndonjëherë emrat e prokurorëve të Eulex-it që po e monitoronin rastin.

N.M. e pranoi se prokurorët e EULEX-it që po e monitoronin rastin ku përfshihej V.L., A.L., L.K. dhe A.G. ishin E.G. dhe J.S., që të dy shtetas X.

N.M. e mohoi ti kishte treguar M.N. që letërreshtimet ishin lëshuar kundër V.L., A.L., L.K. ose A.G..

Ai dëshmoi se A.G. e kishte kontaktuar atë disa herë. Ai tha se në fillim A.G. e kishte lënë një kartë biznesi për të në zyrën e tij dhe pastaj e kishte thirrur atë me telefon kur ai ishte në pushim. Ai tha se ai ishte shumë i shkurtër dhe i kishte thënë A.G. që të mos e thirrte më.

N.M. ishte pyetur nga prokurori nëse e kishte informuar ndonjëherë M.N. për faktin se A.G. ishte munduar ta kontaktonte atë. Në përgjigje ai tha "*...E kamë pyetur nëse ajo i kishte thënë A. të më thërriste...*" Ai the se kishte menduar se ajo mund ta njihte atë. Ai tha se i kishte thënë M.N. ti tregonte A.G. që të mos e kontaktonte atë.

Ai e mohoi ti kishte sugjeruar M.N. që ajo të kontaktonte V.L., A.L., L.K. dhe A.G. me qëllimin e caktimit të ndonjë takimi në X.

R.Z. nuk dha dëshmi para kësaj gjykate. Ai ishte marrë në pyetje nga prokurori më 17 prill dhe 3 korrik 2012.

Ai është drejtori i vetëm i Impex.

Ai e pranoi se në 2010 dhe 2011 numri i tij i telefonit ishte XXX XXX XXX. Ai tha se e kishte përdor vetëm këtë numër.

Ai dëshmoi se P.M. e kishte kontaktuar atë dhe jo siç kishte pretenduar P.M. se R.Z. e kishte kontaktuar atë.

R.Z. e pranoi se ai kishte pasur një "marrëdhënie shoqërore me" me N.M..

Ai tha se e kishte arritur një marrëveshje me L.N. se ai do ti'a jepte hua atij 20,000 Euro, që do të ktheheshin për 4 muaj. Ai tha se huaja kishte lidhje me biznesin e tij, i Impex. Ai tha se paratë do të ktheheshin me kamatë. Pagesa e parë e kamatës prej 1,600 Euro di ti zbritej L.N. pasi ai do ta pranonte shumën kryesore. Ai tha se e kishte takuar L.N. në qershor të vitit tjetër në lidhje me pagesën tjetër të kamatës. Ai tha se e kishte takuar L.N. në tri raste. Në dy raste kishte qenë vetëm ai dhe L.N. Ai tha se X.Z. nuk ishte i pranishëm në këto takime. Në rastin e tretë P.M. ishte po ashtu i pranishëm.

Ai dëshmoi se kur i kishte marrë paratë prej L.N. ai nuk dinte fare për rastin që zhvillohej kundër P.M. Ai tha se kj ishte çështje private në mes të tij dhe L.N. dhe në këtë nuk ishte i përfshirë P.M.. Kjo ishte gënjeshtër. L.N. dëshmoi se ai ia kishte dhënë 20,000 Euro R.Z. me kërkesën e P.M. Ai dëshmoi se përmes një pale të tretë hetimet kundër P.M. do të pushoheshin dhe ai do të kthehej në vendin e tij të punës si Likuidator i X.

R.Z. dëshmoi se ai nuk e kishte nënshkruar një marrëveshje për kredi me L.N. Ai tha se L.N. "më besonte mua". Megjithatë, dëshmia R.Z. në lidhje me ekzistimin e ndonjë kontrate ishte plotësisht kontradiktore. Gjatë seancës gjyqësore me 9 janar 2013 R.Z. e bëri një paraqitje në gjykatë ku tha se ishte përpiluar një kontratë dhe kopja e tij ishte në një folder të gjelbër që ishte konfiskuar nga policia më 2 prill 2012.

Megjithata dokumenti zyrtar në lidhje me konfiskimin e sendeve e përmend thjesht një folder të gjelber me dokumente. Përmbajtja e folderit nuk është specifikuar individualisht. Në të vërtetë, P.P. dëshmoi se ai e kishte përpiluar një kontratë. Pretendimi i bërë nga by R.Z. se kontrata ishte në folderin e gjelbër që e kishte konfiskuar policia, ishte gënjeshtër.

Më tej, L.N. dëshmoi se *"ne duhej ta përpilonim [një kontratë] por ata kurr nuk u paraqitën. P.M. do të konformonte për përpilimin e kontratës por ata asnjëherë nuk u paraqitën dhe ne nuk e përpiluan kontratën kurrë dhe ky ishte gabimi im i madh."*

Gjykata konsedoron se nuk kishte pasur kontratë. Kjo ishte gënjeshtër e shpikur nga R.Z. me qëllim që kjo të dukej si një marrëveshje e një biznesi të ligjshëm. Nuk kishte ndonjë arsye tjetër pos saj. Gjykata vendosi ta pranonte dëshminë e L.N. e jo të R.Z. në lidhje me pagesën e huas. Gjykata konsideron se L.N. ia kishte dhënë R.Z. 20,000 Euro dhe jo 18,400 siç pretendonte R.Z.

R.Z. dëshmoi se paratë nuk ishin kthyer kurrë. Ai tha se ai nuk kishte folur më L.N. dhe ai e kishte pyetur nëse mund të priste për para e për të cilat that se L.N. ishte përgjegjës "s'ka problem". Kjo ishte gënjeshtër. L.N. dëshmoi se se ai kishte kërkuar që ti ktheheshin paratë' kjo dëshmi ishte vërtetuar nga P.M. Në të vërtetë, kërkesa për kthimin e parave kishte rezultuar që P.M. të mbahej më gjatë në burg.

R.Z. dëshmoi se P.M. i ishte paraqitur atij dhe duke e pasur parasysh faktin që ai ekishte humbur punën në bankë dhe hetimet që po zhvilloheshin, kishte kërkuar ndihmën e tij për të kontaktuar N.M. me qëllim që ai ti pushonte hetimet dhe ta

kthente në vendin e tij të mëparshëm të punës. Ai the se si kompensim do të kërkonte nga L.N. ta ndihmonte atë finaciarisht. Ai tha se e kishte refuzuar këtë ofertë sepse ai tashme e kishte lidhur një marrëveshje me L.N. Ai mendon se kjo ka ndodhur në nëntor të vitit 2010. Kjo ishte gënjeshtër. Sa i përket huas L.N. dëshmoi se *"Ajo ka shkuar përmes P.M. pasi që unë nuk i kam njohur fare. Edhe nëse do të jetoja 100 vjet nuk do ti jepja dikujt hua që nuk e njoh"*.

R.Z. dëshmoi se P.M. e kishte kontaktoar atë gjersa ai ishte në arrest shtëpiak. Ai tha se ai dhe dhe X.Z. e kishin vizituar P.M. në shtëpinë e tij. R.Z. dëshmoi se P.M. përsëri kishte kërkuar nga ata që ta kontaktonin N.M. Ai tha se P.M. kishte kërkuar nga ai që ai ta kontaktonte N.M. që ta lejonte atë që të udhëtonte deri në X pa përcjellje policore.

R.Z. dëshmoi se ai nuk ishte takuar me N.M. dhe që ai kishte kërkuar nga ai që të takohet me P.M. që ta lejonin atë të vinte deri në X pa përcjellje policore. Ai tha se N.M. ishte pajtuar. N.M. e mohoi ta kishte diskutuar ndonjëherë rastin e P.M. me vëllezërit Z.

R.Z. e pranoi se ai i kishte marrë hua 5000 Euro prej G.H. Ai e mohoi se shuma prej 20,000 Euro që ai e kishte marrë nga L.N. ose shuma e 5,000 Euro që ai e kishte marrë nga G.H. të kishin lidhje me rastin e P.M. Kjo ishte gënjeshtër. L.N. dëshmoi se gjatë takimit që kishte pasur me R.Z. dhe X.Z. atij i kujtohej se vëllezërit Z. thoshnin se ata kishin *"njerëz me influencë në X dhe ata mund të kryejnë punë të mëdha "*. Dëshmia se paratë nuk kishin lidhje me rastin e P.M. po ashtu u kundërshtua nga G.H. që dëshmoi se R.Z. i kishte thënë atij *"po mundohem ti ndihmoj P.M. në lidhje me arrestin shtëpiak"*.

Ai tha se paratë që i kishte marrë nga L.N. nuk i ishin dhënë N.M.

R.Z. dëshmoi se shuma prej 18,400 Euro dhe 5,000 Euro që ai e kishte marrë nga L.N. dhe G.H. menjëherë i ishin paguar kompanisë. Në fakt, ai dëshmoi se që të dy shumat ishin paguar në llogarinë e kompanisë "...në të njëjtën ditë ose ditën tjetër". Kompania i kishte disa llogari me të cilat operonte në Raiffeissen bank. R.Z. dëshmoi se vetëm llogaritë e Z. Impex-it ishin mbajtur në Raiffeissen Bank.

R.Z. dëshmoi se shumat e parave ishin paguar në atë llogari, në llogarinë të cilën ai i kishte pranuar. Me fjalë të tjera a e pagoi në llogari shumë prej 18,400 Euro (sipas dëshmisë së tij) dhe 5000 Euro respektivisht.

Nuk është tërësisht e qartë kur L.N. i dha huanë R.Z. L.N. në dëshminë e tij thoshte se kjo ka ndodhur në verë të 2010. Duke i shqyrtuar të gjitha llogaritë bankare që ishin konfisar në lidhje me R.Z. Impex dhe llogarite personale të R.Z. dhe X.Z. për 2010 dhe 2011 gjykata nuk mund të gjen ndonjë depozitë as prej 18,400 Euro ose 20,000 Euro. Në të vërtetë gjykata nuk mundi të gjejë dëshmi me shumë të ngajshme gjatë periudhës në fjalë.

G.H. e tërhoqi shumë prej 5,000 Euro më 10 mars 2011. Ai ia dha këtë shumë R.Z. të njëjtën ditë. Duke i rishikuar llogaritë bankare për vitin 2011 gjykata nuk mund të gjente ndonjë depozitë prej 5,000 Euro. Përsëri, gjykata nuk mundi të gjente ndonjë dëshmi për depozitim në një shumë të ngjshme gjatë periudhës në fjalë.

Nëse këto para do të ishin përdorë për ndonjë qëllim të ligjshëm, nuk do të kishte arsye që R.Z. osë në të vërtetë,

X.Z. do të gënjente për qëllimin për të cilin paratë ishin dhënë dhe pranuar

R.Z. e mohoi të kishte pranuar para të tjera prej P.M. P.M. dëshmoi se ai e kishte marrë një kredi prej 3,000 dhe paratë ia kishte dhënë R.Z. Dëshmitë tregojnë se më 10 shtator 2010 P.M. e kishte marrë një kredi në shumën prej 3,000 Euro nga Bank X..

Gjykata konsideron që R.Z. kishte pranuar prej P.M. shumën prej 3,000 Euro.

Përsëri, edhe nëse këto para do të përdreshin për ndonjë qëllim të ligjshëm, nuk ekziston arsye që R.Z. do të gënjente për pranimin e tyre / ose që do të përpiqej që të fshehte qëllimin për të cilin paratë ishin planifikuar.

R.Z. e mohoi se ai kishte marrë miell nga P.M.. Kjo ishte gënjeshtër dhe ishte kundërshtuar nga dëshmia e X.Z. Në lidhje me miellin X.Z. tha "*[mielli] ishte marrë si hua që do të kthehej në një kohë të caktuar, në kohën që ishte caktuar në marrveshje me R.Z.*".

R.Z. e pranoi se ai kishte komunikime të shpeshta telefonike me N.M. Ai tha se këto komunikime u intensifikuan në 2010 për shkak të sëmundjes së djalit të N.M.

Ai dëshmoi se në 2010 ai e kishte kontaktuar P.M. njëherë me telefon, megjithësi ai tha se P.M. e kishte kontaktuar atë.

Ai dëshmoi se sa herë që e kishte takuar P.M., X.Z. kishte qenë i pranishëm.

Ai dëshmoi se P.M. kurrë nuk i kishte ofruar atij ose X.Z. para me qëllim që hetimet të ndërpriteshin.

Ai e mohoi të kishte pasur ndonjëherë ndonjë komunikim telefonik me P.M. në lidhje me hetimet. Kjo ishte gënjeshtër.

Ai dëshmoi se e vetmja bisedë telefonike që kishte pasur me P.M. ishte për tia uruar ndërprerjen e arrestit shtëpiak. Ai e mohoi ta kishte kontaktuar P.M. me telefon gjatë arrestit të tij shtëpiak. Ai dëshmoi se X.Z. nuk e kishte kontaktuar P.M. gjatë kësaj periudhe. Kjo ishte gënjeshtër. Gjatë periudhës së arrestit shtëpiak të P.M., R.Z. e kishte kontaktuar P.M. në 29 raste. Gjatë periudhës së njëjtë kishte pasur 39 komunikime telefonike në mes të P.M. dhe X.Z.

Ai dëshmoi se se ai kurrë nuk kishte folur me dikë për tia hequr arrestin shtëpiak P.M. Kjo ishte gënjeshtër dhe ishte në kundërshtim me dëshmitë telefonike.

R.Z. e mohoi ta kishte dikutuar ndonjëherë me N.M. çështjen e P.M. për të marrë pjesë në dasmë. Kjo ishte gënjeshtër dhe ishte kundërshtuar nga dëshmitë e përgjimeve telefonike.

R.Z. e mohoi të kishte folur ndonjëherë me N.M. në lidhje me hetimet.

Ai dëshmoi se 4 ditë pasi që ishte paraburgosur P.M. ai e kishte takuar N.M. që i kishte thënë atij se T.G. e kishte informuar atë se P.M. e kishte akuzuar N.M. për kërkimin e ryshfetit prej 50,000 Euro.

R.Z. dëshmoi se gjatë takimit me P.M. pas lirimit të tij arresti shtëpiak ata e kishin diskutuar sëmundjen e djalit të

N.M. Ai tha se P.M. kishte ofruar 50,000 Euro për shërimin e djalit të N.M.

Dëshmia e R.Z. në lidhje me gjoja ofertën e P.M. për të paguar 50,000 Euro kundërshtohet nga dëshmitë e tjera të cilat janë përmendur këtu.

Ai dëshmoi së më apo rreth 8 marsit 2011 ai e kishte pranuar një thirrje telefonike prej S.M. që kërkonte të takoheshin. Ai tha së ai në atë kohë ishte në X.

R.Z. e mohoi të ishte takuar ndonjëherë me S.M. Ai tha "*...ai nuk jeton këtu por jashtë shtetit*". Kjo ishte gënjeshtër. Në të vërtetë, X.Z. dëshmoi para gjykatës se ai dhe R.Z. e kishin takuar S.M. në shtëpinë e P.M..

R.Z. dëshmoi se se ai e kishte marrë një kredi prej 1.7 milion Euro dhe një tjetër prej 200,000 Euro si një mbitërheqje e miratuar nga X Banka. Megjithëta paratë nuk i ishin dhënë. Ai kishte folur me N.M. që kishte thënë se ao do të fliste me A.L. për të parë se përse nuk i ishin dhënë paratë. Ai tha se N.M. pastaj i kishte thënë atij për bisedën që kishte pasur me A.L.. Është e mundshme që vëllezërit Z. mund të kenë kërkuar nga N.M. ndihmë juridike në lidhje me kërkesën për kredi të bërë nga kompania që drejtohej nga R.Z. Megjithatë fakti se ata kërkonin nga N.M. të kontaktonte bankën me qëllim që ta vlerësonte statusin e kredisë, tregon se sa thellë ishin ndërlidhur çështjet e tyre personale.

Ai tha se më 2010 dhe 2011 ai e kishte vizituar N.M. në zyret e PSRK-së "shpesh". Ai tha se X.Z. asnjëherë nuk kishte shkuar me të. Kjo ishte gënjeshtër. Shënimet nga libri i hyrje-daljeve të PSRK-së tregojnë që më 20 shtator 2010 R.Z. kishte hyrë në ndërtesë në orën 14:10 dhe kishte dalë në 15:10. X.Z.

erdhi dhe u largua saktësisht në të njëjtën kohë. Në të vërtetë X.Z. e pranoi se ai dhe R.Z. e kishin takuar N.M. në zyret e PSRK-së më 2010.

Ai dëshmoi se në mes të shtatorit dhe dhjetorit 2010 ai e takonte çdo ditë N.M.⁶² Ai tha se këto takime kishin të bënin me djalin e N.M. Ai dëshmoi se gjatë periudhës së njëjtë kohore ai kishta pasur pothuajse çdo ditë biseda telefonike me N.M.. Ai tha se ai zakonisht i telefononte N.M.. Ai tha se më 2011 ishin takuar një herë në javë dhe kishin komunikuar me telefon pothuaj çdo ditë. Ai tha se pothuajse gjithmonë i telefononte N.M.

Regjistrimet telefonike tregojnë se N.M., R.Z. dhe X.Z. kishin biseda telefonike me njëri-tjetrin gjatë vitit 2010 dhe 2011. Shumica e komunikimeve ishin në mes të R.Z. dhe X.Z. Në 2010 kishte komunikime të shpeshta telefonike në mes të N.M., R.Z. dhe X.Z. Komunikimet ishin më të shpeshta në 2010 se në 2011. Në të vërtetë, N.M. i iniconte shumicën e komunikimeve telefonike.

R.Z. e pranoi se në 2010 dhe 2011 ai e kishte kontaktuar N.M. në numrin e tij personal në zyret e PSRK-së.

X.Z. dëshmoi në këtë gjykatë më 11, 13 dhe 18 mars 2013. Ai u mor në pyetje nga prokurori më 18 Prill dhe 5 dhe 12 korrik 2012.

Në fillim të dëshmisë së tij në këtë gjykatë X.Z. e konfirmoi saktësinë e dëshmisë së tij të mëparshme.

⁶² Faqe 9 e Procesverbalit të marrjes në pyetje me prokurorin special më 12 korrik 2012.

Ai e përshkroi profesionin e tij si shofer i punësuar nga X Impex. Ai tha se ishte përgjegjës për "çështjet e transportit". Ai tha se vëllai i tij R.Z. ishte drejtori i vetëm i R.Z. i X. Impex. X.Z. tha se ai nuk ishte i përfshirë në çështjet financiare ose bankare të R.Z. i X. Impex.

Kur ai u mor në pyetje nga prokurori ai dëshmoi se në 2010 dhe 2011 ai e përdorte nr. e telefonit XXX XXX XXX. Ai tha se në 2010 ai ishte i vetmi që e përdorte këtë numër. Megjithatë më vonë gjatë ekzaminimit në përgjegje të pyetjes së bërë nga avokati i tij mbrojtës, ai tha se edhe punëtorët e tjerë të X Impex e përdorin poashtu telefonin e tij. Kur ai e dha dëshminë e tij në këtë gjykatë, duke iu referuar vitit 2010, ai tha se "gjatë shumicës së kohës" ai e kishte përdorur atë numër telefoni. Ai tha se në 2011 ai ishte në Shqipëri prej marsit deri në "fund të vitit" dhe ai nuk e kishte pasur këtë telefon me vete. Ai tha se ai nuk e kishte përdorur këtë numër telefoni gjatë asaj periudhe. Ai tha se nuk e dinte ku ishte telefoni dhe mendoi se mund ta kishte lënë në punë. Në fakt telefoni ishte konfiskuar gjatë kontrollit të shtëpisë së tij më 15 Shkurt 2012.

Kur u mor në pyetje nga prokurori në prill 2012 ai u pyet: "A e përdorte dikush tjetër pos teje telefonin tënd në 2010 dhe 2011, apo vetëm ti?" në përgjigje X.Z. tha "Deri në fund të 2010 e përdorja unë. Pastaj në 2011 nuk e kam marr me vete fare..."

Natyrisht është e mundshme që telefoni të përdorej rastëshi prej ndonjë personi tjetër. Megjithatë nëse telefoni përdorej shpesh ose rregullisht nga punëtorët e tjerë të X Impex, është logjike që X.Z. do të thoshte, që kur ishte i intervistuar në atë rast. Gjykata gjen se në 2010 dhe 2011 X.Z. ishte shfrytëzuesi i vetëm ose kryesor i këtij numri telefoni mobil.

Ai tha se më 2011 ai nuk e kishte përdor këtë numer telefoni. Kjo ishte gënjeshtër.

Kur ai e dha dëshminë para kësaj gjykate ai the se numri i telefonit në fjalë nuk ishte funksional. Ai tha se SIM karta ishte parapaguese. Ai tha se kontratat telefonike ishte ndërprerë në fund të vitit 2010. Ai tha se ishte "e pamundshme" të bëheshin thirrje duke e përdor atë numër, por tha se ishte e mundshme që të pranoheshin thirrjet. Kjo dëshmi u kundërshtua plotësisht nga dëshmitë telefonike që provonin se thirrjet ishin bërë prej atij numri gjatë vitit 2011 dhe 2012. Gjykata gjen se numri i telefonit ishte në përdorim gjatë vitit 2011 dhe 2012.

Ai tha se e kishte njohur P.M. që prej gushtit 2010. Ai tha se N.M. u njoftua se ata ishin shokë të P.M. gjatë kohes që ai ishte në arrest shtëpiak.

Kur X.Z. dha dëshminë para kësaj gjykate ai u pyet nëse kishte pasur ndonjë komunikim telefonik me P.M. gjatë 2010 dhe 2011. Ai tha se nuk e kishte përdor telefonin për ta thirrur P.M. Ai tha se ndoshta kishte raste kur R.Z. e kishte përdor telefonin e tij për ta thirr P.M. Kjo ishte gënjeshtër që u kundërshtua nga dëshmitë e përgjimeve telefonike që janë referuar këtu.

Më tej, ka pasur raste kur R.Z. do ta përdorte telefonin e tij për ta kontaktuar N.M. dhe që komunikimi telefonik menjëherë do të pasohej nga një komunikim telefonik në mes të X.Z. dhe P.M. Nëse që të dy komunikimet do të ishin bërë nga nga R.Z. atëherë ai nuk do ti përdorte dy telefonat. Kjo është shume e dyshimtë duke pasur parasysh faktin që numrat që i posedonte R.Z. dhe X.Z. ishin përdor për ta kontaktuar N.M. dhe P.M.

Kur ai u mor në pyetje nga prokurori prill 2012 ai dëshmoi se kurrë nuk e kishte thirrë P.M. Ai tha se gjithmonë ishte P.M. që e thirrte atë. Kjo ishte gënjeshtër. Në mes të gushtit 2010 dhe prillit 2011 ai e kishte kontaktuar P.M. me telefon përafërsisht në 68 raste.

Më 2011 ai shpesh e përdorte telefonin e tij për ta kontaktuar R.Z. Duke e përdorë atë numër ai e kishte kontaktuar N.M. në disa raste. Ai po ashtu e kishte përdorë këtë numër për ta kontaktuar P.M.

Kur ai ishte marrë në pyetje nga prokurori ai tha se pas shkurtit 2011 ata më nuk kishin pasur më kontakte me P.M. Në lidhje me periudhën pas shkurtit 2011 ai tha *"...nuk e kam dëgjuar më kurrë në telefon. Ai mund të ketë folur me vëllain tim R.Z. por unë nuk jam informuar."* Në fakt ai e mohoi të kishte pasur nonjë bisedë me P.M. në 2011. Kjo ishte gënjeshtër. Sipas dëshmive telefonike gjatë periudhës mars - prill 2011 kishin ekzistuar komunikime të shpeshta telefonike në mes të P.M. dhe X.Z.

Kur ai u mor në pyetje nga prokurori në prill 2012 ai e përmendi një dasmë ku dëshironte të shkonte P.M. Në atë kohë P.M. ishte në arrest shtëpiak. X.Z. dëshmoi se se P.M. e kishte thirrur 30 herë. Kur ai dëshmoi para kësaj gjykate ai e pranoi se kishte folur me P.M. për dasmë por tha se nuk e kishin diskutuar këtë çështje përmes telefonit. Megjithatë kjo u kundërshtua nga dëshmitë që ai ia dha prokurorit në Prill 2012 kur ai tha se e kishte diskutuar çështjen e dasmës me P.M. në telefon. Në të vërtetë, dëshmitë që ai i dha kësaj gjykate kundërshtohen në dëshmitë telefonike.

Ai dëshmoi se në 2010 ai ishte me R.Z. në një restoran në X kur e kishin takuar P.M. dhe L.N. Ai e përshkroi këtë si takim të rastësishëm. Ata i diskutuan vështirësitë financiare të R.Z. i Impex. Ai tha se kjo ishte hera e parë që ai e kishte takuar P.M. Kjo ishte gënjeshtër. L.N. dëshmoi se ai dhe P.M. ishin pajtuar që të takoheshim. Ai tha se ata e takuan R.Z. dhe X.Z. L.N. tha se takimi kishte ndodhur pasi që P.M. kishte kërkuar prej atij një hua prej 20,000 Euro.

X.Z. tha se L.N. ishte pajtuar që tja jepte 20,000 Euro për tu kthyer me kamatë. Ai tha se L.N. faktikisht ia dha R.Z. 18,400 Euro. Bilanci ishte zbritur automatikisht që e tregonte pagesën e kamatës. Kohëzgjatja e kredisë ishte katër muaj. Paratë nuk ishin kthyer gjatë asaj kohe dhe ai dëshmoi se L.N. u bë agresiv. Dëshmia e tij në lidhje me reagimin L.N. për dështimin e pagesës së kredisë, është në kundërshtim të plotë me dëshmitë që ka dhënë R.Z. në këtë çështje.

Ai dëshmoi se pagesa e kamatës i ishte bërë L.N., por kredia e plotë kurrë nuk ishte kthyer.

Ai tha se R.Z. i kishte marrë 5000 Euro prej G.H. Ai tha se R.Z. i kishte thënë atij se paratë ishin hua.

Kur ai u mor në pyetje nga prokurori ai e përshkroi marrëdhënien e tij me N.M. si "shumë shoqërore". Kur ai dëshmoi para kësaj gjykatë ai tha se N.M. ishte një "shok i nderuar i familjes". Ai i përshkroi marrëdhëniet në mes tij, R.Z. dhe N.M. që u përkeqësuan e pastaj ata shkuan te N.M. me një ofertë prej P.M. për një përfitim material.

Ai dëshmoi para kësaj gjykate se ai e kishte njohur N.M. për "shumë vite". Para vitit 2010 ai fliste me telfon me N.M. vetëm në disa raste të pakta. Ai tha se takimet ishin të

rrala. Ai tha se 2010 ai kishte folur me N.M. me telefon në ndoshta një ose dy raste. Më 2011 ai tha se ishte takuar shumë rrallë me N.M. dhe kishte folur me të në telefon vetëm pak herë.

Kur ai u mor në pyetje nga prokurori më 2012 ai the se nuk i kujtohej asnjë rast i vetëm në 2010 dhe 2011 kur N.M. ta kishte kontaktuar me telefon. Provat telefonike tregojnë se gjatë periudhës qershor 2010 deri në Prill 2011 ai kishte pasur komunuikime telefonike me N.M. në afërsisht 41 raste.

Ai dëshmoj para kësaj Gjykate që R.Z. mund të ishte prezent gjatë ndonjë takimi që ai kishte me N.M. Kur ai ishte dëgjuar nga Prokurori në muajin Prill të vitit 2012, ai deklaroi që R.Z. kishte qenë prezent në çdo takim që ai kishte pasur me N.M.

Ai dëshmoi që rreth muajit Mars apo në Prill të vitit 2011, P.M. i kishte thënë që ai është nën hetime. Ai tha që Prokurori i rastit ishte N.M. Ishte dëshmimi i tij para kësaj Gjykate që P.M. i kishte treguar atij që mund të paguante 50,000 Euro "që të rikthehet në pozitën e likuidatorit". Siç duket, P.M. në asnjë moment nuk kishte kërkuar pushimin e hetimit.

Ai deklaroi që ai kishte njoftuar N.M. nëpërmes telefonit që P.M. kishte ofruar këtë shumë. Ai tha që N.M. i kishte thënë që mos ta telefonon më lidhur me këtë çështje. N.M. kishte dhënë tjetër dëshmi. Ai deklaroi që R.Z. kishte vizituar shtëpinë e tij dhe i kishte treguar atij që P.M. kishte ofruar 50,000 Euro që të ndihmoi në pagesën rreth birit të tij.

Ai dëshmoi që P.M. gjithnjë kishte bërë kërcënime. Kur ai është pyetur rreth këtyre kërcënimeve të ashtu-quajtur, ai tha që P.M. kishte kërkuar ndihmë nga ata lidhur me N.M., dhe si

këmbim, ai do të fliste me L.N. lidhur me të hollat që ata ia kishin borxh.

Ishte dëshmia e tij që ai asnjëherë nuk ishte akorduar që të jetë lidhja nëmës të P.M. dhe N.M. Ai deklaroi që në asnjë moment, N.M. nuk kishte diskutuar hetimin penal kundër P.M. Ai tha që ai asnjëherë nuk e kishte pyetur N.M. për informacionet lidhur me P.M. Ai deklaroi që N.M. në asnjë moment nuk e kishte përmendur emrin e P.M. Ai dëshmoi që ai asnjëherë nuk ishte ofruar që të afrohet Prokurorit, ose në të vërtetë, ndokënd tjetër për të pushuar këtë lëndë. Kjo ishte një gënjeshtër e cila ishte në kundërshtim me provat të tjera, në të cilat iu referohemi këtu.

Ai dëshmoi para kësaj Gjykate që N.M. në asnjë moment nuk kishte kërkuar nga ai që të kontakton P.M. Ai deklaroi që N.M. në asnjë moment nuk kishte kërkuar nga ai që të kërkonte para nga P.M.

Ai deklaroi që ai nuk ishte prezent gjatë bisedave nëmës të P.M. dhe N.M.

Ai deklaroi që P.M. kishte njohuri që ai ishte shokë me N.M. sepse P.M. me siguri e kishte parë atë me N.M. dhe bashkëshorten dhe birin e N.M., në një restorant në X.

Ai është pyetur për arsyen që ai kishte komunikuar me N.M. Ai deklaroi që kjo bisedë kishte lidhje vetëm rreth vështirësive me biznesin e tyre, X Impex. Ai deklaroi që ata nuk kishin diskutuar asgjë tjetër.

Megjithatë, kur ai është dëgjuar nga Prokurori në muajin Prill të vitit 2012, ai deklaroi që ai kishte diskutuar me N.M. çështjet rreth tretmanit të birit të N.M. Në atë rast, ai

ishte pyetur rreth natyrës së sëmundjes që kishte goditur të birin e N.M. Duke u përgjigjur, ai deklaroi *"Besoj që bëhet fjalë për sëmundje mendore"*. Ai as që kishte njohuri për natyrën e sëmundjes. Kur atij ishte parashtruar po e njëjta pyetje gjatë gjykimit, ai deklaroi që ai nuk kishte njohuri rreth natyrës së sëmundjes së të birit. Në të vërtetë, duket që as X.Z., e as R.Z. kishin njohuri natyrën e saktë, apo nivelin në të cilin ishte ajo sëmundje e birit të N.M. Kjo është për t'u befasuar pasi që ata kishin dëshmuar që komunikimi me N.M. mund t'i atribuohet diskutimeve lidhur me tretmanin e propozuar të birit të N.M.

Kur ai ishte dëgjuar nga Prokurori, ai deklaroi që ai ishte takuar me N.M. në X. Ai deklaroi që ai dëshironte të diskutoi lëndën e P.M., por N.M. refuzoi.

Sipas provave të dëshmive telefonike, është qartë që X.Z. dhe R.Z. janë takuar me N.M. për të diskutuar lëndën e P.M. Disa takime të tilla kishin ndodhur.

X.Z. pohoi që R.Z. kishte vizituar P.M. në shtëpinë e P.M.

X.Z. dëshmoi para kësaj Gjykate që P.M. asnjëherë nuk i kishte thënë që ai kishte qenë i intervistuar nga Prokurori. Edhe kjo ishte një gënjeshtër.

Me datën 19 Prill të 2011 P.M. është dëgjuar nga N.M. në PSRK. Ai është larguar nga PSRK në ora 13:25. Në ora 17:40 X.Z. bëri thirrje telefonike P.M.. Biseda zgjati 1 minutë. P.M. deklaroi *"Isha aty dhe ai më pranoj mirë, dhe më premtoj që sot do të parashtronte kërkesën për ndërprerje të arrestit..."* Është e qartë që ai iu është referuar arrestit shtëpiak. X.Z. është përgjigjur duke thënë *'Më vjen mirë që të paska pranuar mirë'.* *'Ne jemi duke ardhur në X'.*

Kur ai dëshmoi para kësaj X, ai deklaroi që kur ai kishte shkuar në shtëpinë e P.M., ai i kishte thënë që është nën arrestin shtëpiak.

Megjithatë, kur ai është dëgjuar nga Prokurori në muajin Prill të vitit 2012, ai kishte deklaruar që ai nuk ishte në dijeni që P.M. ishte në arrest shtëpiak. Kjo gjë ishte një gënjeshtër.

Ai dëshmoj para kësaj Gjykate që ai asnjëherë me askënd, nuk e kishte diskutuar nëpërmes telefonit çështjen e arrestit shtëpiak të P.M.. Në fakt, ishte dëshmimi i tij në të cilin tregoj që ai as nuk e ka ditur që P.M. ishte në arrestin shtëpiak. Edhe kjo gjë ishte një gënjeshtër.

Me datën 19 Prill të vitit 2011 në ora 22:07, X.Z. i telefonoi P.M. dhe i tha *"Vetëm dëshirova t'ju tregoj që çdo gjë është përfunduar dhe i erdh fundi." 'Për të tjerat do të shohim, por nuk ka nevojë për asgjë në këtë drejtim'. 'Ai e parashtroi sot. Ai tha që e kishte shkruar dhe nesër, kjo gjë të shkonte në vendin e vetë"*.

Me datën 24 Prill të vitit 2011 në ora 19:36-19:36 X.Z. i telefonoi N.M. dhe i tha *"N., një shoku ynë paska martesë, a ka mundësi ai që të shkon nesër?" 'A e ke shikuar këtë çështje?', 'Merre. Përfundo këtë çështje.'" N.M. është përgjigjur 'Nuk e di nëse ai mundet'. 'Ok'.*

Po të mos kishte njohuri X.Z. që P.M. ishte nën arrestin shtëpiak, perse ai do të diskutonte me N.M. çështjen e autorizimit për P.M. rreth pranisë e tij në martesë.

Me datën 26 Prill të vitit 2011, N.M. parashtroi Gjykatës e Qarkut në Prishtinë një Kërkesë për ndërprerje të Arrestit Shtëpiak kundër P.M. Me datën 27 Prill 2011, Gjykata lëshoi Aktvendimin mbi ndërprerje të arrestit shtëpiak.

Me datën 28 Prill të vitit 2011 në ora 17:27-17:28 R.Z. bëri thirrje P.M. dhe i tha *"Urime. N. do të pimë kafe. E kam parë, e kanë nënshkruar. Tani prit, dikush do ta sjell atë në shtëpinë tënde". 'Tani jam këtu me këta burra, Ai më tha që e kishte dërguar atë, por ka pyetur në qoftë se ai mund ta dorëzoj atë nesër në shtëpinë tënde. Ai tha që ai është i lirë."* Në ora 18:02 X.Z. telefonoi P.M. dhe tha *"Urime!", 'A e ke pranuar atë'*

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate X.Z. deklaroi që ai nuk kishte dijeni se kur është ndërprerë arresti shtëpiak. Kjo gjë ishte një gënjeshtër. Gjatë bisedës e tyre telefonike të datës 19 Prill 2012 X.Z. dhe P.M. qartazi iu referoheshin urdhrit për ndërprerje të arrestit shtëpiak.

Kur ai është dëgjuar nga Prokurori, X.Z. dha dëshmi që ai asnjëherë nuk e kishte takuar S.M.n. Megjithatë, në momentin kur ai dha dëshmi para kësaj Gjykate, ai tha që e kishte takuar.

Në momentin kur ai dha dëshmi para kësaj Gjykate, X.Z. mohoi që gjatë ndonjë bisede telefonike me P.M. ishte përmendur emri i avokatit të tij, T.G. Kjo gjë ishte një gënjeshtër.

Me datën 17 Prill të vitit 2011 në ora 16:35 P.M. bëri thirrje X.Z.. Në ora 18:46 X.Z. bëri thirrje N.M.. Në ora 20:18 P.M. bëri thirrje X.Z. dhe i tregoi *"E kam takuar T. dhe e ftova që të vjen të flasim."* *'Vetëm isha i brengosur (për atë gjerën tanë?)* X.Z. është përgjigjur: *'I bëra thirrje dhe nesër do te*

duhet të flasim edhe njëherë. Kemi folur.' 'Jemi akorduar për atë gjë, ajo gjë është e rregulluar'.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate, X.Z. mohoi që i kishte thënë P.M. të mos diskuton rreth bizneseve të tyre me T.G.. Edhe kjo gjë ishte një gënjeshtër.

Me datën 17 Prill të vitit 2011 në ora 20:24-20:25 X.Z. prapë i telefonoi P.M. dhe i tregoi "A i ke treguar T. rreth neve, dhe rreth asaj që të kishim thënë' 'Për atë gjë'. 'Në qoftë se ai merr vesh, do të humbim, por edhe ti do të humb.' 'Është një katastrofë sepse ai është shumë i ndjeshëm." P.M. është përgjigjur: 'Jo, burrë'. 'Jemi akorduar për atë gjë, kjo kuptohet'.

Gjykata gjen që gjatë kësaj bisede X.Z. dhe P.M. iu referoheshin diskutimeve rreth hetimit penal kundër P.M.

X.Z. tregoi që përderisa ai ishte në X, ai kishte pranuar një thirrje telefonike nga S.M. i cili bënte kërcënime në rast që P.M. qëndron edhe një natë në burg. Prokurori i bëri pyetje nëse S.M. mendonte që ai ishte përfshirë në rast. Në përgjigje, X.Z. tha "Jo, vetëm sepse unë kisha një borxh, një obligim X dhe ai insistoi që të kthehem nga X për në X". Ai tha që i kishte thënë S.M. "Nuk munden sepse këtu jam në spital". Kjo ishte njëri nga pohimeve më bizare në këtë lëndë. Është një gjë e papërshtatshme që S.M. do të kishte, në provë të X.Z., të bëhet aq i shqetësuar rreth një marrëdhënie kontraktuese të biznesit nëmës të vëllezërve Z. dhe L.N., e cila nuk ka lidhshmëri me këtë çështje. Megjithatë, fakti është që R.Z. dhe X.Z. janë kthyer në Kosovë të nesërmen.

Kjo gjë është plotësisht në përputhshmëri me dëshmimin e S.M., i cili deklaroi që me datën 28 Shkurt të vitit 2011, ai është

njoftuar për arrestimin e P.M. dhe që ai kishte arritur në Kosovë të nesërmen. Ai tha që ishte takuar me X.Z. dhe R.Z. në shtëpinë të P.M. për afërsisht dy ditë pasi që është liruar për arrest shtëpiak. P.M. ishte liruar për arrest shtëpiak me datën 2 Mars 2011. Sipas shënimeve të kufirit, edhe X.Z., si dhe R.Z., janë kthyer në Kosovë me datën 2 Mars 2011. Kjo është në përputhshmëri me faktin që në momentin kur S.M. kishte arritur në Kosovë me datën 1 Mars 2011, dhe ka pasur biseda telefonike me R.Z., vëllezërit Z. ishin në X. Po ashtu përputhet me dëshmimin e të P.M. si dhe S.M. që ata janë takuar me R.Z. Zherken dhe X.Z. Zherken në shtëpinë e P.M. dy ditë pas lirimit të P.M. në arrest shtëpiak.

Duke u referuar në vitet 2010 dhe 2011, X.Z. dha dëshmi para kësaj Gjykate që N.M. asnjëherë nuk kishte kërkuar nga ai ndonjë ndihmë financiare.

Ai tregoi që N.M. kishte përmendur tretmanin e mundshëm për birin e tij jashtë vendit, por kurrë nuk kishte përmendur koston e këtij tretmani.

Kur ai ishte dëgjuar nga Prokurori, X.Z. dëshmoi që të hollat që ai i kishte huazuar nga L.N. dhe G.H., i kishte depozituar në xhirollogarinë e tyre bankare. Ai deklaroi që ka qenë prezent në momentin kur të hollat janë depozituar në bankë. Ai mohoi që ndonjë pjesë e parave ishte e caktuar për N.M. Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate, duke iu referuar huas e marr nga L.N., fillimisht, ai kishte thënë që ai ka qenë prezent në momentin kur parat janë paguar në xhirollogarinë bankare të R.Z. Impex-it. Më vonë, ai deklaroi që iu është thënë që parat janë paguar në atë xhirollogari, por që ai nuk ishte prezent aty. Më vonë, ai deklaroi që ai ka qenë "aty afër" X. në momentin kur parat janë paguar. Në çdo rast, regjistrat e X. tregojnë që as të hollat të dhëna nga L.N., e as të hollat të

dhëna nga G.H., nuk janë paguar në xhirollogarinë bankare të drejtuar nga R.Z. ose X.Z..

Duke iu referuar çështjes së miellit, para Prokurorit, X.Z. dëshmoi si në vijim *"është marr si hua që duhej të kthehet pas një kohe të caktuar, koha e akorduar me R.Z."*. Ai tha që sasia ka qenë përafërsisht 5 ton. Ai mendoj që shitja e realizuar ishte për një shumë prej afro 300 Eurove. Ai tha që të hollat janë përdorur për të paguar faturën e telefonit. Ai deklaroi që kjo hua kurrë nuk kthyer.

Dëshmia e dhënë nga X.Z. lidhur me miellin, plotësisht kundërshton dëshminë e R.Z. Kur ai është dëgjuar në muajin Prill të vitit 2012, R.Z. mohoi që kishte marr miell nga P.M.

Kur ai është dëgjuar nga Prokurori në muajin Prill të vitit 2012, ai konfirmoi që ai kishte aplikuar në X për hua në shumë prej 2.5 milion Euro. Një hua në shumë prej 1.7 milion Eurove ishte aprovuar. Megjithatë, banka kërkoi më shumë siguri për hua. Kurrë, këto të holla nuk janë transferuar. Ai deklaroi që ai dhe R.Z. ishin takuar me A.L. për të diskutuar çështjen e huas. Ai konfirmoi që ata kishin diskutuar çështjen e huas me N.M. Ishte dëshmia e tij që ai dhe R.Z. janë takuar me N.M. në një restorant në Prizren. Ai tha që R.Z. kishte pyetur N.M. a mos ekziston ndonjë pengesë ligjore që t'iu jepet huaja. Ai deklaroi që ata kishin pyetur N.M. sepse ai është jurist.

X.Z. dëshmoi që R.Z. ishte njoftuar nga A.L. që për hua nevojitet më shumë siguri. Ai tha që ata e kishin diskutuar këtë çështje me N.M. dhe ishin akorduar që të vendosin shtëpinë e tij si garantë. Fakti që N.M. ishte i gatshëm të vendos shtëpinë e tij si garantë për huan të kërkuar nga R.Z. Impex-i, jep disa indikacione rreth marrëdhënies e tyre.

Kur ai është dëgjuar nga Prokurori në muajin Prill të vitit 2012, ishte dëshmia e tij që ai kurrë nuk kishte kontaktuar N.M. në numrin e tij zyrtar në zyrat të PSRK-së. Ai pohoi që në vitin 2010, ai kishte vizituar N.M. në zyrat të PSRK-së. Ai deklaroi që ky takim ishte mbajtur një ditë para se të udhëtojnë bashkë për në Shqipëri. R.Z. po ashtu ishte prezent. Po ashtu, ai është pyetur për qëllimin e këtij takimi. Ai deklaroi që qëllimi ishte *"për t'u marr vesh rreth momentit kur do të nisen për rrugëtim"*. Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate, ai prapë është pyetur rreth këtij takimi. Ai tha që ata vetëm kishin folur me N.M. për vendtakimin e tyre. Ai mohoi që ata kishin diskutuar ndonjë çështje tjetër. Megjithatë, kur ai është pyetur, ai tha që takimi kishte zgjatur rreth një orë, ai po ashtu deklaroi që ata kishin pasur komunikim telefonik me mjekun rreth ri caktimit të takimit.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate, ai deklaroi që ai kishte vizituar N.M. në zyrat e PSRK-së dy herë, në vitin 2010 dhe në vitin 2011.

R.Z. deklaroi që në vitin 2010 dhe në vitin 2011, ai "shpesh" kishte vizituar N.M. në zyrat e PSRK-së. X.Z. kishte dëshmuar që ai kurrë nuk kishte shkuar me të. Shënimet të sigurimit nga regjistri i PSRK-së shënon që me datën 20 Shtator 2010, ai kishte hyrë në lokalet në ora 14:10, dhe është larguar në ora 15:10. X.Z. kishte arritur dhe është larguar saktësisht në të njëjtën kohë.

Shënimet Kufitare për R.Z., X.Z. dhe N.M. për periudhën 1 Shtator 2010 - 1 Tetor 2010 tregojnë që asnjëri nga këta personat të pandehur ishin larguar nga Kosova nëmës të datave 20 Shtator dhe 1 Tetor 2010.

M.N. ushtroi drejtën e saj që të hesht dhe ajo nuk dëshmoi para kësaj Gjykate. Ajo ishte dëgjuar nga Prokurori me datën 12 Korrik të vitit 2012.

Ajo dëshmoi që ishte takuar me N.M. në Zagreb përafërsisht para 5 - 6 viteve.

Ajo bëri përshkrimin e marrëdhënies e saj me N.M. gjatë viteve 2010 dhe 2011, si marrëdhënie intime.

Ajo iu është referuar birit të N.M. i cili është autistik. Ajo deklaroi që ajo kishte tentuar që të gjej ndonjë mjek në X i cili do të ishte në gjendje t'i ndihmon. Ajo tha që ishte ideja e saj që të kërkohet jashtë vendit.

Ajo dëshmoi që termini fillestar diagnostik ishte falas. Që andej e tutje, shpenzimet do ti mbulonin shoqatat të ndryshme bamirëse religjioze.

Termini i parë ishte caktuar për muajin Shkurt të vitit 2012, por ishte shtyrë për datën 10 Prill 2012. Ajo deklaroi që i kishte treguar N.M. datën e këtij terminit po atë ditë kur ai është arrestuar.

Ajo dëshmoi që gjatë viteve 2011 dhe 2012, ajo ishte takuar me N.M. përafërsisht një herë në çdo javë. Disa prej këtyre takimeve kishin ndodhur ne zyrën e tij në PSRK.

Ajo deklaroi që në rast që ai nuk është përgjigjur kur ajo i bëri thirrje, ajo do të shkonte në zyrën e tij. Ajo tha që nganjëherë ata janë fjalosur rreth marrëdhënies e tyre.

Nëmës datave 11 Tetor 2011 dhe 30 Mars 2012, ajo kishte vizituar zyrat e PSRK-së jo më pak se në 8 raste.

Shënimet të sigurimit e PSRK-së, në të cilat bazohet Prokuroria, tregojnë që me datën 11 Tetor 2011, ajo kishte hyrë në lokalet në ora 14:50 dhe është larguar në ora 15:30. Me datën 26 Tetor 2011, ajo kishte hyrë në lokalet në ora 13:00 dhe është larguar në ora 14:00. Me datën 29 Dhjetor 2011 ajo kishte hyrë në lokalet në ora 12:17 dhe është larguar në ora 12:46. Me datën 22 Shkurt 2012 ajo kishte hyrë në lokalet në ora 14:30 dhe është larguar në ora 14:32. Me datën 24 Shkurt 2012 ajo kishte hyrë në lokalet në ora 14:05 dhe është larguar në ora 14:40. Me datën 28 Shkurt 2012 ajo kishte hyrë në lokalet në ora 14:25 dhe është larguar në ora 15:15. Me datën 9 mars 2012 ajo kishte hyrë në lokalet në ora 13:55 dhe është larguar në ora 15:30. Me datën 30 Mars 2012 ajo kishte hyrë në lokalet në ora 15:35 dhe është larguar në ora 15:50.

Ajo dëshmoi që në muajin Mars apo Prill të vitit 2011, ajo është takuar me V.L., në zyrën e tij në X. Ata kishin diskutuar mundësit të biznesit lidhur me X, një kompani të cilën ajo e përfaqësonte. Në atë kohë, Termokos-i është marr me procesin e ofertimeve.

Ajo dëshmoi që në muajin Shtator të vitit 2011, X e kishte njoftuar që ata kishin fituar një ofertim. Ajo deklaroi që dëshironte të njofton V.L. rreth këtij lajmi dhe e kishte ftuar atë që të takohen në X Hotel. V.L. dëshmoi që M.N. dëshironte të ketë një takim më sekret, dhe sugjeroi që të takohen në atë hotel. Në rast që qëllimi i këtij ishte thjesht që të njofton V.L. rreth suksesit të X, është e çuditshme që ajo thjesht nuk ka shkuar në zyrën e tij.

M.N. dëshmoi që ata kishin ngrënë drekë në X Hotel dhe kanë diskutuar rreth biznesit. Ajo deklaroi që ky takim zgjati rreth një orë.

Ajo mohoi që N.M. ndonjëherë kishte diskutuar me të hetimet që ai ishte duke bërë. Ajo tha që ai asnjëherë nuk i kishte përmendur emrat të personave të përfshirë në ndonjë hetim të tij. Ajo mohoi që ndonjëherë të kishte shikuar dosjet në zyrën e N.M.. Ajo tha që ajo kurrë nuk e kishte bërë pyetje rreth punës së tij. Kjo gjë ishte një gënjeshtër.

Ajo mohoi që kur ajo e kishte takuar V.L., që ajo ishte në dijeni që ai ishte nën hetime. Ajo tha që nuk ka dijeni për asnjë emër të ndonjë Gjykatësit, Prokurorit, apo Zyrtarit policor ndërkombëtar. Ajo deklaroi që ajo nuk kishte dijeni që ndonjë hetim i udhëhequr nga N.M. ishte nën mbikëqyrje të një prokurorit ndërkombëtar. Ajo mohoi të ketë diskutuar ndonjë çështje ku përfshihen L.K., A.L. apo A.G. Ajo mohoi të ketë diskutuar ndonjë hetim me V.L. Ajo mohoi të ketë përmendur emrin e N.M. Ajo mohoi të ketë sugjeruar V.L. që ai, L.K., A.L. apo A.G. të udhëtojnë për në X. Ajo mohoi të ketë treguar V.L. që ndaj është lëshuar një urdhër arresti. Ajo mohoi të ketë treguar V.L., që ai të tregon A.G. që të mos kontakton N.M.n. Në të vërtetë, ajo dëshmoi që ajo "kurrë nuk ishte në dijeni që A.G. ekziston". Kjo gjë ishte një gënjeshtër.

V.L. dëshmoi që M.N. kishte përmendur A.G. Kjo dëshmi përputhet me dëshminë e N.M. Kur N.M. është dëgjuar me datën 10 Korrik 2012, ai është pyetur nga Prokurori a mos e kishte njoftuar ndonjëherë M.N. rreth faktit që A.G. kishte tentuar që ta kontakton atë. Duke u përgjigjur, ai deklaroi "...E kam pyetur a mos i kishte treguar A. që të me telefonon..." Ai tha që kishte menduar që ndoshta ajo e njeh atë. Ai tha që e kishte kërkuar nga M.N. të tregon A.G. që mos ta kontakton atë.

M.N. mohoi të kishte ofruar V.L. kartëvizite të Kryeprokurorit të X, ose që ky Prokuror kishte udhëtuar për në Kosovë në rastin V.L.

Ajo mohoi të kishte treguar V.L. që N.M. do të pushon hetimet ndaj tij. Ajo mohoi të kishte treguar V.L. që një Prokuror Gjerman ishte duke punuar me N.M.

Ajo dëshmoi që kurrë nuk kishte pasur ndonjë problem apo mospajtim me V.L.

2. Dëshmitë lidhur me Komunikimet Telefonike

Sipas Urdhëresës së Gjykatës⁶³, PTK, Vala dhe IPKO ishin urdhëruar të nxjerrin përmbajtjen e komunikimeve SMS nëmës R.Z., X.Z., P.M. dhe N.M. gjatë periudhës prej datës 1 Qershor 2010 deri me datën 30 Prill 2011.

Palët janë akorduar rreth pranimin të dëshmive të Komunikimeve Telefonike në të cilat është bazuar Prokuroria, dhe të cilave iu është referuar në këtë dokument, duke përfshirë listingun telefonik, transkriptat të komunikimeve SMS, si dhe transkriptat të Komunikimeve Telefonike.

Gjykata gjen që tërë materiali tregon që personat në vijim kishin në përdorim numrat të telefonit si në vijim:

P.M. - XXX XXX XXX

R.Z. - XXX XXX XXX

X.Z. - XXX XXX XXX

⁶³ 13 shkurt 2012

N.M. - XXX XXX XXX dhe XXX XXX XXX

Shënimet telefonike për M.N. nuk janë futur si dëshmi.

Asnjë shënim telefonik për S.G. nuk është futur si dëshmi.

Komentet hyrëse

Në vitin 2008 Policia e Kosovës i mori dy ankesa anonime ku pretendohet ekzistenca e korrupsionit në sistemin bankar të Kosovës.

Në mesin e atyre që pretendoheshin se ishin të involvuar ishte edhe Guvernatori i atëhershëm i X. X. H.R. si dhe zyrtarët tjerë në X. Letrat po ashtu përmbanin pretendimet kundër ish likuidatorit të X., P.M. dhe zyrtarët tjerë në X në X - L.K. dhe A.L. si dhe një zyrtar i X., V.L.

Pas një hetimi policor, u dorëzuan disa kallëzime penale. Këto përmbanin kallëzimin penal të datës 23 mars 2009⁶⁴ (Nr. 2008-XZ-007) që përfshinte pretendimet kundër V.L., L.K. dhe A.L. Ai raport iu është dërguar prokurorit të PSRK-së L.S. Edhe pse pretendimet ishin bërë lidhur me X, në atë raport nuk iu ishte bërë asnjë referim P.M.

Kallëzimi i dytë penal i datës 27/03/2009 (Nr. DKKO-NJHF-2008-XZ-013) iu ishte dërguar prokurorit të PSRK-së R.M. Përsëri, edhe pse ishin bërë pretendime që kishin të bënin me X, në atë kallëzim penal nuk iu ishte bërë asnjë referim P.M.

Në vitin 2009 ishte lëshuar Aktvendimi mbi Inicimin e Hetimeve në rastin e ashtuquajtur 'X'. Ky rast kishte të bënte

me P,S. dhe S.K. dhe iu ishte ndarë numri PPS 23/09. Fillimisht ky rast ishte marrë në shqyrtim nga prokurori i PSRK-së L.S. por më 25 maj 2010 ai iu ishte dhënë N.M.

Më 28 maj 2010 një kallëzim penal i nënshkruar nga aksionarë të ndryshëm të X. ishte dërguar në polici. Personat e akuzuar në raport ishin A.G. dhe V.L. Aktvendimi mbi Inicimin e Hetimeve në atë rast ishte lëshuar më 2 dhjetor 2011⁶⁵.

Më 23 qershor 2010 N.M. ia dërgoi Udhëheqëses së atëhershme të PSRK-së I.A. një memorandum të titulluar 'Informatë lidhur me veprimin e ndërmarrë në rastin PPS 23/09.⁶⁶ Në këtë dokument N.M. e njofton udhëheqësen e tij lidhur me hapat hetimor që atëherë ishin ndërmarrë. Ai konkludoi se duhej të ndërmerreshin hetime të ndara kundër të gjithë të dyshuarve që ishin identifikuar në kallëzimet penale të Policisë. Sipas mendimit të tij do të duhej të ngrihej rasti kundër V.L., L.K. dhe A.L. (Rasti Nr. 3). P.M. nuk ishte përmend në atë memorandum.

Komunikimet e para telefonike në mes të N.M. dhe vëllezërve Z. ishin bërë më 28 qershor 2010.

Më 20 korrik 2010 Policia e Kosovës ia dorëzoi N.M. një Memorandum Zyrtar Nr. 017-TFAK/2010⁶⁷. Në atë raport P.M. dyshohej për shpërdorim të pozitës zyrtare kur ishte likuidator në X. Ky dokument përmbante disa pretendime tjera po ashtu kundër H.R., V.L., L.K. dhe A.L.

Më 21 korrik 2010 N.M. lëshoi Aktvendimin mbi Inicimin e Hetimeve⁶⁸ kundër H.R., I.J., I.M. dhe S.Z-H.. Lëndës iu dha

⁶⁵ Faqe 2184 e dosjes nga shqyrtimi kryesor.

⁶⁶ Faqe 2113 e dosjes nga shqyrtimi kryesor.

⁶⁷ Faqe 2117 e dosjes nga shqyrtimi kryesor.

⁶⁸ Faqe 2126 e dosjes nga shqyrtimi kryesor.

numri i rastit PPS 64/10.

Lidhur me R.Z. dhe X.Z., është me rëndësi të thuhet se në vitin 2010 X Impex, kompani në të cilën R.Z. ishte drejtor i vetëm dhe X.Z. ishte i punësuar, i kishte borxh shuma të konsiderueshme Raifeissen X. Ekzistonte një hipotekë në pronën e Z. në afërsi të 1 milion Eurove⁶⁹.

Veç kësaj, vëllezërit Z. kishin marrë hua të shumave të konsiderueshme të të hollave nga individ të ndryshëm privat.

Rasti i P.M.

Kur **S.K.** u kthye nga pushimi i lehonisë në muajin gusht të vitit 2010 ajo punoi me N.M.

Ajo dëshmoi se P.M. ishte takuar me N.M. në një "seancë" në zyrat e PSRK-së. Ajo mendonte se kjo ishte në vitin 2011.

P.M. mori një ftesë formale për t'u paraqitur para prokurorit më 19 prill 2011.

Kur ajo u mor në pyetje nga prokurori në mars të vitit 2012 ajo tha se ajo kurrë nuk i kishte telefonuar P.M. për të kërkuar nga ai që të vinte në zyrat e PSRK-së.

Asaj nuk i kujtohej nëse P.M. kishte ardhur në zyrat e PSRK-së më shumë se një herë.

Gjykata konstatoi se, në fakt, P.M. po ashtu kishte ardhur në zyrat e PSRK-së më 8 dhe 15 shtator 2010 pa pranuar ndonjë ftesë zyrtare.

⁶⁹ Certifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme.

S.K. dëshmoi se asaj nuk i kujtohej se sa herë P.M. kishte qenë në zyrat e PSRK-së. Asaj nuk i kujtohej që N.M. ndonjëherë të kishte kërkuar nga ajo që ta kontaktonte P.M. që të vinte në zyrat e PSRK-së në ndonjë takim joformal.

Sidoqoftë, dukej se nuk ishte e pazakonshme që të ftohet ndonjë dëshmitar nëpërmes telefonit.

Duke iu referuar rastit kundër Guvernatorit të X. ajo tha se ajo kurrë nuk e kishte parë ndonjë listë të personave të cilët duheshin të arrestoheshin.

S.K. dëshmoi se ajo e njohte R.Z. si shokë të N.M. Ajo e njohte vetëm emrin e X.Z. pasi që lidhur me te kishte lexuar në gazeta pas arrestimit të N.M.

Ajo tha se i kujtohej një rast kur R.Z. kishte telefonuar në numrin privat të zyrës së N.M. dhe kishte kërkuar që të fliste me te. Ajo tha se R.Z. asaj ia kishte dhënë emrin e tij. Asaj nuk i kujtohej se çfarë do tjetër të kishte thënë R.Z. me atë rast. Kur ajo u mor në pyetje nga ana e prokurorit në muajin mars të vitit 2012, duke iu referuar ati rasti ajo tha se ajo e kishte pyetur R.Z. nëse ai dëshironte ta linte ndonjë porosi. Si përgjigje ai kishte thënë "Unë jam R.Z., shoku i tij, i tregoni që të më thërret".

S.K. kishte mbajtur shënime në një ditar personal si një përkujtues. Këto konfirmuan dy raste kur R.Z. kishte tentuar të bënte kontakt me N.M. në zyrat e PSRK-së.

Në mes të gushtit 2006 dhe shtatorit 2010 **L.Z-M.** ishte e punësuar në PSRK në cilësinë e Zyrtares Ligjore. Ajo kishte punuar me prokurorë të ndryshëm.

Ajo dëshmoi se dëshmia e saj lidhur me hetimet që bëheshin kundër ish Guvernatorit të X. ishte e vetme arsye që kishte dhënë dorëheqje në muajin shtator të vitit 2010. Ajo ishte brengosur lidhur me drejtimin që e kishte marrë rasti. Sipas mendimit të saj provat nuk i mbështetnin pretendimet. Ajo besonte se provat ishin duke u manipuluar për të justifikuar vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj ish Guvernatorit të X. Aji ia shprehu brengosjet e saja N.M. dhe dy eprorëve të tij. Ajo u udhëzua që të vazhdonte të punonte në rastin në fjalë dhe të ndiqte udhëzimet e N.M. Ajo dhe dorëheqje nga posti i saj. Natyrisht, nuk është e pazakonshme që dy juristë të mos pajtohen lidhur me vlerësimet e provave në një rast.

Asaj iu kujtua që e kishte parë në dosjen e rastit një listë të personave që duheshin të arrestoheshin. Asaj nuk iu kujtuan emrat nga ajo listë. S.H. nuk iu kujtua nëse e kishte parë në dosjen e rastit listën e personave që duheshin të arrestoheshin. Ajo mendoi se po të kishte ekzistuar një listë e tillë ajo do ta kishte parë atë.

Ajo tha se asaj i kishte thënë S.K. se P.M. ishte ftuar në zyrat e PSRK-së dhe se ai ishte paraqitur në dy raste. Ajo tha se S.K. i kishte thënë asaj se P.M. kishte pasur biseda joformale me N.M. dhe Z.I. para datave në të cilat ai zyrtarisht ishte ftuar. S.K. nuk i kujtohej se kishte qenë dëshmitare të çfarëdo lloji të takimit në mes të N.M. dhe P.M.. Mirëpo, gjykata gjeti se më 8 dhe 15 shtator P.M. ishte takuar me N.M. në zyrat e PSRK-së gjatë së cilave nuk ishte zhvilluar ndonjë intervistë formale. Kjo ishte befasuese duke marrë parasysh se takimi i 15 shtatorit kishte zgjatur më shumë se dy orë.

Në mes komunikimit të tyre të parë të përgjuar më 28 qershor

dhe 11 gusht 2010 ka pasur një komunikim të shpeshtë në mes të N.M. dhe të vëllezërve Z.⁷⁰.

Në orën 22:56 më 11 gusht 2010 R.Z. i telefonoi P.M. Ishte një thirrje e dytë telefonike nga R.Z. në orën 23:02.

Kronologjia e këtij komunikimi telefonik, dhe të tjerave, është interesante. Në orën 17:28 X.Z. i telefonoi N.M.. Në orën 22:10 N.M. i telefonoi R.Z. Në orën 22:11 R.Z. ia dërgon N.M. mesazhin SMS si në vijim "Zoti N., jam R.Z. Gjendem në X, a mund të pimë kafe bashkë? Përshëndetje" Në orën 22:15 N.M. i telefonoi R.Z.

Në bazë të komunikimeve telefonike duket se kishte ndodhur një takim në mes të P.M. dhe të vëllezërve Z. më 13 gusht 2010 sepse në orën 09:26 më 14 gusht R.Z. ia dërgoi një mesazh SMS P.M. që thoshte "A mund të pimë kafe në orën 10 aty ku ishim dje, në Çabrat?"

Përsëri, kronologjia e komunikimeve në mes të R.Z. dhe P.M. është interesante. Në orën 09:42 më 14 gusht 2010 R.Z. ia dërgoi një mesazh SMS N.M. me këtë përmbajtje "A je mirë? A je duke ardhur apo jo?" R.Z..".

Në orën 09:46 N.M. i telefonoi R.Z. Ajo bisedë zgjati 1 minutë dhe 17 sekonda.

Në orën 12:10 R.Z. ia dërgoi N.M. një mesazh SMS me këtë përmbajtje, "N., gjendem në X. Do të takohemi kurdo që më thërret".

Në orën 12:32 R.Z. ia dërgoi N.M. një mesazh SMS me këtë

⁷⁰ 28 dhe 30 qershor, 9, 15, 17, 19, 21, 22, 23 korrik dhe 4 dhe 7 gusht 2010.

përmbajtje, "N., a mund të takohemi te X?".

Në orën 12:57 N.M. i telefonoi vëllezërve Z. Në orën 15:08 dhe 15:44 vëllezërit Z. i telefonuan P.M.

Më 13 gusht 2010 Hetuesi Z.I. ia dërgoi një raport informativ⁷¹ N.M. në rastin PPS 64/10 duke e njoftuar prokurorin lidhur me progresin e hetimeve.

P.M. dëshmoi se kur u takuan, R.Z. dhe X.Z. kërkuan një hua prej tij në një shumë prej 240,000 Eurove.⁷² Ata thanë se dëshironin që ta ndërtonin një fabrikë për mbushjen e shisheve. P.M. u tregoi atyre se ishte i papunë dhe se nuk ishte në gjendje që t'ju ndihmonte. Në përgjigjën e tyre ata i treguan P.M. se ishte duke dorëzuar kundër tij dhe se "ne kemi një person shumë të fortë, është një mik i yni dhe se ti duhet të bashkëpunosh me atë person për të parë se si mundesh me na ndihmuar neve lidhur me atë borxh, por edhe lidhur ndonjë bashkëpunim që ai personi mund ta kërkojë nga ti".

Ai tha se R.Z. dhe X.Z. e kishin pyetur atë lidhur me ish Guvernatorin e X. Ata i treguan se miku i tyre do të mund t'i ndihmonte që ri-caktohet në pozitën e tij të Likuidatorit në X. Mirëpo, P.M. dëshmoi se vëllezërit Z. nuk i kishin treguar në takimin e tyre të parë se kush ishte miku i tyre apo çfarë lloj ndihme kërkonte ky personi.

Gjykata konstaton se komunikimi i parë në mes të P.M. dhe të vëllezërve Z. ishte bërë nga R.Z. Fakti se ky komunikim erdhi pas një numri të madh të komunikimeve telefonike në mes të N.M. dhe R.Z. e mbështetë pohimin e prokurorit se ky kontakt ishte organizuar në bashkëpunim me N.M. Në të vërtetë, është e

⁷¹ Faqe 2140 e dosjes nga shqyrtimi kryesor.

⁷² Faqe 19 Procesverbali i datës 4 dhjetor 2012.

pabesueshme se në gusht të vitit 2010 vëllezërit Z. do të ishin në dijeni lidhur me hetimet kundër P.M. po qese ata nuk janë njoftuar lidhur me te nga N.M.

Ishte dëshmia e P.M. e dhënë Trupit Gjykses se disa ditë pas këtij takimi të parë se ai e kishte marrë një telefonatë nga R.Z. i cili kishte kërkuar që të takoheshin përsëri. Në fakt, ai me siguri kishte gabuar se kur kishte ndodhur takimi i dytë. Provat telefonike të cilave iu është referuar sugjerojnë se takimi i parë ishte mbajtur më 13 gusht kurse takimi i dytë më 14 gusht.

P.M. dëshmoi se gjatë takimit të dytë me R.Z. dhe X.Z. ata i treguan atij se ata kishin biseduar me mikun e tyre i cili kishte konfirmuar se ai do të mund t'i ndihmonte P.M. por si kundër shpërblim ai duhet me iu ndihmua lidhur me një rast. Ata e përshkruan shokun e tyre si "shumë të fuqishëm dhe të pushtetshëm". Ata po ashtu i treguan atij se do të dorëzohej një kallëzim penal kundër tij që do të përmbante pretendime se ai kishte pranuar një përfitim material të kundërligjshëm në një shumë prej përafërsisht 200.000 Eurove. R.Z. dhe X.Z. thanë se miku i tyre "do të të ndihmojë".

Përsëri, vëllezërit Z. ishin në dijeni lidhur me detajet hetimeve penale kundër P.M. dhe iu referuan një shume specifike të të hollave. Kjo ishte shuma që ishte përmendë në mënyrë specifike në kallëzimin penal që ishte dorëzuar nga ushtruesi i detyrës së administratorit të përkohshëm të X..⁷³ Veç kësaj, vëllezërit Z. ishin në dijeni se hetimet në një mënyrë e përfshinin edhe ish Guvernatorin e X.

P.M. dëshmoi para Gjykatës se vëllezërit Z. i kishin treguar se miku të cilit ata i referoheshin dhe personi nga i cili

⁷³ Faqe 1901 e dosjes nga shqyrtimi kryesor.

marrë informatën ishte prokurori special N.M.. Ata kishin sugjeruar një takim me N.M.

Gjatë periudhës 11 - 15 gusht 2010 kishin qenë 13 komunikime telefonike në mes të N.M. dhe R.Z.

Me rastin e intervistimit nga ana e prokurorit më 1 shkurt 2012 P.M. dëshmoi se për afërsisht dy ditë pas takimit të tij të dytë me R.Z. dhe X.Z., kur ata kishin biseduar lidhur me një takim të mundshëm me N.M., ai e mori një telefonatë nga R.Z. i cili i tha "Prokurori po ashtu është kërcënuar dhe ai shkon askund pa mbrojtjen e afërt, ai nuk ka mundësi që të takohet me ty jashtë zyrës së tij por ti dëshesh me shkua në zyrën e tij".

Me 16 gusht 2010 Zyra e Prokurorisë së Qarkut e pranoi një Kallëzim Penal⁷⁴ kundër P.M. i dorëzuar nga ushtruesi i detyrës së administratorit të përkohshëm të X., L.B. Pretendimet në atë kallëzim penal kishin të bënin me P.M..

Më 24 gusht 2010 në orën 08:16 N.M. ia dërgon një mesazh SMS R.Z. me përmbajtjen si në vijim "Tung. Vetëm sa për të informuar se kam ardhur dje". Në orën 08:17 R.Z. ia dërgon një mesazh SMS N.M. ku thotë "A je mirë. A mund të pimë kafe sot? Përshëndetje R.Z." Në orën 08:18 N.M. ia dërgon një mesazh SMS R.Z. ku thotë "Më lajmëro kur të vish".

Në orën 14:49 me datë 24 gusht 2010 P.M. ka thirrur në telefon R.Z. R.Z., dhe ka pyetur 'si janë punët'. Nuk është rastësi se rreth 10 minuta pas kësaj në orën 15:00, R.Z. ka dërguar një SMS N.M. ku thuhet "N. A mund të takohemi në X në orën 17:00? R.Z.i". Në orën 15:05 N.M. ka dërguar një sms R.Z. ku thuhet vetëm "Po". Në orën 16:25 R.Z. ka dërguar një sms N.M. ku

⁷⁴ Do.

thuhej "A mund të takohemi tek X?". Përsëri nuk është rastësi që në orën 19:13 R.Z. ka dërguar një SMS P.M. ku thuhej "P., të lutem kupto. Sonte dhe nesër në mëngjes do të pimë X. R.Z.". Gjykata gjen se qëllimi i këtyre komunikimeve telefonike me N.M. dhe takimi i propozuar ishin për të diskutuar lëndën e P.M.

Me datë 25 gusht 2010 në orën 11:11 R.Z. ka dërguar një sms P.M. ku thuhej "P., Jam në X. Kthhem pas një ore dhe takohemi. R.Z.". Në orën 18:27 R.Z. ka dërguar një sms P.M. ku thuhej "Px, të lutem kupto edhe sonete. R.Z."

Me datë 26 gusht 2010 në orën 19:27 R.Z. ka dërguar një SMS N.M. ku thuhej "N. A mund të ulemi bashkë sonete?" Në orën 19:37 R.Z. ka dërguar një SMS N.M. ku thuhej "N.. A mund të ulemi bashkë bashkë sonete?"

Me datë 6 shtator 2010 në orën 11:27, 14:44 dhe 16:39 P.M. ka kontaktuar R.Z. Në orën 16:42, tre minuta pas komunikimit të tij telefonik me P.M., R.Z. ka telefonuar N.M. Edhe këtë herë kjo nuk është rastësi.

Me datë 6 shtator 2010, po të njëjtën ditë komunikimi telefonik mes N.M., R.Z. dhe P.M., N.M. fton P.M. që të shkojë në zyrat e PSRK-së me datë 8 shtator 2010 në lëndën numër 64/10.

Nuk është rastësi që P.M. i është kërkuar të paraqitet në zyrën e prokurorit brenda një kohe relativisht të shkurtër pas diskutimit që ai kishte pasur me vëllezërit Z. lidhur me mundësinë për të takuar N.M. dhe sugjerimit që është mbajtur takim në zyrën e prokurorit.

Me datë 8 shtator 2010 P.M. ka qenë në zyrat e Prokurorit

Special të Republikës së Kosovës. Ai nuk kishte pranuar ftesë zyrtare për tu paraqitur përpara prokurorit. Ai ka hyrë në zyrat e PSRK-së në orën 09:58.

P.M. ka dëshmuar se gjatë këtij takimi N.M. i ka thënë atij se ai kishte nevojë për ndihmën e tij në lëndën e tyre kundër ish-guvernatorit të X. N.M. i ka thënë atij se në shkëmbim të ndihmës së tij ai do të riemërohej në pozitën e tij të mëparshme si Likuidator i X.

Si përgjigje P.M. ka deklaruar se ai ka dëshirë të ndihmojë por se ai nuk kishte asnjë informacion relevant për të dëshmuar kundër ish Guvernatorit.

Si përgjigje ndaj kësaj N.M. i ka thënë atij *"Ne rregull, por mos harro se po përgatitet një kallëzim penal kundër teje"*⁷⁵.

P.M. deklaroi se ai nuk kishte frikë nga kjo sepse nuk kishte bërë asgjë gabim dhe se nuk kishte asgjë për të fshehur. N.M. i ka thënë P.M. që *"mendohu"*⁷⁶. Atij i është thënë se atij do ti kërkohet të vinte përsëri në zyrën e prokurorit në kohë të duhur.

P.M. dëshmoi se gjatë takimit të tij me N.M. nuk është mbajtur procesverbal dhe atij nuk i është kërkuar të nënshkruajë asnjë dokument. Ai mendon se takimi ka zgjatur rreth 20 minuta. Ai është larguar nga zyra e prokurorit në orën 10:50⁷⁷.

P.M. dëshmoi se pas largimit të tij nga zyra e prokurorit ai i ka telefonuar R.Z. për tu treguar atyre atë që kishte ndodhur. Ai tha se gjatë kësaj bisede R.Z. tha *"A nuk të kemi thënë se*

⁷⁵Faqe 23 e procesverbalit të shqyrtimit kryesor të datës 4 dhjetor 2012.

⁷⁶ Do.

⁷⁷ Faqe 795 - 814 e dosjes së gjykimit.

*do të bëhej mirë*⁷⁸.

Fakti i një thirrje telefonike mes P.M. dhe R.Z. mbështetet nga prova se në orën 11:01 P.M. ka kontaktuar R.Z. Në orën 14:16 R.Z. ka kontaktuar N.M. Pas kësaj në orën 14:18 P.M. ka kontaktuar R.Z. Përsëri, nuk është rastësi që R.Z. ka biseduar në telefon me N.M. brenda pak minutash pasi kishte biseduar me P.M.

Komunikime telefonike që janë bërë brenda një periudhe relativisht të shkurtër mes N.M., R.Z., X.Z. dhe P.M. nuk kanë qenë karakteristike e pazakontë në këtë rast. Komunikime të ngjashme janë bërë edhe me datë 10, 16 dhe 26 shtator 2010.

Me datë 10 shtator 2010 në orën 08:45 P.M. ka telefonuar R.Z. Në orën 08:46 R.Z. ka telefonuar N.M. Përsëri, R.Z. ka telefonuar N.M. rreth 1 minut pas marrjes së një telefonate nga P.M. Ky komunikim është interesant sepse ka ndodhur të njëjtën ditë kur P.M. ka marrë një kredi bankare në shumën prej 3000 Euros.

P.M. dëshmoi se atij i janë bërë kërkesa të tjera për para nga vëllezërit Z. Ai dëshmoi se me datë 10 shtator 2010 ai ka marrë një kredi prej 3,000 Euros nga Bank X.⁷⁹ dhe këtë shumë ia ka dhënë R.Z. P.M. ka hipotekuar veturën e tij private dhe disa pajisje shtëpiake si garaci për kredinë. Është e qartë se kjo nuk ishte thjesht një marrëveshje biznesi për një kredi të bërë nga dikush me kapital të disponueshëm. Fakti se P.M. ka përdorur veturën e tij dhe pajisje të domosdoshme shtëpiake si garanci sugjeron se kjo ishte një përpjekje e dëshpëruar për të gjetur fonde.

⁷⁸ Faqe 25 e procesverbalit të shqyrtimit kryesor datë 4 dhjetor 2012.

⁷⁹ Faqe 740 - 762 e dosjes së gjyqimit.

Me datë 11 shtator 2010 në 15:58 R.Z. ka dërguar një SMS N.M. ku thuhej "N., a mund të pijmë kafe? Jemi në X. R.Z.". Në orën 16:33 R.Z. ka dërguar edhe një SMS N.M. ku thuhej "A mund të takohemi apo jo? R.Z.". Në orën 16:35 N.M. ka dërguar një SMS R.Z. ku thuhej "Jam në qytet".

Me datë 14 shtator 2010 në orën 19:32 R.Z. ka dërguar një SMS N.M. ku thuhej "Jam tek shtëpia jote".

Me datë 15 shtator 2010 P.M. është thirrur përsëri në zyrat e PSRK-së pa ftesë zyrtare. Ai ka arritur në zyrat e PSRK-së në orën 09:42.

P.M. dëshmoi se kur ka hyrë në zyrën e prokurorit ai ka parë N.M. duke shtypur në kompjuterin e tij. Ai ishte vetëm. Pastaj N.M. ka marrë një dokument nga printeri i tij dhe ia ka dhënë P.M. Ai i ka thënë se kjo ishte lista e personave që do të arrestoheshin në rastin e X. Kreditore. P.M. ka parë se emri i tij ishte në listë.

N.M. i ka thënë P.M. se edhe ai do të duhej të ishte arrestuar por se ai nuk e kishte bërë këtë "për shkak të miqve të përbashkët"⁸⁰.

T.G. dëshmoi se N.M. i është referuar "vëllezërve" kur ata janë takuar gjatë kohës kur P.M. ishte në arrest shtëpiak.

Gjykata gjen se N.M. i është referuar R.Z. dhe X.Z. Është e paimagjinueshme që N.M. të jetë referuar vëllezërve Z. përveç se nëse ai ka ditur për lidhjen mes tyre dhe ai ka dashur të validojë natyrën dhe qëllimin e diskutimeve inter se.

P.M. dëshmoi se gjatë atij takimi N.M. ka pyetur P.M. nëse ai

⁸⁰ Faqe 25 e procesverbalit të datës 4 dhjetor 2012.

kishte menduar më shumë lidhur me rastin kundër ish Guvernatorit të X. P.M. deklaroi se nuk kishte prova për të dhënë të cilat, sipas mendimit të tij, do të ndihmonin prokurorin. Ai tha se si përgjigje N.M. i ka thënë atij se ai kishte marrë një kallëzim penal i cili implikonte P.M. në një vepër penale. Ai tha se vetëm i kishte hedhur një sy raportit. Ai i ka thënë P.M. se ai duhej *"...te vazhdonte të ndihmonte shokët tanë vëllezërit Z. çdo gjë do të jetë në rregull"*⁸¹.

P.M. është larguar nga zyrat e PSRK-së në orën 11:50⁸². Përsëri, nuk është bërë intervistë formale - edhe pse P.M. ka qendruar në zyrën e PSRK-së për më shumë se dy orë.

Nuk është rastësi se gjatë takimit në PSRK i cili është mbajtur ditën e nesërme pasi R.Z. është takuar me N.M. në Prizren N.M. të deklarojë *"...vazhdo ndihmo vëllezërit gjithçka do të jetë në rregull"*⁸³.

Pas takimit të dytë me N.M. P.M. ka telefonuar R.Z. dhe e ka informuar atë se ai ishte larguar nga zyra e prokurorit. R.Z. thotë *"shumë mirë, do të takohemi"*⁸⁴.

P.M. dëshmoi se një apo dy ditë pas takimit me N.M. ai ka takuar R.Z. dhe X.Z. në X. Gjatë këtij takimi R.Z. dhe X.Z. i kanë kërkuar P.M. 50,000 Euro për të ndërprerë hetimin kundër tij dhe për ta rikthyer në pozitën e tij të mëparshme si Likuidator i X. Kreditore. Është domethënëse se kjo "kërkesë" është bërë brenda pak ditësh nga takimi mes P.M. dhe N.M. gjatë së cilit N.M. kishte informuar atë lidhur me kallëzimin penal. Nga kjo del qartë se R.Z. dhe X.Z. komunikonin me N.M. dhe kjo sekuencë e ngjarjeve ishte pjesë e një plani të

⁸¹ Faqe 26 procesverbali i datës 4 dhjetor 2012.

⁸² Faqe 739 e dosjes së gjykimit.

⁸³ Faqe 26 procesverbali i datës 4 dhjetor 2012.

⁸⁴ Faqe 27 e procesverbalit të datës 4 dhjetor 2012.

parapërgatitur. Edhe ky takim është bërë pas komunikimeve telefonike mes R.Z. dhe N.M. dhe një takimi mes R.Z. dhe N.M. Kjo ka ndodhur pak kohë pas takimit mes P.M. dhe N.M. në zyrat e PSRK-së ku N.M. kishte deklaruar *"...vazhdo të ndihmoheshokët tanë, vëllezërit Z. gjithçka do të jetë në rregull"*⁸⁵.

P.M. dëshmoi se R.Z. dhe X.Z. kanë thënë se shuma prej 50,000 Euro do ti jepej N.M. Ata kanë thënë se N.M. kishte nevojë për paratë për të dërguar djalin e tij jashtë vendit për trajtim mjekësor.

Duke iu referuar sëmundjes së djalit ata i kanë thënë P.M. ai *"bërtet shumë kur është i ulur në tavolinë dhe hedh poshtë çdo gjë që mund të kapë pa kontroll"*⁸⁶. Duket se vëllezërit Z. kishin njohuri të thjeshta lidhur me sëmundjen e djalit të N.M.

P.M. ka pyetur vëllezërit Z. si mund të riemërohej në postin e tij të mëparshëm si Likuidator. Vëllezërit Z. i thanë atij se të gjithë personat kryesorë në rastin e X., përfshirë N.K., zëvendës guvernatori i X. Kreditore, do të ftoheshin zyrtarisht së shpejti për tu paraqitur përpara prokurorit. Ata thanë se prokurori do ti kishte ata të gjithë *"në dorë"*.

Kjo është interesante sepse përsëri verteton njohuritë e vëllezërve Z. lidhur me një hetim në zhvillim deri edhe kohën kur ishte propozuar që prokurori të intervistonte një dëshmitar kyç. Duke pasur parasysh modelin e komunikimeve të tyre Gjykata gjen se ishte N.M. ai që kishte zbuluar këto informata lidhur me hetimin penal.

P.M. i ka thënë R.Z. dhe X.Z. se ai nuk mund të ndihmonte

⁸⁵ Faqe 26 e procesverbalit të datës 4 dhjetor 2012.

⁸⁶ Faqe 29 e procesverbalit të datës 4 dhjetor 2012.

prokurorin sepse ai nuk kishte prova që mund të ndihmonin atë. Megjithatë ai tha se ishte i interesuar të riemërohej në postin e tij të mëparshëm si Likuidator i X.

P.M. dëshmoi se ai ofroi vëllezërve Z. 20,000 Euro. Duke iu referuar vëllezërve Z. P.M. tha "asgjë nuk ishte për ata".⁸⁷

Duke u përgjigjur ofertës së tij për të paguar 20,000 Euros R.Z. dhe X.Z. kanë thënë "Në rregull, do të flasim me prokurorin dhe do të tregojmë se si do veprosh"⁸⁸.

Gjatë periudhës kohore 11 - 18 shtator 2010 janë bërë 14 komunikime telefonike mes N.M. dhe R.Z. dhe një komunikim telefonik mes N.M. dhe X.Z.

Me datë 16 shtator 2010 në orën 12:54 N.M. ka dërguar një SMS R.Z. ku thuhet "Dr. Q.S.". Në orën 15:54 X.Z. i ka telefonuar N.M. Në orën 15:46 P.M. ka telefonuar R.Z. Në orën 20:17 N.M. ka telefonuar X.Z. Përsëri, nuk është rastësi se rreth tre minuta më vonë, në orën 20:20 R.Z. i ka telefonuar P.M. Në orën 20:33 R.Z. i ka telefonuar P.M.. Në orën 20:37 P.M. i ka telefonuar R.Z. Në orën 21:22 X.Z. i ka telefonuar N.M..

Me datë 17 shtator 2010 në orën 15:57 R.Z. ka dërguar një SMS P.M. ku thuhet "P., Jam në. R.Z."

P.M. dëshmoi se dy apo tre ditë pas takimit me R.Z. dhe X.Z. gjatë së cilit ai kishte ofruar 20,000 Euro, R.Z. e ka kontaktuar atë duke kërkuar takim. I pranishëm në takim kanë qenë P.M., R.Z. dhe X.Z. R.Z. i ka thënë P.M. se N.M. kishte refuzuar ofertën e tij prej 20,000 Euro dhe kishte përsëritur

⁸⁷ Faqe 22 e versionit anglisht e procesverbalit të marrjes në pyetje nga prokurori me datë 1 shkurt 2012.

⁸⁸ Faqe 11 e versionit anglisht e procesverbalit të marrjes në pyetje nga prokurori me datë 1 shkurt 2012.

kërkesën e tij të mëparshme prej 50,000 Euro. P.M. dëshmoi se vëllezërit Z. i kanë thënë atij se N.M. kishte nevojë për atë shumë sepse paratë do të ndaheshin mes tre personave përfshirë edhe një avokat nga X si dhe dikë nga X. emrat e të cilëve nuk janë përmendur.

P.M. informoi vëllezërit Z. se ai nuk mund të siguronte atë shumë parash. Ata i kanë thënë atij se hetimi do të vazhdonte por se ata do të bënin çfarë kishin mundësi të bënin për të gjetur një zgjidhje.

Disa ditë pas takimit, R.Z. i ka telefonuar P.M. dhe ka kërkuar edhe një takim. Gjatë atij takimi R.Z. dhe X.Z. i janë referuar përsëri faktit se djali i N.M. ishte i sëmurë duke thënë *"ne do të bëjmë maksimumin për të ndihmuar; ne duhet të gjejmë disa para në formë huaje për Prokurorin Publik..."* Ata i kanë kërkuar atij hua. P.M. nuk i kujtohet shuma. Ai tha se u ka thënë atyre se nuk kishte para për të dhënë borxh.

P.M. dëshmoi se, pas kësaj, R.Z. i ka telefonuar atij vazhdimisht gjatë dy apo tre ditëve. Ata u pajtuan të takoheshin përsëri.

P.M. dëshmoi se në pjesën e fundit të gushtit 2010 ai ishte pajtuar të jepte vëllezërve Z. shumën prej 20,000 Euro. Kjo shumë ishte kuptuar si hua dhe ato ishin para që ai i kishte kërkuar L.N.

Në fakt, nga provat del se këto para janë dhënë në apo rreth shtatorit të vitit 2010. Në dëshminë e tij L.N. iu referua "verës" së vitit 2010.

Nga provat del se P.M. ka vazhduar me këtë skemë duke devijuar vetëm në momentin kur kërkesat e të pandehurve u bënë tepër të

mëdha. Në mënyrë të qartë kjo ndikon në besueshmërinë e tij. Megjithatë, bazuar në gjithë materialet, dëshmia e tij është koherente dhe e mbështetur nga prova të tjera në lëndë. Gjykat gjeti dëshminë e tij të besueshme përse i përket aspektit material.

L.N. dëshmoi se P.M. i ka thënë atij se atij i nevojiteshin paratë sepse kundër tij po përgatitej një "akuzë". Ai tha se P.M. i ka thënë atij se ai kishte nevojë për paratë për "tu liruar nga aktakuza". Kur ai është ekzaminuar nga prokurori ai nuk ka përmendur "aktakuzën". Megjithatë, është e qartë se ai ishte në dijeni të një hetimi penal kundër P.M.

L.N. dëshmoi përpara kësaj gjykate se arsyeja për të cilën ai ka dhënë para hua vëllezërve Z. ishte sepse P.M. besonte se ata mund ta kthenin atë në postin e tij të mëparshëm në bankë.

Megjithatë, kur ai është dëgjuar nga prokurori⁸⁹ ai tha se P.M. "kishte frikë nga arrestimi". Në këtë rast atij i është kërkuar nga prokurori të spjegojë arsyen pse P.M. i kishte kërkuar atij të jepte 20,000 euro hua vëllezërve Z. Ai u përgjigj se P.M. i ka thënë atij "Ata do të bëjnë punën për mua dhe ata më kërkuan këto para". Megjithatë, më vonë gjatë marrjes në pyetje prokurori pyet L.N. nëse paratë që ishin dhënë vëllezërve Z. ishin në shkëmbim të "një lloj nderi". L.N. përgjigjet duke deklaruar se "P.M. më tha "Vëllezërit Z. mund të kthenin në postin tim të mëparshëm përmes disa njerëzve të tjerë" sipas tij unë kam dhënë këto 20,000 Euro vetëm për këtë qëllim"⁹⁰.

L.N. dëshmoi se shuma prej 20,000 Euro do të jepej vëllezërve Z. në shkëmbim të një përfitimi material. Ai dëshmoi se përmes

⁸⁹ 23 mars 2012.

⁹⁰ Faqe 4 e procesverbalit të intervistës me prokurorin me datë 23 mars 2012.

një pale të tretë hetimi kundër P.M. do të pushonte dhe ai do të kthehej në punë si Likuidator i X. Kreditore.

L.N. tha se ai ka takuar R.Z. dhe X.Z. në X.

L.N. tha se gjatë atij takimi vëllezërit Z. thanë se kishin *"njerëz me ndikim në X që mund të kryenin punë të mëdha"*⁹¹.

Kur ai dëshmoi në gjykatë ai tha se janë përmendur *"prokurorë"*. Megjithatë, kur u ekzaminua nga prokurori, L.N. u pyet *"A përmendën vëllezërit Z. çfarë lloj njerëzish me ndikim..."* L.N. u përgjigj *"mua jo"*. Ai tha se takimi kishte zgjatur 15 - 20 minuta.

Në fakt, gjatë marrjes në pyetje nga prokurori, L.N. është pyetur *"A përmendën vëllezërit Z. apo P.M. ndonjë gjë lidhur me përfshirjen në këtë lëndë të ndonjë zyrtari të shtetit?"* Ai u përgjigj *"Ata vetëm thanë "kemi njerëz në X që mund të kryejnë punë" por asgjë lidhur me emrat apo funksionet e këtyre njerëzve"*⁹².

Me kalimin e kohës është e pashmangshme që faktorë të jashtëm të mos kenë një efekt subliminal mbi koherencën e dëshmisë së dëshmitarit. Kjo është sigurisht e vërtetë në këtë lëndë për këtë dhe dëshmitarë të tjerë. Gjykata ka marrë parasysh këtë veçori gjatë vlerësimit të kësaj dhe provave të tjera.

L.N. u pajtua të japë hua vëllezërve Z. shumë prej 20,000 Euro. Kjo shumë duhej të kthehej përpara vitit të ri. P.M. ishte garant për huanë.

L.N. dëshmoi se rreth katër ditë pas takimit të tyre të parë

⁹¹ Faqe 4 e procesverbalit të intervistës me prokurorin me datë 23 mars 2012.

⁹² Do.

në Gjakovë ai i ka dhënë R.Z. 20,000 Euro para të gatshme ndërsa gjendeshin në veturën e P.M. që ishte e parkuar përballë të X në X.

L.N. dëshmoi se komunikimi i tij me vëllezërit Z. është bërë gjithmonë përmes P.M. Ai nuk ka takuar asnjëherë asnjërin prej vëllezërve Z. pa praninë e P.M. Ai tha se nuk u kishte dhënë vëllezërve Z. numrin e tij të telefonit.

Gjykata gjeti se L.N. ishte dëshmitar i besueshëm.

P.P. dëshmoi se në vitin 2010 ai është kontaktuar nga R.Z. dhe L.N. Të dy i janë referuar një kontrate që ishte propozuar që P.P. të përgatiste lidhur me një hua në shumën prej 20,000 Euro nga L.N. për R.Z.

P.P. dëshmoi se ai nuk ka diskutuar kushtet e kontratës së propozuar as me R.Z. dhe as me L.N.

Ai tha se kishte kërkuar R.Z. ti siguronte atij një certifikatë pronësie. Kur u paraqit në gjykatë P.P. solli me vete një certifikatë pronësie të vulosur. Atij nuk i kujtohej se kush ia kishte dhënë atë. Gjykata gjen se normalisht certifikatat e pronësisë të mbyllura me vulë i jepen pronarit të regjistruar të pronësië dhe se ka shumë mundësi që kjo certifikatë ti jetë dhënë P.P. nga R.Z.

P.P. dëshmoi se në vazhdim ai nuk ka pasur më informacion as nga R.Z. dhe as nga L.N. dhe kontrata nuk u përpilua kurrë.

Ai dëshmoi se ishte kontaktuar nga P.M. i cili kishte pyetur lidhur me parakontratën. Ai tha se P.M. e ka pyetur atë nëse ai kishte përpiluar kontratën mes R.Z. dhe L.N. Megjithatë ai tha se ai kishte përshtypjen se P.M. kishte afruar L.N. dhe

R.Z. Ai nuk mundi të spjegojë sesi kishte krijuar atë përshtypje. Natyrisht është shumë domethënëse vetë përfshirja e P.M. Kjo nuk ishte një marrëdhënie e thjeshtë biznesi mes R.Z. dhe L.N. siç pretendonte R.Z.

R.Z. dëshmoi përpara prokurorit me datë 17 prill 2012⁹³ se nuk ishte përpiluar kontratë. Në fakt dëshmia e tij dukej të ishte se palët nuk kanë pasur asnjëherë qëllim që të përpilojnë një kontratë. Ai tha L.N. *"kishte besim tek unë "*. Për këtë arsye është është e çuditshme që P.P. të jetë udhëzuar lidhur me këtë.

Me datë 21 shtator 2010 në orën 16:42 R.Z. ka dërguar një SMS P.M. ku thuhej *"P., të lutem kupto deri nesër nuk mund ta bëj. Përshëndetje, R.Z."*

Me datë 23 shtator 2010 në orën 19:01 R.Z. ka dërguar një SMS P.M. ku thuhej *"P., të lutem kupto, do ta kryejmë detyrimin deri të shtunën. R.Z."* Në orën 19:04 P.M. ka dërguar një SMS R.Z. ku thuhej *"Nuk të thirra për atë muhabetin, desha vetëm me pi kafe dhe me bisedu për diçka"*.

Me datë 23 shtator 2010 Shefja e PSRK-së në atë kohë I.A. ka nënshkruar një Vendim⁹⁴ për të marrë përsipër lëndën ku përfshihej P.M.

Me datë 25 shtator 2010 në orën 10:52 X.Z. ka dërguar një SMS N.M. ku thuhej *"Tung. Si shkoi dita sot? A është djali mirë? Përshëndetje, X.Z."* Në orën 16:53 N.M. ka dërguar një SMS X.Z. ku thuhej *"Mirë, faleminderit për interesimin. Gjendja e djalit nuk ka ndryshuar shumë. Përshëndetje"*

⁹³Faqe 5 e procesverbalit apo faqe 101 e dosjes së gjykimit.

⁹⁴Faqe 1912 e dosjes së gjykimit.

Me datë 26 shtator 2010 në orën 20:17 N.M. i ka telefonuar X.Z. Përsëri nuk është rastësi që pak kohë pas kësaj, në orën 20:20 R.Z. i ka telefonuar P.M. Në orën 20:33 R.Z. i ka telefonuar P.M. Në orën 20:37 P.M. i ka telefonuar R.Z. Në orën 21:22 X.Z. i ka telefonuar N.M..

Me datë 29 shtator 2010 në orën 08:51 R.Z. ka dërguar një SMS N.M. ku thuhet "Prof. Dr. M.R. nr. XXX XXX XXX"

Gjatë muajit tetor, nëntor dhe dhjetor 2010 ka pasur komunikime telefonike të shpeshta mes R.Z., X.Z., N.M. dhe P.M.

Me datë 4 dhjetor 2010 në orën 13:30 N.M. ka dërguar një SMS R.Z. ku thuhet "Tung. Si je?"

Me datë 5 dhjetor 2010 në orën 11:16 N.M. ka dërguar një SMS R.Z. ku thuhet "Ke kry punë me mu". Në orën 11:30 R.Z. dërgon një SMS N.M. ku thuhet "Faleminderit, ke bërë shumë për ne...ndërsa *ishallah* nuk përfundon kurrë për ne. Vetëm djalli lart në qiell do të na vejë shpirtin në provë. E di shumë mirë se gjërat e mira do të peshojnë më shumë. Faleminderit për mirënjohjen që ti ndien me punën tonë. R.Z.". Në orën 11:31 N.M. i telefonon R.Z. Në orën 11:34 N.M. dërgon një SMS R.Z. ku thuhet "Ti vetë e ke dashur kështu kur jemi takuar tek unë". Në orën 11:54 R.Z. dërgon një SMS N.M. ku thuhet "Kësaj i thonë punë e rëndë. Meqënëse të konsideroj si vëlla kam menduar se së bashku do ta kalojmë këtë vështirësi? Esenca e kësaj është se ne nuk e kishim dhe asgjë". Në orën 11:57 R.Z. dërgon një SMS N.M. ku thuhet "Z. N. kam qenë dje në orën 12 tek shtëpia jote bashkë me X.Z. dhe B. Ti nuk ishe aty. Çeshtja është se puna nuk po kryhet, as me doktorin dhe as me ty. Varet si na kupton ti neve. Borxhi është borxh për ne dhe derisa ta kthejmë na trazon shpirtin. R.Z.". Në orën 12:32

R.Z. dërgon një SMS N.M. ku thuhet "Z. N. a ndihesh më mirë? Ishallah bëhesh më mirë. N., njerëzit e zemrës nuk prishen për para. Përshëndetje të përzemërta familjes. R.Z." Në orën 13:14 R.Z. dërgon një SMS N.M. ku thuhet "Z. N. është një shprehje e vjetër muslimane që thotë 'Kur gjen ni shok ke një vështirësi më pak kur humb një shok ke një vështirësi më shumë". Të lutem bëje për ne. Edhe pak ditë me Dr. dhe ne kryejmë obligimin. R.Z.." Në orën 13:30 dhe 13:34 R.Z. ka dërguar edhe dy SMS të tjerë N.M. Përmbajtja e këtyre SMS mungon. Në orën 17:25 R.Z. dërgon një SMS N.M. ku thuhet "Z. N. të dhashtë Allahu gjithmonë atë që ti dëshiron. Vëllazërisht R.Z.".

Gjatë këtyre shkëmbimeve mes N.M. dhe R.Z. i referohet "punës". Konteksti i këtyre shkëmbimeve është i tillë që gjykata gjen se kjo nuk është bisedë lidhur me trajtimin mjekësor të djalit të N.M. Në fakt, përveç pyetjeve të rastit nga vëllezërit Z. lidhur me djalin e N.M., komunikimet telefonike nuk përmbajnë asnjë bisedë që mund të lidhej në ndonjë mënyrë me sëmundjen apo trajtimin mjekësor të djalit të tij.

Me datë 24 dhjetor 2010 në orën 18:42 R.Z. dërgon një SMS N.M. ku thuhet "I nderuar N., të lutem deri ditën e hënë nuk mund të mbaroj detyrimin. R.Z.".

Me datë 25 dhjetor 2010 në orën 15:38 R.Z. dërgon një SMS N.M. ku thuhet "Z. N., të lutem, nëse je me Dr. ki durim deri të marten, do të mbarojmë obligimin tonë. Do të të sjell whisky për vitin e ri. Përshëndetje edhe Dr. S. R.Z."

Përsëri, konteksti i këtij shkëmbimi është i tillë që gjykata gjen se ky nuk është diskutim lidhur me trajtimin e djalit të N.M.

Shuma prej 20,000 Euro që L.N. i ka dhënë R.Z. duhej të kthehej me apo përpara datës 31 dhjetor 2010. Është bërë marrëveshje që të jepet një afat shtesë për kthimin e parave. Megjithatë këto para nuk janë kthyer kurrë.

L.N. dëshmoi se vëllezërit Z. nuk kanë refuzuar asnjëherë që të kthejnë paratë. Ata thjesht kishin dështuar ta bënë këtë.

L.N. dëshmoi se P.M. i ka thënë atij "Ata na kanë mashtruar". Ai tha "Ata kërkuan paratë për të më kthyer në punën time të mëparshme".

Me datë 5 janar 2011 në orën 19:03 R.Z. ka dërguar një SMS N.M. ku thuhej "N., jam R.Z. A je mirë? A mund të pimë kafe bashkë nesër në X? Përshëndetje R.Z.".

Me datë 6 janar 2011 në orën 16:35 R.Z. ka dërguar një SMS P.M. ku thuhej "Edhe sonte nuk mund ta kryejme punën. Të lutem na kupto".

Me datë 8 janar 2011 në orën 17:25 R.Z. dërgon një SMS N.M. ku thuhej "Faleminderit për ndihmën e madhe që na ke dhënë. E vlerësojmw shumë".

Në janar dhe shkurt të vitit 2011 ka pasur komunikime telefonike të shpeshta mes R.Z., X.Z., P.M. dhe N.M.⁹⁵

Me datë 10 janar 2011 Z.I. ka dërguar një raport⁹⁶ N.M. duke kërkuar prokurorit që të nxjerrë një Aktvendim për Fillim të Hetimeve për vepra penale të pretenduara ku përfshihej P.M.

⁹⁵ (04-12/01/2011, 17-18/01/2011, 27-28/01/2011, 31/01/2011, 02/02/2011, 07-08/02/2011, 12-13/02/2011, 15-16/02/2011, 18/02/2011, 21/02/2011 dhe 25-27/02/2011).

⁹⁶ Faqe 1916 e dosjes së gjykimit.

Mes shtatorit 2010 dhe marsit 2011 S.H. ka punuar si zyrtare ligjore në PSRK. Ajo ka punuar për prokurorë të ndryshëm përfshirë edhe N.M.

Ajo ka punuar në lëndën ku përfshihej ish guvernatori i X. Së bashku me L.Z-M. ajo kishte shqyrtuar lëndën dhe kishte përgatitur një analizë të provave. Sipas mendimit të saj provat ishin të pamjaftueshme për të mbështetur akuzat e propozuara. Raporti i tyre i është dhënë N.M.

S.H. dëshmoi se në shkurt të vitit 2011 ajo kishte përpiluar Aktvendimin për Fillimin e Hetimeve në lëndën kundër P.M. Ajo ka gjetur se kishte prova të mjaftueshme kundër P.M. për të justifikuar nxjerrjen e këtij Aktvendimi.

Me datë 24 shkurt 2011 në lëndën numër PPS 87/10 N.M. ka nxjerrë një Aktvendim për Fillimin e Hetimeve⁹⁷ kundër dy të dyshuarve përfshirë P.M.

Urdhri i datës 24 shkurt 2011 për arrestimin e P.M. është nëshkruar nga N.M.

Me datë 24 shkurt 2011 rreth orës 3 pasdite P.M. ka pranuar një thirrje telefonike nga policia ku ai udhëzohej të paraqitej në një takim me oficerin hetues në orën 10 paradite me datë 28 shkurt 2011. Personi me të cilin ka folur P.M. i ka thënë atij të paraqitej në zyrën e Z.I. Ai nuk ka pranuar fletëthirrje zyrtare.

P.M. dëshmoi se pas pranimit të kësaj telefonate ai ka thirrur R.Z. Të nesërmen ai është takuar me R.Z. dhe X.Z. në X.

⁹⁷ Faqe 1922 e dosjes së gjykimit.

P.M. dëshmoi se kur ai është takuar me R.Z. dhe X.Z. në X me datë 25 shkurt 2011 ata i kanë thënë se atij do ti kërkohet të jepte një deklaratë. Ata i kanë thënë P.M. se ata do të kontaktonin mikun e tyre dhe se do të siguronin "të gjitha informatat". Ata thanë "miku yne nuk do të bëjë asgjë që nuk është mirë për ty". Ai tha se e kishin informuar atë për personat e tjerë që do të intervistoheshin.

Në fakt, provat nga telefonat vertetojnë se me datë 25 shkurt 2011 në orën 16:12, 16:40 dhe 17:50 P.M. ka telefonuar R.Z.. Mes orës 17:43 dhe 17:56 N.M. ka bërë 5 përpjekje për të kontaktuar R.Z. në telefon. Në orën 18:05 R.Z. ka telefonuar N.M..

Me datë 26 shkurt 2011 në orën 08:23 P.M. ka telefonuar R.Z. Në orën 09:40 X.Z. ka telefonuar N.M. Në orën 11:54 N.M. ka telefonuar X.Z. Mes orës 21:00 - 22:00 N.M. ka bërë 4 përpjekje për të kontaktuar R.Z.

Provat nga matja e telefonave tregojnë një vecori në komunikimin mes P.M., R.Z., X.Z. dhe N.M. me datë 25 dhe 26 shkurt 2011.

Me datë 27 shkurt 2011 në orën 09:39 dhe 09:50 R.Z. ka telefonuar P.M.. Në orën 10:21 dhe 21:00 N.M. ka telefonuar R.Z.

Me datë 28 shkurt 2011 P.M. është ekzaminuar në cilësinë e të dyshuarit nga Z.I.⁹⁸. Me këtë rast P.M. është arrestuar.

⁹⁸Page 1948 of the main trial bundle.

Një Aktvendim mbi Mbajtjen e Personit të arrestuar u leshua më 28 Shkurt 2011.⁹⁹

Me 1 Mars 2011 N.M. paraqiti një kerkese qe të Urdherohet Paraburgimi kundër P.M.¹⁰⁰

Me 1 Mars 2011 S.M. mberriu ne Kosovë dhe e udhezoi avokatin T.G. që ta përfaqësoj P.M.¹⁰¹

Me 2 Mars 2011 kishte një seance degjimore para Gjyqtarit të Procedures Paraprake i cili urdhëroi Arrestin Shtëpiak¹⁰² të skadojë me datën 2 Prill 2011.

T.G. dëshmoi se gjate seances se paraburgimit P.M. i kishte thënë "Nuk arsye tjera se pse prokurori publik me mbajti mua". T.G. tha se ai i kishte thënë P.M. të mos e permend këtë tek gjyqtari.

T.G. tha se P.M. i kihste thënë se dikush duke vepruar ne emër të prokurortit kishte këerkuar 50,000 Euro.

Kur T.G. ishte marrë në pyetje ne Prill të 2012-tës ai nuk tha se kush kishte kërkzar 50,000 Euro nga P.M. Sidoçoftë, me vone ne deshmime e tij ai tha se P.M. kishte thënë se nuk i kishte dhëne 50,000 Eurot "këtyre vëllezërve".¹⁰³ Ai tha se edhe pse P.M. i kishte përmendur emrat e dy vëllezërve atij nuk i kujtoheshin emrat e tyre.

Kur ai dha deshmi para kesaj gjykate ai tha se ishin dy vellezrit të cilet kishin kerkuar 50,000 Eurot në emer të prokurorit.

T.G. deshmoi se gjate një pauze të seances se paraburgimit ai bisedoi me N.M. Ai i tha se P.M. kishte deklaruar se " dikush kerkoi para ne emer të Prokurorit Publik". N.M. mohoi të kishte kerkuar para.

T.G. deklaroi se P.M. gjithashtu tha se i kishte dhëne 20,000 Euro dy vellezerve nga Gjakova si hua. P.M. kishte thënë se paratë do të perfundojne ne duart e N.M.

Gjykata e konsideroi T.G. si dehsmitarë i sinqertë dhe i besueshëm.

⁹⁹ Faqe 1937 të dengut të shqyrtimit kryesor.

¹⁰⁰ Faqe 1967 të dengut të shqyrtimit kryesor.

¹⁰¹ Faqe 1966 të dengut të shqyrtimit kryesor.

¹⁰² Faqe 1978 të dengut të shqyrtimit kryesor.

¹⁰³ Fillimi i faqes 7 të procesverbalit të datës 12 Mars 2012.

Prokurori nuk kishte parashtruar ankesë Aktvendimin mbi zevendesimin e paraburgimit me Arrest Shtepiak.

S.M. deshmoi se deri ne Korrik të 2011-tës ai jetonte në X. Ai tha se ishte ne kontakt me familjen e tij në Kosovë per çdo ditë. Ai mbante kontakt me vellaun e tij, P.M. Ai tha se gjate një bisede qe ata kishin P.M. ishte referuar një "iniciative" kunder tij nga ana e N.M. permes vellezerve Z. qe kishte të bente me 50,000 Euro ryshfet ne menyre qe ta bente të "zhdukur" një çështje kunder tij.

S.M. tha se ishte informuar per arrestimin e vellaut të tij me 28 Shkurt 2011 dhe se ai menjëhere udhetoj për Kosovë, duke mberritur me 1 Mars 2011. Ai deshmoi se pas mberritjes ne Prishtinë ai bisedoi me R.Z. permes telefonit. Ai that se iu "falenederua" R.Z. per arrestimin e P.M. dhe se kerkoi kthimin e parave të cilat ai i kishte marrur. R.Z. i tha atij se ishte neX. Ai tha se R.Z. mohoi t1 kishte të bente ndogjë me arrestimin e P.M. Ai tha se do ta kontaktonte N.M.¹⁰⁴

S.M. deshmoi se gjate bisedes se tyre telefonike, R.Z. kerkoi nga ai që ta vazhdoi afatin e fundit për kthimin e huasë ose të " terheq akuzimin". Ata u pajtuan që të takohen kur R.Z. kthehet nga X.

S.M. ishte e pranishem ne gjykate gjatë seances se zevendesimit të Paraburgimit me Arrest Shtepiak. Ai deshmoi se e kishte pare N.M. jashtë gjykatores. Ai tha se e kishte injoruar N.M.. Kjo është një çështje me interes sepse me vone R.Z. iu referua faktit se N.M. ishte ofenduar me faktin se S.M. e kishte injoruar atë jashte gjykatës.

S.M. tha se dy ditë pasi që P.M. ishte liruar ne Arrest Shtepiak ai ishte i pranishem ne një takim ne shtepinë e P.M., ne të cilin, ai, P.M., R.Z. dhe X.Z. ishin të pranishëm. Ai tha se R.Z. i kishte thënë se për shkak të kercnimeve qe ai i kishte bërë R.Z. kur ata folen në fakt ai ishte për tu fajesohej për zgjatjen e paraburgimit të P.M. për 24 ore.

R.Z. deklaroi se N.M. të kishte thënë " pasi qe Sokoli të është kercenuar ty, ai duhet të vuaj edhe 24 ore tjera në arrest".¹⁰⁵ R.Z. tha se N.M. kishte thënë se nëse S.M. do të bënte ndonjë kërcenim tjetër ai do ta arrestonte S.M.

¹⁰⁴ Shih gjithashtu email-in e dërguar nga Sokol Mirashi më 3 Prill 2012 (Faqe 763-768 të dengut të shqyrtimit kryesor).

¹⁰⁵ Fillimi i faqes 30 i procesverbalit të 16 Janarit 2013.

Të ashtuquajturat "kercenime" të cilave R.Z. iu referua ishin kerkesat e bera nga P.M. deh S.M. per kthimin e parave të dhena si kredi.

Kjo deshmi ishte mbeshtetur nga P.M.

Ishte deshmia e tij se gjate takimit qe te dy, edhe R.Z. edhe X.Z. kishin thene se ata ishi udhezuar nga N.M. qe ta njoftojne P.M. se ai do ta permyllte çështjen kunder P.M. per një pagese prej 50,000 Eurosh. Ata thanë se kishin maredhenie të ngushta familjare me N.M. Ata thane se per shkak të shoqërise se tyre ata do të mund ta benin rastin të zhdukej. S.M. tha se R.Z. e kishte permendur djalin e N.M. Ai tha se djali i tij ishte i sëmure dhe se N.M. kishte propozuar ta dergoj atë per sherim në X.

S.M. tha se kishte kerkuar ta takonte N.M. R.Z. tha se N.M. nuk donte ta takonte ate sepse ne fakt ai e kishte ofenduar N.M. duke mos e pershendetur atë kur ata u takuan jashte gjykates dite kur P.M. kishte seancën e tij të paraburgimit. Kjo ishte në perputhje me deshmine e dhëne nga S.M. dhe se verteton jo vetem faktin se R.Z. komunikonte me N.M. porse faktin se ata kishin diskutuar këtë çështje.

S.M. deshmoi se në perfundim të atij takimi ai i tha vellezerve Z. se ai do të shkonte ne X dhe të takohej me avokatët e P.M. Në pergjgjen e tij R.Z. deklaroi se ai dhe X.Z. do të udhetonin per ne X ta takonin N.M. R.Z. propozoi të takoheshin në nje dite te mevonshme ne X. S.M. i dha numrin e telefonit R.Z. Ishte numër telefoni parapagues. Ai mendoi se numri ishte XXX XXX XXX.

S.M. dha deshmi se ai shkoi në X atë ditë kur ai u mor vesh për çmimet e avokatëve. Ai tha se nuk iu kishte thënë avokatëve asgje në lidhje me perfshirjen e vellezerve Z. ose të N.M. per sa i përket veprave të pretenduara.

Deri sa ai ishte në X, ai mori një thirje telefonike nga R.Z. i cili kerkoi që ata të takoheshin. Ata u takuan ne kafene. Ai tha se X.Z. ishte gjithashtu i pranishëm.

Gjatë takimit R.Z. tha se ai biseduar me N.M.n. R.Z. tha " do të shte me mirë sikur ti paguani 50,000 neve ne menyre qe ta bejme të mundur heqjen e rastit ne vend se ti paguani ato para avokatëve".

S.M. deshmoi se P.M. i kishte thënë se ai kishte marrur borxh 20,000 Euro nga L.N. qe tu a ipte vellezerve Z.. Keto para do ti ipeshin N.M. per sherimin e djalit të tij. Ai tha se kjo ishte një kredi e cila do të kthehej nga vellezërit Z. brenda 4 muajve.

Sidoçoftë, ne pergjigje të pyetjes ne lidhje me statusin e 20,000 Eurove nga L.N. , S.M. tha: " *Kjo kishte të bente me zhdukjen e rastit kunder vellait tim, ku paratë nuk do të ktheheshin nga vellezrit Z.*".

Kur ai deshmoi para k[saj gjykate, duke iu referuar shumës prej 20,000 Eurove të dhëna nga L.N. dhe shumës prej 5,000 Eurove të dhëna nga G.H. , ai tha se shuma prej 25,000 Eurove ishte "të mbetej si dhuratë per kthimin e P. ne poziten punuese të tij te meparshme".

Gjykata konstatoi se S.M. ishte deshmitarë i singertë dhe i besueshëm.

Ne lidhje me këte dhe deshmitare të tjere gjykata e pranon se ngjarjet e ndodhura ne këtë çështje kishin ndodhur disa vite me heret. Gjate periudhes së nderhyrjes, deshmitaret ne menyre te pashmangshme kan qene të ndikuar deri ne një masë me atë se çka kanë parë ne televizion, kanë lexuar ne gazeta ose diskutuar me njerëz tjerë. Ky është nje realitet i thjeshtë. Kur vlerësoheshin deshmitare e secilit deshmitarë, gjykata ka veshtruar keta dhe faktorë të tjere.

P.M. deshmoi se një nate gjate kohës se arrestit te tij shtëpiak, R.Z. dhe X.Z. erdhen tek shtëpia e tij dhe ai i ftoi ata ti bashkangjiten për kafe. P.M. iu tha atyre se nuk mund te dilte nga shtëpia per shkak se ai ishte nen arrest shtëpiak. P.M. deshmoi se R.Z. supozoi ti telefonojnë N.M.. R.Z. i tha personit ne lidhje telefonike "jemi në shtëpinë e mikut tonë, a mund ta marrim ate dhe te dalim të pijmë kafe?". Ai nuk mund ta degjonte personin me te cilin R.Z. po bisedonte. R.Z. e informoi atë se ai mund ta linte shtëpine e tij. Ai tha se N.M. i kishte thënë "me tregoni kur të mbaroni". P.M. refuzoi të dilte nga shtëpia me ta së bashku.¹⁰⁶

Disa ditë pas asaj vizite P.M. i telefonoi vellezerve Z. dhe kerkoi nga ai qe ta rregullojne qe ai te jep deklarate tek prokurori. R.Z. e kontaktoi atë dhe i tha se ai do të duhej që formalisht ta bente kerkesen permes avokatit të tij. Ai e bëri

¹⁰⁶ Faqe 17 e Procesverbalit të shqyrtimit kryesor të 5 Dhjetorit 2012.

një gjë të tillë dhe më 13 Prill 2011 ai formalisht pranoi thirrjen nga prokurori.¹⁰⁷

Në Mars të vitit 2011 vëllezërit Z. shkëmbyen biseda telefonike me P.M. dhe N.M. disa herë në ditë.¹⁰⁸

G.H. deshmoi se në Mars të 2011 tës P.M. i telefonoi atij dhe tha " *me duhet të i gjej 5000 Euro menjëherë, ti e din si e kam situatën*".

G.H. dha deshmi se P.M. i tha atij se vellezerit Z. kishin lidhje me prokurorin e çështjes në të cilën ai ishte i ngarkuar. Kur ai deshmoi para kësaj gjykate ai tha se P.M. i kishte thënë se prokurori në fjalë ishte N.M. Sidoçoftë, ai me vone pranoi se ai e kishte degjuar atë emër të ishte p[er]mendur në televizion. Padyshim se kur ai ishte marre ne pyetje nga prokurori në Mars të vitit 2012 ai nuk e kishte permendur prokurorin me emër. Në fakt në atë rast ai kërkoi të dijë nëse ai e kishte dëgjuar emrin e N.M. Në përgjigjen e tij ai tha " *Tingëllon si emër i njohshëm por nuk po më kujtohet*".

Me kalimin e kohës, është e pashmangshme se faktorët e jashtëm do të kenë efekt nderdijësor në logjikën e dëshmimeve të dëshmitareve. Kjo është padyshim me se e vërtete në këtë rast me këtë dhe dëshmitarë tjerë. Gjykata e ka marre parasysh këtë veçori kur i kishte vlerësuar këto prova dhe provat tjera.

Më 10 Mars 2011 në ora 10:31 R.Z. i telefonon P.M.. Në ora 11:09 P.M. i telefonon R.Z. Në ora 11:40 dhe 12:05 R.Z. i telefonon G.H. Në ora 12:20 R.Z. i telefonon P.M.

Më 10 Mars 2011 G.H. i dha R.Z. 5000 Euro para të thata në një pompe benzine në X. G.H. dëshmoi se gjate këtij takimi të shkurte të tyre R.Z. i kishte thënë " *Po mundohem ti ndihmoj P.M. në lidhje arrestin e tij shtëpiak*".

G.H. dëshmoi se gjate takimit R.Z. i tha atij se ai po shkonte në X për një takim me dike ne lidhje me arrestin shtëpiak të P.M. Ai tha se ky person do të ndihmoj rreth arrestit shtëpiak të P.M.. Ai tha se parat ishin për atë qëllim. Ai nuk e kishte përmendur këtë fakt kur ishte marre në pyetje nga prokurori në Mars të vitit 2012.

¹⁰⁷ Faqe 2023 të dengut të shqyrtimit kryesor.

¹⁰⁸ 4-11 Mars 2011 dhe 13-22 Mars 2011.

Ai tha se gjate atij takimi R.Z. permendi "prokurorin". Edhe nje here ai nuk deklaroi nje gjë te tillë kur ai ishte marre ne pyetje nga prokurori ne Mars te vitit 2012.

G.H. dëshmoi se R.Z. ishte për nguti. Kjo mbështetet nga fakti se R.Z. i telefonoi G.H. tri here ne mes orës 11:40 dhe 12:05. Qartë, ai ishte për nguti ta takoj atë dhe ti marr paratë.

G.H. dëshmoi se P.M. i kishte përmendur që të dy, R.Z. dhe X.Z. në lidhje me çështjet në fjalë.

G.H. dëshmoi se në një rast kur ai e vizitonte P.M. ne shtëpinë e tij, edhe R.Z. edhe X.Z. ishin të pranishëm. Ai tha se ata shkuan me ardhjen e tij.

Gjykata konstaton se G.H. ishte një dëshmitar i sigurtë dhe i besueshëm.

Më 11 Mars 2011 P.M. dha një deklaratë Policisë, ne lidhje me përfshirjet e tij me R.Z. dhe X.Z.

Më 24 Mars 2011 N.M. parashtroi kërkesë për vazhdim të Arrestit Shtëpiak për periudhe kohore prej dy muajsh.¹⁰⁹

P.M. dëshmoi se diku në mes 26 dhe 28 Marsit 2011¹¹⁰ ai kishte kontaktuar R.Z. dhe kërkuar që ata të kthejnë borxhet në shume totale prej 28,000 Eurosh para 5 Prillit 2011.

Provat nga matjet telefonike tregojnë se kah fundi i Marsit/ fillimi i Prillit 2011 N.M. , R.Z., X.Z. dhe P.M. kishin kontakte të shpeshta.¹¹¹

Më 31 Mars 2011 avokati T.G. parashtroi ankesë kundër Arrestit Shtëpiak¹¹². Kjo ankesë ishte caktuar nga Gjykata Supreme më 7 Prill 2011 dhe ishte refuzuar.¹¹³

Në pajtim me urdhrin e Gjykatës, më 16 Prill 2011 kishte filluar përgjimi i bisedave telefonike në mes R.Z., X.Z., P.M. dhe N.M.

Më 13 Prill 2011 në çështjen me numër PPS 87/10 P.M. ishte ftuar të paraqitej në zyrat e PSRK-së në ora 10:30 më 19 Prill 2011¹¹⁴ në cilësinë e të pandehurit.

¹⁰⁹ Faqe 1994 të dengut të Shqyrtimit Kryesor.

¹¹⁰ Faqe 19 e Procesverbalit të shqyrtimit kryesor të 5 Dhjetorit 2012.

¹¹¹ Faqe 2004 të dengut të shqyrtimit kryesor.

¹¹² Faqe 2012 të dengut të shqyrtimit kryesor.

¹¹³ Faqe 2014 të dengut të shqyrtimit kryesor.

P.M. dëshmoi se pasi qe ai e mori thirrjen ai e kontaktoi R.Z. dhe e informoi atë për të dhe e pyeti se si do të mund të shkonte kur ai ishte në arrest shtëpiak. Ai tha se ai e thirri R.Z. dhe i thirri që të dy vëllezërit qe të shkojnë dhe ta vizitojnë atë në shtëpinë e tij. Ai tha se ata erdhën aty dhe e rregulluan punën qe ai të shkoj në zyrën e PSRK-së pa ardhur policia. Ai tha se për këtë vëllezërit Z. kërkuan një "kompensim" shtese prej 5000 eurove.¹¹⁵

Pasi qe kishte dhënë deklaratën para policisë mbi zbulimin e rrjedhave të ngjarjeve qe përfshijnë vëllezërit Z., pas konsultimit me Policinë, ishin pajtuar qe P.M. do ta kontaktonte R.Z. me një oferte financiare.

Më 16 Prill 2011 në ora 13:43-13:44 P.M. thirri X.Z.

P.M.: *"Vëllai im S. më thirre mbrëmë dhe më tha se i ka paratë e gatshme. Mendova se ju do vini në shtëpinë time në mënyre qene do të mund të bisedonim për diçka". "Duhet ta zgjedhim këtë çështje siç edhe kemi folur". "Në rregull, do të takohemi dhe flasim".*

Gjate kësaj bisede P.M. shtiret sikur dëshiron të paguaj paratë në mënyre " që të zgjedhën disa gjëra".

Në ora 14:10-14:11 R.Z. thërret N.M.

R.Z.: *"A mund të qëndroj në Prizren më gjatë? "Me thoni kohen se kur ju dëshironi që të vij unë"*

N.M. : *"Rreth 6-7" .*

Duke marrë parasysh kohën e këtyre bisedave telefonike , Gjykata gjen se takimi i propozuar në mes R.Z. dhe N.M. ishte thjesht për qëllim të diskutimit të ofertës së bërë nga P.M. gjate bisedës telefonike me X.Z.

Kjo mbështetet nga fakti se në ora 14:41-14:42 X.Z. thirri P.M.

X.Z.: *" Veç sa fola me shokun dhe u pajtuam që të takohemi. Ma së pari po shkoj unë atje e mandej kur të kthehem do të të thërras". Me mirë të flasim me të për shkak se i japim me pak kohe e më shpejtë".*

¹¹⁴ Faqe 2023 të dengut të shqyrtimit kryesor

¹¹⁵ Faqe 17 të Procesverbalit të shqyrtimit kryesor të 5 Dhjetorit 2012

Edhe ai na duhet gjithashtu por ne gjithashtu do ti themi për ty konkretisht". Edhe R.Z.i po vjen".

P.M.: *Është me rëndësi që të zgjedhën problemet."*
Eja këtu për 5 minuta".

Kjo strukture e komunikimit përsëritet gjate shumicës se provave të matjeve së komunikimeve. P.M. do të fliste me X.Z. dhe kjo bisede do të pasonte me një thirrje telefonike në mes të R.Z. dhe N.M. dhe anasjelltas.

"Shoku" të cilit R.Z. i referohet është N.M.. Në të vërtetë, ai iu referua takimit të cilin sapo e aranzhoi me N.M..

Është shumë e qarte nga ajo bisede se që të dy edhe X.Z. edhe R.Z. do të merrnin pjese në atë takim me N.M.. Për me tepër, është prape dëshmuar sistemi i komunikimit në mes të R.Z., X.Z., P.M. dhe N.M.. Rolet plotësuese të luajtura nga R.Z. dhe X.Z. janë teme e qëndrueshme e kësaj skeme.

Më 17 Prill 2011 në ora 16:35 P.M. thërret X.Z. Në ora 18:46 X.Z. thërret N.M.. Në ora 20:18 P.M. thërret X.Z. dhe i thotë "I pashë T. dhe e thirra që të vijë të flasim". Unë vetëm se u brengosa (per atë punën tonë?). Gjate bisedës X.Z. tha: "e kam thirrur dhe ne ish dashur të flasim edhe një here nesër. Ne folëm". Ne u pajtuam për atë gjë, ajo gjë u rregullua".

Në ora 20:24 -20:25 X.Z. thërret P.M.

X.Z.: "A i ke thënë T. për ne dhe për atë se çka ne të kemi thënë?" Për atë gjë". Nëse ai e merr vesh ne humbin por humb edhe ti." Është katastrofe për shkak se ai është shumë i ndjeshëm".

P.M.: "Jo o burrë". "Ne jemi marrë vesh për atë punë, kuptohet".

Gjykata gjen se referimi me "T." gjate kësaj bisede ka të bëjë me T.G. Është e qarte nga ky shkëmbim bisedash se X.Z. është e merakosur se P.M. ka mund ta informoj T.G. për bisedat e tyre, dhe mundësisht ti vë ata në dukje para procedurës penale.

Më 19 Prill 2011, deri sa ishte në arrest shtëpiak, P.M. udhëtoi me veturën e tij pa përcjellje të policisë në zyrën e T.G. dhe nga aty ata së bashku shkuan në zyrën e N.M.

T.G. deklaroi se ishte i befasuar kur P.M. se mbërriju në zyrën e tij pa përcjellje. Ai tha se i kishte thënë P.M. se ai

mund të arrestohej për shkak të shkeljes së kushteve të arrestit shtëpiak. Si përgjigje P.M. i tha atij: *"mos e ke dert, është rregullua kjo çështje"*. Me sa duket P.M. gjithashtu i kishte thënë atij se ishte prokurori ai që " e ka rregullua këtë çështje" për shkak se kur ai dëshmoi në Prill të 2012-tës tha se ai e kishte përkujtuar P.M. se është Gjyqtari i Procedurës Paraprake i cili e ka urdhëruar Arrestin Shtëpiak e jo prokurori.

T.G. dhe P.M. shkuan bashkë te zyra e prokurorit. Ata hynë në ndërtesë në ora 10:25. Intervista zgjati nga ora 11:00 deri në ora 13:15. P.M. dhe T.G. u larguan nga ndërtesa e PSRK-së në ora 13:25.

Kur ai u mor në pyetje nga prokurori në Prill të 2012-tës T.G. dëshmoi se N.M. nuk u dukte të jetë i befasuar se P.M. erdhi aty pa përcjelljen e policisë.¹¹⁶ Në të vërtete kur ai mor në pyetje nga prokurori më 19 Prill 2012 N.M. ishte pyetur nëse i e kishte autorizuar P.M. të shkoje në zyrat e tij pa përcjellje të policisë. Ai u përgjigj : *"Mendoj se po, e kam autorizuar, por nuk jam i sigurve"*.¹¹⁷

Gjatë intervistës N.M. mori një telefonatë. P.M. e kishte dëgjuar N.M. të ketë thënë *"Këtu është ky. Gjithçka është në rregull"*. P.M. tha se ai supozonte se N.M. ishte duke folur ose me R.Z. apo X.Z.

P.M. dëshmoi se gjate atij takimi N.M. e kishte pyetur *"si janë shokët tanë?"*

Ajo dëshmi është në përputhje me dëshminë e dhënë nga T.G. i cili tha gjate dëshmisë se tij se pasi që intervista mbaroi N.M. e pyeti P.M. për dy vëllezër. Kur ai dha dëshminë e tij në Prill të 2012-tës T.G. deklaroi se P.M. u përgjigj "në mënyrë ironike" se ata ishin mirë. T.G. nuk i kujtohej nëse P.M. i kishte përmendur emrat e këtyre "vëllezërve".

Pasi që P.M. u largua nga zyrat e SPRK-së më 19 Prill 2011 në ora 17:33 ai e thirri R.Z.. Në ora 17:40 X.Z. e thirri P.M. Biseda zgjati për rreth 1 minute.

P.M. tha: *"Unë isha atje, dhe ai me priti mirë, dhe premtoi se do ta paraqes kërkesën sot por nuk e di nëse a ka paraqitur kërkesën apo vetëm se premtoi se*

¹¹⁶ Procesverbali i marrjes në pyetje të datës 11 Prill 2012.

¹¹⁷ Faqe 23 e procesverbalit të datës 19 Prill 2012.

do ta bëje këtë kërkesën për ndërprerjen e paraburgimit. Nuk e di se çka do të bëjë ai."

X.Z.: *"Më vjen mirë që të ka pritur mirë" Ne po vijmë në Pejë".*

Në ora 19:26 X.Z. edhe një here e thërret P.M.. Në ora 20:12 R.Z. e thërret N.M.

R.Z.: *"Si është djali?" Unë jam në x. A mund të vijë?"*

N.M. i përgjigjet: *"Eja".*

Në ora 21:30 R.Z. e thërret prapë N.M.

R.Z. Z.: *"Jam te dera".*

N.M.: *"Ja po dal"*

Përafërsisht gjysmë ore pas bisedës telefonike, në ora 22:07 X.Z. thërret P.M.

X.Z.: *"Vetëm se desha me të thënë se u krye dhe mbaroi. " Për të tjerët do të shohim por asgjë nuk është e nevojshme në këtë drejtim". Ai e kishte dorëzuar sot. Ai tha se i kishte shkruar dhe se nesër shkon në vend të vetin".*

P.M.: *"Faleminderit shumë"*

Në Prill të 2011-tës në ora 15:37 R.Z. thirri N.M.

Më 22 Prill 2011 në ora 17:12 P.M. thirri X.Z.

Me 23 Prill 2011 P.M. thirri X.Z. 3 herë.

Më 24 Prill 2011 në ora 19:36-19:36 X.Z. thirri N.M.

X.Z.: *"Një shok i yni ka një dasmë nesër, a mund të shkoi ai?" A e ke shikuar a jo? Mere. Mbaroje punën."*

"Shoku" të cilit i referohet X.Z. është P.M.

Është interesante se gjatë kësaj dhe bisedave të tjera telefonike në mes të R.Z., X.Z. dhe N.M., referencë i është bërë thjesht "shokut". Secili nga ata e dijnë se kujt po i referohet tjetri. Prapë, kjo jep indikacion për shkallën e dijenisë dhe përfshirjes së tyre në këtë skemë.

P.M. ka dëshmuar se ka kontaktuar R.Z.. Të dy, R.Z. dhe X.Z., kanë shkuar në shtëpinë e tij. Gjatë atij takimi ai u ka thënë të mbajnë paratë por të ndërprejnë arrestin shtëpiak.¹¹⁸

Më datën 24 prill 2011, apo pak kohë pas kësaj date, N.M. është pajtuar të parashtrojë një kërkesë për ndërprerje të arrestit shtëpiak. Përputhja kohore është domethënëse sepse vie pas interesimit të X.Z. lidhur me dasmën ku donte të shkonte P.M. dhe është pasuar me komunikime të mëtutjeshme telefonike.

Më 25 prill 2011 P.M. dhe vëllezërit Z. kanë telefonuar njëri-tjetrin 4 herë.

Më 26 prill 2011 N.M. ka parashtuar pranë Gjykatës së Qarkut në x kërkesë për të ndërprerë arrestin shtëpiak kundër P.M.

Më 27 prill 2011 Trupi gjykues ka lëshuar Aktvendim për ndërprerjen e kësaj mase (Nr GJPP 77/11).

Më 28 prill 2011 Aktvendimi për ndërprerjen e arrestit shtëpiak i është dorëzuar PSRK-së.

Më 28 prill 2011 në orën 10:32-10:34 R.Z. i ka telefonuar N.M.

R.Z.: "...Shiko edhe çështjen e djalit të ri sepse ai

¹¹⁸ Faqe 19-20 e procesverbalit nga seanca e shqyrtimit kryesor më 5 dhjetor 2012

dëshiron të shkojë në dasëm'. 'A do të rregullohet?'

N.M.: 'Ok.'

Referenca nga e R.Z. bërë për "çështjen" është referim i qartë urdhrin për ndërprerje të arrestit shtëpiak. P.M. është duke ndjekur urdhrin në mënyrë që të shkojë në dasmën që po afrohej.

Pas kësaj, në orën 10:36-10:38 X.Z. i ka telefonuar P.M.

X.Z.: "...Sapo fola. 'Ajo femra që është dashur që të shqyrtojë atë, ajo nuk ishte këtu' 'Sot ose nesër, por deri në 2.00 definitivisht do të t'a jap'. Sot ose nesër kjo çështje do të kryhet' dhe po ashtu: 'Vetëm desha të të thërras dhe të të them se ai ka telefonuar.'"

Pos dasmës, gjatë kësaj bisede X.Z. ka përmendur çështjen e miellit.

X.Z.: "Ato gjërat e mullirit që i ke në shitje? 'Nëse të gjej blerësin, a do më ndihmosh? Për t'a shitur në x? Ti jep miellin dhe unë rregulloj pak situatën time.'"

P.M.: "Hej njeri aty ka 30 tonë miell (...)"

Në 17:27-17:28 R.Z. ka telefonuar P.M.

R.Z.: "Urime. Nesër do të pijmë kafe. E kam parë, e kanë nënshkruar. Tani prit, dikush do të t'a sjellë në shtëpi'. 'Jam me këtë personin këtu tani, ai tha se e ka dërguar por pyeti nëse mund të t'a dorëzojë nesër në shtëpi. Ai tha se është i lirë.'"

P.M.: 'Ok'

Trupi gjykues gjen se R.Z. i referohej Aktvendimit mbi ndërprerjen e arrestit shtëpiak. Ai thotë se e ka parë "atë". PSRK e ka pranuar Aktvendimin më 28 prill 2011. Nëse, me të vërtetë, e ka parë Aktvendimin ka mundësi që ka qenë N.M. ai i cili ia ka treguar.

Në orën 18:02 X.Z. ka telefonuar P.M.

X.Z.: "Urime!", 'A e morre?"

P.M.: "Ende jo. Kam marrë lajmin por jo edhe letrën".

X.Z. Xherka: "Posa ka dalur nga zyra, por nesër në Oxygen ne paguajmë kafënë e jo ti".

Më 29 prill 2011 P.M. ka marrë aktvendimin nga Gjykata mbi ndërprerjen e arrestit shtëpiak. Në orën 11:39 ai ka telefonuar R.Z.

P.M.: "Sapo e morra tani."

R.Z.: "Urime! Mbrëmë isha i befasuar se përse ai avokat nuk ka marrë më herët. Ai duhet të kujdeset për këtë'. 'Le të shpresojmë se ky nuk është gëzimi i parë. Uroj të vijmë të gjitha gëzimet rend!"

Në vitin 2011 R.Z. dhe X.Z. kanë pranuar rreth 5 tonë miell në vlerë prej rreth 2350 euro. Trupi gjykues gjen se kjo është dobi pasurore në këmbim për faktin që ata kanë mundësuar ndërprerjen e arrestit shtëpiak të caktuar kundër P.M. Duke iu referuar miellit X.Z. ka deklaruar:

"Nëse të gjej blerësin, a do më ndihmosh? Për t'a shitur në X? Ti jep miellin dhe unë rregulloj pak situatën time."

Kur është marrë në pyetje nga prokurori më 17 prill 2012¹¹⁹ R.Z. ka thënë se nuk kishte marrë kurrfarë mielli nga P.M. Megjithatë, kjo dëshmi është kundërshtuar në tërësi nga X.Z. kur ky është marrë në pyetje nga prokurori më 18 prill 2013.¹²⁰

Arrestimi shtëpiak është ndërprerë sipas kërkesës së N.M. para përfundimit të hetimeve.

Një draft i aktakuzës në lëndën kundër P.M. i krijuar më 18 maj 2011 është nxjerrë nga kompjuteri zyrtar i N.M.

Më 4 tetor 2011 N.M. ka nënshkruar Aktvendimin për fillim të hetimeve në lëndën PPS 99/10 kundër L.K. dhe A.L.¹²¹

Më 13 janar 2012 në lëndën PPS numër 02/12 ftesa e gjykatës është nënshkruar nga N.M. për P.M. që të paraqitet në zyret e PSRK-së në orën 10:30 më 2 shkurt 2012¹²² në cilësinë e të pandehurit.

Më 17 janar 2012 është lëshuar Aktvendimi për fillimin e hetimeve¹²³ në lëndën PPS 02/12 i nënshkruar nga N.M. kundër P.M.

Më 27 janar 2012 lënda PPS 02/12 i është transferuar¹²⁴ Prokurorisë së Qarkut.

¹¹⁹ Faqe 7.

¹²⁰ Faqe 20.

¹²¹ Faqe 2946 e dosjes së Shqyrtimit kryesor.

¹²² Faqe 2914 e dosjes së Shqyrtimit kryesor.

¹²³ Faqe 2916 e dosjes së Shqyrtimit kryesor.

¹²⁴ Faqe 2915 e dosjes së Shqyrtimit kryesor.

Më 16 shkurt 2012 P.M. është marrë në pyetje nga Prokurori Publik i Qarkut¹²⁵.

Më 21 mars 2012 Prokurori Publik i Qarkut ka parashtruar Aktvendimin¹²⁶ për ndërprerjen e hetimeve. Në arsyetimin e tij prokurori ka deklaruar se "nuk ka pasur manifestim të elementeve qenësore lidhur me veprat penale për të cilat kishin filluar hetimet".

R.Z. ka qenë drejtori i vetëm i x Impex. Megjithatë, të dy, edhe R.Z. edhe X.Z., kanë qenë aktivisht të përfshirë në aktivitetet ditore të biznesit të dy kanë përfituar financiarisht nga kompania. Megjithatë, siç është thënë më lart, kompania ka qenë në vështirësi të konsiderueshme financiare gjatë kohës kur janë kryer veprat penale në fjalë.

Lënda kundër V.L.t, A.L.t, L.K.

Nga marsi 2009 PSRK-ja ka marrë përsipër hetimet penale që kanë përfshirë pretendime kundër zyrtarë të ndryshëm bankarë, përfshirë A.L. Fillimisht, kjo lëndë i ishte caktuar një prokurori tjetër të PSRK-së. Megjithatë, është pothuajse e pabesueshme që N.M. mos të ketë pasur njohuri lidhur me identitetin e disa zyrtarëve shumë të lartë bankar të cilët kanë qenë të implikuar në këto hetime.

A.Lu., vëllai i A.L., ka dëshmuar se në maj të vitit 2010 N.M. kishte kërkuar nga ai nëse mund të fliste me vëllain e tij lidhur me një kërkesë për kredi që ishte bërë nga vëllezërit Z..

¹²⁵Faqe 2922 e dosjes së shqyrtimit kryesor.

¹²⁶Faqe 2938 e dosjes së shqyrtimit kryesor.

A.Lu. kishte thënë se N.M. i ka përshkruar vëllezërit Z. si të ishin vëllezërit e tij.

Disa ditë pas këtij takimi, pas nxitjes së N.M., A.Lu. ka takuar X.Z. Ai i ka thënë X.Z. se e kishte diskutuar çështjen me vëllain e tij i cili e kishte informuar se kredia nuk mund të aprovohej.

X.Z. ka përshkruar rolin e tij në firmë si të një vozitësi të thjeshtë. Megjithatë, është e qartë se ai ka qenë i përfshirë shumë më shumë në aktivitetet biznesore se sa ka arritur të bindë Trupin gjykues.

Ca kohë pas takimit të tij me X.Z., A.Lu. ka pranuar telefonatë nga N.M. i cili e kishte pyetur se përse nuk ishte aprovuar kredia. A.Lu. ka thënë se kishte shpjeguar arsyet.

Ai ka dëshmuar se N.M. i kishte thënë që, nëse e domosdoshme, ky vetë do të hipotekonte pronën e tij si peng për kredinë.¹²⁷

A.L. ka dëshmuar¹²⁸ se në maj apo qershor të vitit 2010 vëllai i tij A.Lu. e ka pyetur lidhur me kërkesën për kredi që ishte parashtruar nga R.Z. dhe X.Z. Kredia ishte për kompaninë X Impex. A.Lu. i kishte thënë se N.M. e kishte pyetur lidhur me kredinë.

Sipas dëshmive duket se kredia ishte aprovuar nga banka X - dega në X, por aprovimi i mëtejshëm nuk ishte dhënë nga komisioni i kredive i X. A.L. ka thënë se ai kishte informuar vëllezërit Z. lidhur me vendimin e X.

¹²⁷ Procesverbal nga marrja në pyetje më 6 prill 2012.

¹²⁸ Procesverbal i marrjes në pyetje më 13 prill 2012.

Periudha kohore e këtyre diskutimeve lidhur me kredinë është interesante kur shikohet në kontekstin e hapave të ndërmarrë nga N.M. për të marrë përsipër hetimet ku kanë qenë të përfshirë mu ata persona që kanë pasur ndikim në aprovimin zyrtar të këtyre kredive.

Më 23 qershor 2010 N.M. i ka dërguar I.A., në atë kohë Shefe e PSRK-së, një memo të titulluar Informacione mbi veprimet e ndërmarrura në Lëndën PPS 23/09'¹²⁹. Në këtë dokument N.M. ka informuar mbikëqyrësen e tij lidhur me hapat hetues që ishin ndërmarrë tashmë. Ai kishte ardhur në përfundim se duhet të fillohen hetime të ndara kundër të gjithë të dyshuarve që ishin identifikuar në kallëzimet penale të Policisë. Sipas tij, një nga këto lëndë të ndara duhej të ishte lënda kundër V.L., L.K. dhe A.L.

Ky memo ishte dërguar për afërsisht brenda një muaji nga diskutimi në mes të N.M. dhe A.Lu. rreth kërkesës për kredi që në fund nuk ishte aprovuar nga banka në të cilën vëllai i tij, A.L., ishte zyrtar i lartë.

Më 20 korrik 2010 Policia e Kosovës i kishte parashtruar N.M. një Memorandum Zyrtar Nr 017-TFAK/2010¹³⁰. Ky raport përmbante pretendime kundër V.L., L.K. dhe A.L. Kësaj dosjeje i është dhënë numri i lëndës PPS 99/10.

A.G. ka dëshmuar se në mars të vitit 2011 është intervistuar nga policia të cilët po hetonin pretendime për korrupsion në X. Pasi nuk kishte dëgjuar më asgjë lidhur me lëndën, në gusht të vitit 2011 kishte vendosur të kontaktojë prokurorin drejtperdrejtë.

¹²⁹ Faqe 2113 e dosjes së shqyrtimit kryesor.

¹³⁰ Faqe 2117 e dosjes së shqyrtimit kryesor.

A.G. ka shkuar në zyret e PSRK-së dhe ka kërkuar të bisedojë me N.M. I ishte thënë se prokurori nuk ishte në dispozicion. Ai kishte lënë vizit-kartelën e tij por nuk ishte kontaktuar. Prandaj, në shtator të vitit 2011 i ka telefonuar N.M. N.M. i ka thënë se ishte në pushim dhe se do t'a kontaktonte posa të kthehej. Ai nuk e kontaktoi asnjëherë.

V.L. ka dëshmuar se në shtator të vitit 2011 ka pranuar një telefonatë nga M.N. e cila kishte kërkuar takim në Hotel X në X. Duket se nuk ka dashur të takohet në bankë. Ajo kishte thënë se dëshironte të diskutonte një çështje "konfidenciale". V.L. kishte takuar M.N. në të kaluarën.

M.N. ka dëshmuar se ka dashur të informojë V.L. se X kishte fituar procesin e ofertimit. Kjo zor se mund të quhet çështje 'konfidenciale'. Është e qartë se ajo donte të takohej me qëllim të diskutonte diçka për të cilën hezitonte t'a bëjë në zyrën e tij.

V.L. ka dëshmuar se kur janë takuar ajo i është referuar hetimeve penale aktuale kundër tij dhe zyrtarëve të tjerë të X.

Kur është marrë në pyetje nga prokurori M.N. ka mohuar të ketë diskutuar me V.L. çfarëdo hetime penale.

Nuk kontestohet fakti që N.M. dhe M.N. kanë pasur një marrëdhënie të ngushtë. M.N. e ka përshkruar marrëdhënien e tyre si "intime".

Është e vërtetë se kundër V.L. dhe zyrtarëve të tjerë bankarë hetimet penale ishin në vazhdim e sipër. N.M. ishte prokuror në këtë lëndë. Trupi gjykues gjen se N.M. i kishte treguar asaj lidhur me faktin për hetimet dhe identitetin e disa apo

gjithë të dyshuarve.

V.L. ka dëshmuar se gjatë takimit të tyre M.N. ka sugjeruar që V.L. të kontaktojë A.G. dhe t'i thotë atij që mos t'a kontaktojë N.M.

Kur u intervistua M.N. nga ana e prokurorit dëshmia e saj ka qenë se ajo "kurrë nuk ka qenë në dijeni për ekzistimin e A.G.". Kjo ishte gënjeshtër. Dëshminë që e ka dhënë V.L. lidhur me këtë përputhet me dëshminë e N.M. Kur N.M. është marrë në pyetje më 10 korrik 2012 ai është pyetur nga prokurori nëse e kishte informuar ndonjëherë M.N. lidhur me faktin që A.G. është munduar t'a kontaktojë. Ai është përgjigjitur duke thënë "...E kam pyetur atë nëse i kishte thënë A. të më telefonojë..." Ai ka thënë se ka menduar që ajo mund t'a njihte. Ai ka thënë se ka kërkuar nga M.N. t'i thotë A.G. mos t'a kontaktojë.

M.N. ka gënjyer kur ka thënë se kurrë nuk kishte dëgjuar për A.G.. Ajo e ka përmendur A.G. me emër dhe faktin që ai është përpjekur të kontaktojë N.M. me qëllim që të bind V.L. për marrëdhënien e saj me N.M.

Në të vërtetë, M.N. disa herë ka deklaruar se ka një marrëdhënie shumë të mirë me N.M. Kjo nuk ishte vënë asnjëherë nën dyshim. Ajo ka thënë se për shkak të marrëdhënies së saj me N.M. ajo mund të "mbyllë lëndën".

Gjasat janë të vogla që V.L. ka qenë në dijeni për marrëdhënien në mes të M.N. dhe N.M., pos nëse ajo i ka treguar.

V.L. ka deklaruar se gjatë takimit me M.N. ajo kishte përmendur se N.M. po punonte me një prokuror gjerman. Kjo

ishte e saktë. Ky informacion ka konfirmuar afërsinë e marrëdhënies së saj me N.M. Ajo nuk do ishte në dijeni lidhur me këtë fakt nëse N.M. nuk do t'i kishte treguar. Në të vërtetë, ka pak gjasa që V.L. do të ishte në dijeni mbi këtë fakt.

M.N. i ka sugjeruar V.L.t se ai dhe "shokët" e tij të shkojnë në X për të "përfunduar punën". Sipas tij ata do të takonin M.N. në X. V.L. ka thënë se M.N. nuk ka përmendur emra specifikisht por, duke pasur parasysh temën e diskutimit të tyre, ai e ka kuptuar këtë si referencë A.L. dhe L.K. Ai ka refuzuar të bashkëpunojë me të.

Gjatë takimit të tyre M.N. nuk ka përmendur ndonjë shumë specifike parash.

A.L. ka dëshmuar se në shtator të vitit 2010 zyrtarë të policisë e kanë intervistuar në zyrën e tij në X. Në tetor të vitit 2010 ai ka pranuar një telefonatë nga policia ku është kërkuar nga ai të paraqitet në stacion policor për të dhënë deklaratë. Pas kësaj ai kishte dhënë deklaratë në cilësi të dëshmitarit.

L.K. ka dëshmuar se në apo rreth shtatorit të vitit 2011 V.L. i kishte treguar për takimin që kishte pasur me M.N. V.L. i kishte thënë se M.N. i ishte referuar një prokurori nga X. M.N. i kishte thënë V.L. t'i thotë A.G. që mos të kontaktojë N.M. M.N. ka ftuar V.L. dhe A.G. të takojnë atë dhe N.M. në X me qëllim që të "ndërprehen" hetimet.

Ai ka thënë se përshtypja e tij ka qenë se hetimet do të ndërpreheshin në këmbim të një dobie pasurore. Ai ka thënë se V.L. nuk i është referuar ndonjë shumë specifike parash të jetë përmendur. Kur është intervistuar në prill të vitit 2012

ai nuk ka përmendur para ose, në të vërtetë, ndonjë dobi pasurore. Në fakt, kur me atë rast është pyetur nga prokurori nëse ishte përmendur ndonjë përfitim specifik ai ka thënë "Nuk jam i sigurtë". Kur ka dëshmuar para Trupit gjykues dhe është ballafaquar me këtë mospërputhje ai ka thënë se thjesht ka supozuar se do të ketë një shpërblim financiar për ndërprerjen e procedurës. Në të vërtetë, ai në mënyrë paksa imagjinative ka thënë "ata nuk po shkonin në X në skijim!"

Përafërsisht brenda një muaji nga takimi në mes të M.N. dhe V.L., më 4 tetor 2011 N.M. ka lëshuar Aktvendimin për fillim të hetimeve në lëndën me numër PPS 99/10 kundër V.L., A.L. dhe L.K. ku ata ishin të dyshuar për kryerje të veprave penale të Shpërdorimit të detyrës dhe autorizimit zyrtar (neni 339 i KPK) dhe Përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës (neni 340 i KPK).

Kallëzimi i fundit penal në këtë lëndë i ishte parashtruar PSRK-së më 20 korrik 2010. Prandaj, pasi kishte pritur më shumë se 1 vit para se të lëshonte Aktvendimin mbi fillimin e hetimeve, brenda një muaji të takimit në mes të M.N. dhe V.L. në Hotel X N.M. lëshoi Aktvendimin mbi fillimin e hetimeve.

A.L. ka dëshmuar se kishte takuar N.M. në nëntor të vitit 2010. Ai ka kërkuar nga N.M. të udhëzojë një ekspert financiar të shqyrtojë transaksionet financiare të X. Gjatë bisedës N.M. i kishte thënë A.L., *"Unë kam urdhër-arrestin për ty të cilin e kam poseduar në kohën kur është arrestuar H.R., edhe pse kam qenë nën presion të të arrestoj edhe ty por nuk e kam bërë këtë për shkak të konsideratës që kam për familjen tënde"*¹³¹

A.L. ka thënë se disa muaj pas diskutimit të tij në maj të vitit 2010 me N.M.n ai është takuar me N.M.n i cili, duke iu

¹³¹Procesverbal i marrjes në pyetje më 13 prill 2012

referuar çështjes lidhur me kredinë, ka thënë se nuk ka qenë në dijeni se në atë kohë A.L. ishte nën hetime.

A.Lu. ka dëshmuar¹³² se ka takuar N.M. më 17 korrik 2011. Gjatë atij takimi A.Lu. ka pyetur N.M. lidhur me hetimet ku ishte i përfshirë vëllai i tij. N.M. i ka thënë se mund të arrestonte A.L. por për shkak të respektit që kishte për familjen e tij nuk e kishte bërë këtë.

A.Lu. ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me presionin që po ndiente se po ushtrohej ndaj vëllait të tij dhe ftoi N.M.n ose të akuzojë vëllain e tij ose të pushojë hetimet.

A.Lu. ka dëshmuar se në apo rreth tetorit të vitit 2011 V.L. ka shkuar në zyrën e tij dhe i ka treguar për takimin e tij me M.N. në Hotel X. V.L. i kishte thënë atij se dukej që M.N. dinte gjithçka lidhur me lëndën. Ajo i ishte referuar A.G. por A.Lu.t nuk i ishte kujtuar konteksti. V.L. i kishte thënë atij se M.N. i kishte treguar vizit-kartelën e zyrtarit policor zviceran apo gjerman që po punonte me N.M. Ajo kishte sugjeruar të takoheshin në Zvicër me qëllim që të diskutojnë se si të mbyllet "lënda". V.L. i ka thënë se ndoshta do të jetë e nevojshme të jepen para për të ndërprerë hetimet kundër A.L.t, A.G. dhe L.K.

A.Lu. ka dëshmuar se ka raportuar këtë çështje te Kryeprokurori I.K. brenda disa ditësh nga takimi i tij me V.L.n.

A.G. ka thënë se ka biseduar me V.L.n i cili i kishte treguar për takimin e tij me M.N. e cila kishte kërkuar nga V.L. t'i thotë A.G. që mos të kontaktojë N.M. V.L. i kishte thënë atij

¹³² Faqe 4 e intervistës me prokurorin më 6 prill 2012 (Faqe 431 e dosjes së shqyrtimit kryesor).

se M.N. kishte sugjeruar të takoheshin në Zvicër.

Duke iu referuar takimit të propozuar në Zvicër A.G. ka thënë se sipas tij N.M. do të ishte i pranishëm me qëllim të diskutimit mbi ndërprerjen e hetimeve në këmbim të dobisë pasurore.¹³³

A.G. dhe V.L. kanë diskutuar nëse duhet të shkonin në Zvicër. A.G. ka thënë se ata janë pajtuar se nuk duhet të hynin në asnjë marrëveshje me prokurorin.

Më 2 dhjetor 2011 N.M. ka lëshuar Aktvendimin mbi fillimin e hetimeve në lëndën me numër PPS 65/10 kundër V.L., A.L. dhe L.K.

Kallëzimi penal në këtë lëndë ishte parashtruar pranë PSRK-së më 28 maj 2010. Prokurori ka pritur më shumë se një vit e gjysmë para se të lëshojë Aktvendimin mbi fillimin e hetimeve për afërsisht brenda një muaji nga takimi në mes të M.N. dhe V.L. në Hotel X.

Më 11 shkurt 2012 V.L. ka dëshmuar se në shkurt të vitit 2012 ai është ftuar në zyret e PSRK-së. Ai ishte marrë në pyetje nga N.M. në mars të vitit 2012.

B.B. ka dëshmuar lidhur me rastin kur kishte shoqëruar N.M. në restaurantin X. Ai ka përshkruar se si ishte ulur në tavolinë me N.M., F.S. dhe personin që e njohte si L. Nuk i kujtohej emri i tij. Ai ka thënë se gjatë bisedës së tyre Z. L. i është referuar vëllait të tij i cili punonte në bankë.

Ai ka thënë se dy apo tre ditë pas këtij takimi A.L. ka shkuar

¹³³ Faqe 4 e procesverbalit të intervistës me prokurorin më 28 qershor 2012 (Faqe 628 e dosjes së shqyrtimit kryesor)

në zyret e PSRK-së dhe ka biseduar shkurt me N.M. i cili i kishte thënë se nuk kishin për çfarë të bisedonin. Ai ka thënë se nuk i kujtohet të ketë parë ndonjë dokument në duart e N.M. Ai ka thënë se A.L. nuk ka qenë fyes apo kërcënues në asnjë mënyrë.

B.B. ka dëshmuar se në vjeshtë të vitit 2011 ka qenë me N.M. kur ky i fundit ka pranuar një telefonatë nga njëri nga vëllezërit Z. Nuk e ka ditur se cili nga vëllezërit kishte qenë. Ai ka thënë se i njëjti e ka thirrur dy herë. N.M. i ka thënë B.B. se vëllezërit kishin kërkuar ndihmën e tij lidhur me një kompani. N.M. ka takuar vëllezërit diku në mes të X dhe X. Ai ka thënë se ai mendonte se ishin në vështirësi. Ai asnjëherë nuk i kishte dëgjuar të përmendin P.M.

B.B. ka dëshmuar se N.M. i kishte thënë se vëllezërit Z. kishin ofruar t'i ndihmojnë në trajtimin e djalit të tij.

Sipas dëshmisë së tij N.M. ka takuar M.N. disa herë në prani të tij. N.M. i kishte thënë se ajo ishte mikeshë. Ai ka shoqëruar N.M. kur ky kishte takuar M.N. në Hotel X apo X. Duket se shumica e takimeve kishin ndodhur në X. Atij nuk i kujtohet nëse M.N. kishte ardhur në zyren e N.M.

Trupi gjykues ka gjetur se V.L., L.K., A.L., A.Lu. dhe A.G. janë dëshmitarë të singertë, të besueshëm. Të gjithë ata ishin profesionistë të respektuar të cilët kanë lënë përshtypje te Trupi gjykues me mënyrën e qartë, të logjikshme dhe të qëndrueshme të dhënies së dëshmisë.

IX. GJETJET MBI PËRGJEGJËSINË E TË AKUZUARIT

Lidhur me Pikat 1 dhe 2 kundër N.M.; pika 2 kundër R.Z. dhe X.Z. dhe pika e vetme kundër M.N., Trupi gjykues ka gjetur se dënimet e parapara në Kodin e ri Penal të Republikës së Kosovës janë më të favorshme për të pandehurit.

Prandaj, në pajtim me nenin 3 të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës, gjatë shqiptimit të dënimeve ndaj të pandehurve, Trupi gjykues i referohet neneve relevante të KPRK.

1. N.M.

Pika 1

Në mes të qershorit 2010 dhe 27 prill 2011 në Prishtinë, N.M., gjatë tërë kohës materiale prokuror i Prokurorisë Speciale së Republikës së Kosovës, duke vepruar në cilësi të personit zyrtar, në lëndën me numër PPS 87/10, hetime që kanë përfshirë P.M.n, ka shfrytëzuar pozitën dhe autoritetin e tij zyrtar, dhe në këtë mënyrë ka tejkaluar kufinj të autorizimeve të tij, me qëllim të përfitimit të paligjshëm të dobisë pasurore në shumë prej 50,000 euros për vete, R.Z. R.Z. dhe X.Z. R.Z., ka ofruar të ndërprejë hetimet në lëndën me numër PPS 87/10 kundër P.M., ka siguruar ndërprerjen e arrestit shtëpiak kundër P.M. dhe i ka zbuluar R.Z. dhe X.Z. informacione të besueshme nga lënda me numër PPS 87/10 duke i mundësuar në këtë mënyrë R.Z. dhe X.Z. të zhvatin nga P.M. dobi pasurore në shumë prej 30,250 euro dhe gjatë kësaj edhe më tej ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare duke i lejuar P.M.it të largohet nga adresa ku ai po banonte në atë kohë nën kushtet e caktuara sipas Aktvendimit mbi arrestin shtëpiak, në shkelje të kushteve të këtij Aktvendimi.

NË KËTË MËNYRË ka kryer veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nën nenin 3 (2) dhe nenit 422 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje "KPRK")¹³⁴.

N.M. ka portretizuar veten si viktimë në këtë lëndë. Ai është shtirë se ishte kurthuar nga persona të fuqishëm të cilët, sipas tij, ishin ose nën hetime nga ai apo të lidhur me persona të tillë. Ky pohim thjesht nuk bazohet në prova.

Në rastin ku përfshihet P.M., vëllezërit Z. kanë qenë miq të tij. N.M. u ka ndihmuar gjatë vështirësive të tyre financiare. Ai madje kishte ofruar të vëjë pronën e tij si peng në kërkesën e tyre për kredi të bërë në emër të R.Z. Impex. Në të vërtetë, është e qartë sipas provave se N.M., R.Z. dhe X.Z. në fakt kanë sajuar skemën. Ata nuk ishin viktimat. Larg nga kjo.

Më tej, nëse kjo do të ishte një përpjekje nga persona të panjohur për të fabrikuar prova kundër N.M. supozohet se P.M. do të ishte pjesë e kesaj skeme. Nëse ka qenë, kur ka dhënë dëshmi lidhur me takimet apo bisedat telefonike që ai ka thënë se ka pasur me N.M.n, përse P.M. thjesht nuk ka deklaruar se N.M. ka kërkuar para?

Modus operandi në rastin e P.M. ka qenë shumë i ngjashëm me atë që është përdorur në rastin e V.L.t. N.M. ka përdorur ndërmjetësit për të kontaktuar të dyshuarit në hetimet e tij me qëllim të zhvatjes së parave nga ata.

Trupi gjykues ka gjetur prova të qarta se R.Z. dhe X.Z. kanë pranuar dobi pasurore në shumë totale prej 30,250 euro. Asnjë provë bindëse nuk është paraqitur përpara Trupit gjykues se

¹³⁴ Ligji me numër 04/L - 082 në fuqi prej datës 1 janar 2013.

N.M. ka pranuar ndonjë pjesë të këtyre parave. Megjithatë, Trupi gjykues gjen se ai në mënyrë të tërthortë ka kërkuar para në këmbim të ndërmarrjes apo mos-ndërmarrjes së veprimeve në hetimet penale që ishin në vazhdim e sipër.

Pika 2

Para 11 shtatorit 2011 N.M., gjatë tërë kohës material prokuror i Prokurorisë Speciale së Republikës së Kosovës, duke vepruar në cilësi të personit zyrtar, me qëllim të përfitimit të paligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare dhe autoritetin kur i ka zbuluar M.N. informacione zyrtare nga dosja e lëndës me numër PPS 99/10, lidhur me hetimet ku kanë qenë të përfshirë V.L., A.L. dhe L.K. dhe më tej i ka zbuluar M.N. informacione zyrtare nga dosja e lëndës me numër PPS 65/10, lidhur me hetime ku kanë qenë të përfshirë V.L. dhe A.G., me qëllim që M.N. të kontaktojë të dyshuarit në këto hetime, ku pas kësaj ajo ka kontaktuar V.L. dhe, sipas udhëzimeve të tij, ka ofruar të ndërprejë hetimet në këmbim të pagesës së një shume të paspecifikuar dhe të pacaktuar të parave nga ana e tyre.

PRANDAJ ai ka kryer veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 3 (2) të KPRK dhe nenit 339 (1) të KPK.

Megjithatë, përpara Trupit gjykues nuk është paraqitur asnjë provë që dëshmon se, kur M.N. ka takuar V.L. në Hotel X, ajo ka kërkuar në emer të N.M. ndonjë shumë të caktuar parash. Prandaj, ligji më i favorshëm është neni 339 (1) i KPK (Kodi i vjetër).

C. Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve

Rreth orës 18:00h më 2 prill 2012 në rr. Nenë Tereza, Nr. 164, në Prizren, ai ka qenë në posedim të paligjshëm të pistoletës 'Crvena Zastava', modeli M-70 me kalibër 7.65 x 17mm pa numër serik, një karikator me 8 fishekë të kalibrit 7.65 x 17mm dhe një fisheku tjetër të kalibrit 7.65 x 17mm, për të cilën nuk ka pasur Leje të vlefshme për mbajtje të armës siç kërkohet me ligj¹³⁵.

PRANDAJ ai ka kryer veprën penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armës sipas nenit 3 (2) dhe nenit 374 (1) të KPRK.

Akuza 1

Nga qershori 2010 deri në 27 prill 2011, në Prishtinë dhe Gjakovë, R.Z., duke vepruar në bashkëkryerje me X.Z. R.Z., kërkoi nga P.M. një përfitim të padrejtë në shumën e 50,000 eurove dhe mori një fitim pasuror në shumën e përgjithshme prej 30,250 eurosh, përfshirë një pagesë prej 20,000 eurosh nga L.N., 3,000 euro nga P.M., 5,000 euro nga G.H. dhe nga P.M. një sasi të madhe mielli që realizoi një vlerë shitjeje me pakicë prej 2,350 eurosh, të gjitha në këmbim të ushtrimit të ndikimit të parregullt nga R.Z. dhe X.Z. lidhur me vendim-marrjen e N.M., prokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe person zyrtar, me qëllimin për të arritur në emër të P.M. ndërprerjen e paraburgimit që ishte caktuar nga gjykata ndaj P.M., si dhe ndërprerjen e hetimit kundër P.M., në lëndën numër PPS 87/10; për ta rikthyer P.M.n në pozitën e tij të mëparshme si Likuidator në X në X dhe, më tej, për ta

¹³⁵ Ligji Nr. 03/L-143.

lejuar P.M. të largohet nga vendi ku ai po banonte sipas kushteve të vendosura në një aktvendim për arrestin shtëpiak.

ME ÇKA ai kreu veprën penale të Ushtrimit të Ndikimit, nga Neni 3 (2) i KPRK-së dhe Neni 345 (1), lidhur me Nenin 23, të KPK-së.

Akuza 2

Nga qershori 2010 deri në 27 prill 2011, në Prishtinë dhe Gjakovë, R.Z., duke vepruar në bashkëkryerje me X.Z. R.Z., e nxiti qëllimisht N.M., prokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe person zyrtar, të kryente veprën e Shpërdorimit të Pozitës ose Autoritetit Zyrtar, nëpërmjet së cilës i përmenduri N.M. përfitoi nga pozita dhe autoriteti zyrtar i tij duke i tejkaluar në këtë mënyrë kufijtë e autorizimeve të tij, me synimin për të siguruar një fitim pasuror të paligjshëm në shumën e 50,000 eurove për veten e tij, R.Z. R.Z. dhe X.Z. R.Z., në mënyrë të tillë që, brenda kuadrit të hetimit të tij në lëndën numër PPS 87/10, ai siguroi ndërprerjen e paraburgimit të caktuar ndaj P.M.; ofroi të ndërpriste hetimin në fjalë; i zbuloi R.Z. dhe X.Z. informacion konfidencial nga shkresat e lëndës, duke i mundësuar në këtë mënyrë R.Z. dhe X.Z. të zhvatin nga P.M. një fitim pasuror të paligjshëm në shumën e 30,250 eurove dhe duke i mundësuar P.M. të largohet nga vendi ku ai po banonte sipas kushteve të vendosura në një aktvendim për arrestin shtëpiak.

ME ÇKA ai kreu veprën penale të Nxitjes së Shpërdorimit të Pozitës dhe Autoritetit Zyrtar, nga Neni 3 (2) dhe Neni 422 (1), lidhur me Nenet 31 dhe 32 (1), të KPRK-së.

3. X.Z.

Akuza 1

Nga qershori 2010 deri në 27 prill 2011, në Prishtinë dhe Gjakovë, X.Z., duke vepruar në bashkëkryerje me R.Z. R.Z., kërkoi nga P.M. një përfitim të padrejtë në shumën e 50,000 eurove dhe mori një fitim pasuror në shumën e përgjithshme prej 30,250 eurosh, përfshirë një pagesë prej 20,000 eurosh nga L.N., 3,000 euro nga P.M., 5,000 euro nga G.H. dhe nga P.M. një sasi të madhe mielli që realizoi një vlerë shitjeje me pakicë prej 2,350 eurosh, të gjitha në këmbim të ushtrimit të ndikimit të parregullt nga X.Z. dhe R.Z. lidhur me vendimarrjen e N.M., prokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe person zyrtar, me qëllimin për të arritur në emër të të përmendurit P.M. ndërprerjen e paraburgimit që ishte caktuar nga gjykata ndaj P.M., si dhe ndërprerjen e hetimit kundër P.M. në lëndën numër PPS 87/10; rikthimin e P.M. në pozitën e tij të mëparshme si Likuidator në X në X dhe, më tej, për ta lejuar P.M. të largohet nga vendi ku ai po banonte sipas kushteve të vendosura në një aktvendim për arrestin shtëpiak.

ME ÇKA ai kreu veprën penale të Ushtrimit të Ndikimit, nga Neni 3 (2) i KPRK-së dhe Neni 345 (1), lidhur me Nenin 23, të KPK-së.

Akuza 2

Nga qershori 2010 deri në 27 prill 2011, në Prishtinë dhe Gjakovë, X.Z., duke vepruar në bashkëkryerje me R.Z. R.Z., e nxiti qëllimisht N.M., prokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe person zyrtar, të kryente veprën e Shpërdorimit të Pozitës ose Autoritetit Zyrtar, nëpërmjet së

cilës i përmenduri N.M. përfitoi nga pozita dhe autoriteti zyrtar i tij duke i tejkaluar në këtë mënyrë kufijtë e autorizimeve të tij, me synimin për të siguruar një fitim pasuror të paligjshëm në shumën e 50,000 eurove për veten e tij, X.Z. R.Z. dhe R.Z. R.Z., shpërdoroi pozitën zyrtare të tij në mënyrë të tillë që, në kuadrit të hetimit të tij në lëndën numër PPS 87/10, siguroi ndërprerjen e paraburgimit të caktuar ndaj P.M.; ofroi të ndërpriste hetimet; i zbuloi X.Z. dhe R.Z. informacion konfidencial nga shkresat e lëndës, duke u mundësuar në këtë mënyrë X.Z. dhe R.Z. të zhvatin nga P.M. një fitim pasuror të paligjshëm në shumën e 30,250 eurove dhe duke i mundësuar P.M. të largohet nga vendi ku ai po banonte sipas kushteve të vendosura në një aktvendim për arrestin shtëpiak.

ME ÇKA ai kreu veprën penale të Nxitjes së Shpërdorimit të Pozitës dhe Autoritetit Zyrtar, nga Neni 3 (2) dhe Neni 422 (1), lidhur me Nenet 31 dhe 32 (1), të KPRK-së.

X.Z. e portretizoi veten si punonjës i thjeshtë i R.Z. Impex. Ai ishte çdo gjë tjetër përveç kësaj. Ai ishte përfshirë qartazi në punët e biznesit, madje mori pjesë edhe në një takim për të diskutuar kërkesën për kredi të bërë në emër të R.Z. Impex.

Përballë këtyre provave, roli i X.Z. në këtë skemë dukej më pak i rëndësishëm kundrejt atij të R.Z. Megjithatë, gjykata gjen se pjesëmarrja e tij në skemën e përgjithshme ishte faktor i ndjeshëm në zhvatjen e parave nga P.M. dhe kjo demonstron nga pjesëmarrja e tij në takime dhe komunikime të ndryshme telefonike.

4. M.N.

Më 11 shtator 2011 në Hotel X në Prishtinë, ajo e ndihmoi qëllimisht N.M., prokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të kryente veprën penale të shpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar, në mënyrë të tillë që i përmenduri N.M., ndërsa vepronte në cilësinë e personit zyrtar, me synimin për të siguruar një fitim pasuror të paligjshëm për veten e tij, shpërdoroi pozitën dhe autoritetin zyrtar të tij në mënyrë të tillë që ai i zbuloi M.N. të dhëna zyrtare nga shkresat e lëndës numër PPS 99/10, një hetim që përfshinte V.L., A.L. dhe L.K. dhe, më tej, i zbuloi M.N. të dhëna zyrtare nga shkresat e lëndës numër PPS 65/10, një hetim që përfshinte V.L., A.G. (dhe të tjerë), në të cilën ai ra dakord me M.N. që kjo e fundit të kontaktonte me të dyshuarit në këto hetime dhe, me udhëzimet e tij, ofroi të ndërpriste hetimet përkatëse në këmbim të përfitimit pasuror, ku pasi ajo kontaktoi me V.L., person të cilin ajo e njihte, e informoi atë për hetimet dhe i sugjeroi që ai dhe të dyshuarit e tjerë ta takonin atë në Zvicër ku, në këmbim të pagesës së një shume parash të paspecifikuar dhe të papërcaktuar, N.M. do të ndërpriste hetimin në fjalë kundër tyre, duke lejuar në këtë mënyrë që N.M. të kryente veprën penale.

ME ÇKA ajo kreu veprën penale të Ndhmës në Shpërdorimin e Pozitës ose Autoritetit Zyrtar, nga Neni 3 (2) i KPRK-së dhe Neni 339 (1), lidhur me Nenin 25, të KPK-së.

X. DËNIMI

Në lidhje me akuzat 1 dhe 2 kundër N.M.; akuzën 2 kundër R.Z. dhe X.Z., dhe akuzën e vetme kundër M.N., gjykata e gjen masën e dënimit në Kodin e ri Penal të Republikës së Kosovës më të favorshme për të pandehurit.

Për rrjedhojë, në bazë të Nenit 3 të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës, gjykata vendosi regjimin e ri të dënimit nga Kodi i ri lidhur me veprat.

1. N.M.

Në të gjitha kohët materiale ai ishte prokuror, i cili mbante një post të lartë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Ai ishte në pozitë besimi. Ai e shpërdoroi këtë besim për përfitim të vet pasuror. Veprimet e tij shërbyen për të minuar rëndë besimin në administrimin e drejtësisë.

Gjykata gjen se i pandehuri jo vetëm ishte i përgatitur të ndërpriste hetimet penale për përfitim të vet personal, por ai zbatoi hetime penale kundër personave ndaj të cilëve ai e dinte se kishte pak prova materiale.

Në gjykatë nuk u paraqit asnjë provë që të provonte se ai, në fakt, mori ndonjë përfitim financiar apo pasuror.

Dënime të mëparshme nuk ka.

Ka bashkëshorten dhe tre fëmijë. Provat sugjerojnë se djali i tij vuan nga autizmi.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor u soll në mënyrë shembullore.

2. R.Z.

Ai mori nga ose në emër të P.M. një fitim pasuror të paligjshëm në shumën e përgjithshme prej 30,250 eurosh.

Ai është drejtor i R.Z.i Impex. Arrestimi dhe burgosja e tij më pas do të kishte në mënyrë të pashmangshme pasoja të rënda dëmtuese në atë biznes.

Është i martuar, ka dy fëmijë.

Nuk ka dënime të mëparshme.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor ai tregoi përbuzje të plotë për gjykatën, policinë dhe oficerët e burgut dhe administrimin e drejtësisë. Ai ishte pengues gjatë procedurës dhe në disa raste e larguan nga salla.

3. X.Z.

Ai mori nga ose në emër të P.M. një fitim pasuror të paligjshëm në shumën e përgjithshme prej 30,250 eurosh.

Është i martuar, ka tre fëmijë.

Nuk ka dënime të mëparshme.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor ai tregoi përbuzje të plotë për gjykatën, policinë dhe oficerët e burgut dhe administrimin e drejtësisë. Ai ishte pengues gjatë procedurës dhe në disa raste e larguan nga salla.

4. M.N.

Asnjë provë nuk u paraqit në gjykatë se e pandehura kërkoi apo mori ndonjë përfitim pasuror për veten e saj.

Ajo i përshkroi marrëdhëniet e saj me N.M.n si "intime". Nga përshkrimi i tij i marrëdhënieve të tyre, ishte e qartë se ajo

ishte, deri-diku, e varur emocionalisht prej tij. Gjykata gjen se ai kishte pozitë ndikimi mbi të dhe e përdori këtë në përfitim të tij.

Ka tre fëmijë.

Nuk ka dënime të mëparshme.

Ajo i tregoi gjykatës se, si pasojë e kësaj procedure penale, ajo e kishte humbur punën.

Ajo punon në industrinë e shërbimeve financiare. Një dënim i kësaj natyre do të kishte pasoja të rënda dëmtuese në mundësitë e punësimit të saj në të ardhmen.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor u soll në mënyrë shembullore.

XI. PËRJASHTIMI NGA DETYRA

Në të gjitha kohët materiale, N.M. ishte prokuror, i cili mbante një post të lartë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Ai ishte në pozitë besimi. Ai e shpërdoroi këtë besim për përfitim të vet pasuror. Veprimet e tij shërbyen për të minuar rëndë besimin në administrimin e drejtësisë.

Prandaj, në bazë të Nenit 56 (2) të KPK-së, N.M. i ndalohej të ushtrojë ndonjë funksion në administratën publike ose në shërbimin publik për një periudhë tre vjeçare pasi të jetë vuajtur dënimi me burgim i caktuar me këtë Aktgjykim.

XII. KONFISKIMI I ASETEVE

Më 2 prill 2012, gjatë një kontrolli të pronave të zëna nga R.Z. dhe X.Z., policia sekuestroi sendet e renditura në

Shtojcën III më poshtë. Në një aktvendim të datës 17 dhjetor 2012, kjo Gjykatë shpalli që këto sende t'i ktheheshin R.Z. dhe X.Z. Prokurori bëri ankesë për këtë.

Në Aktvendimin e saj të datës 24 janar 2013, Gjykata e Apelit e miratoi ankesën e prokurorit.

Për këtë arsye, bazuar në Aktvendimin në fjalë të Gjykatës së Apelit, bazuar në Nenin 493 të KPPK-së, sendet 1 (një) deri në 14 (katërmbëdhjetë) dhe 24 (njëzet e katër) përfshirë këtë të fundit, që u sekuestruan gjatë kontrollit të shtëpisë së R.Z. dhe X.Z. më 2 prill 2012, mund të realizohen për të përmbushur përfitimin e paligjshëm pasuror që u sigurua nga R.Z. dhe X.Z.

XIII. KONFISKIMI I ARMËVE TË ZJARRIT

Gjatë një kontrolli të shtëpisë së N.M. në [adresse], më 2 prill 2012, ai u gjet se ishte në posedim të paligjshëm të një pistolete 'Crvena Zastava', model M-70, e kalibrit 7.65 x 17mm, me numër serik, për të cilën ai nuk zotëronte Kartë Autorizimi për Armëmbajtje, siç kërkohet me ligj, një krehër me 8 fishekë të kalibrit 7.65 x 17mm dhe një plumb i vetëm i kalibrit 7.65 x 17mm.

Për këtë arsye, ai kreu veprën penale të pronësisë, kontrollit, posedimit ose përdorimit pa leje të armëve, nga Neni 374 (1) i KPRK-së.

N.M. i tregoi gjykatës se, para se të vinte në posedim të tij, arma kishte qenë e babait të tij. Ai e përshkroi armën si trofe. Ai tha se ia dorëzoi vullnetarisht armën policisë gjatë kontrollit.

XIV. SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Bazuar në Nenin 102 (1) të KPPK-së, të pandehurit detyrohen të paguajnë shpenzimet e procedurës në shumën që do të përcaktohet nga gjykata në një aktvendim të veçantë.

XV. PALËT E DËMTUARA

Palët e dëmtuara mund të ushtrojnë kërkesë-padi për dëmshpërblim përmes gjykatave civile.

Për arsyet e shpallura këtu, Gjkata jep këtë Aktgjykim.

Sot më datë 23 maj 2013.

Gjyqtari Malcolm Simmons
Kryetar i trupit gjykues

Gjyqtari Darius Sielicki

Gjyqtarja Elmaze Syka

Proces- mbajtëse
Christine Sengl

MJET LIGJOR: Bazuar në Nenin 398 (1) të KPPK-së, personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita që u dorëzohet kopja e këtij Aktgjykimi. Ankesa duhet të ushtrohet me shkrim përmes Gjykatës Themelore të Pejës për Gjykatën e Apelit të Kosovës.

SHTOJCA I

Gjykata dëgjoi këta dëshmitarë:

P.M.
V.L.
L.N.
G.H.
S.K.
L.Z-M.
S.H.
S.M.
T.G.
A.Lu.
A.G.
L.K.
A.L.
P.P.
B.B.

SHTOJCA II

	Deklaratat e të pandehurve	Numri i faqeve
1	Deklarata e N.M. - 19/04/12	1-49
2	Deklarata e N.M. - 10/07/12	50-96
3	Deklarata e R.Z. - 17/04/12	97-137
4	Deklarata e R.Z. - 03/07/12	138-173
5	Deklarata e X.Z. - 18/04/12	174-226

6	Deklarata e X.Z. - 05/07/12	227-256
7	Deklarata e M.N. - 12/07/12	257-276

	<i>Dëshmitarët</i>	
8	Deklarata e P.M. dhënë në Polici - 11/03/11	277-290
9	Deklarata e P.M. dhënë në Polici - 15/04/11	291-299
10	Deklarata e P.M. dhënë prokurorit - 01/02/12	300-337
11	Deklarata e dëshmitarit bashkëpunues e P.M. (kopje) - 22/05/12 bashkë me deklaratën e tij të dhënë sipas Nenit 298 § 3 KPPK	338-369
12	Deklarata e L.N. dhënë prokurorit - 23/03/2012	370-383
13	Deklarata e G.H. dhënë prokurorit - 26/03/12 (me dokumentet bashkëngjitur - shih Listën e Provave Nr. 31 dhe 32)	384-397
14	Deklarata e S.K. dhënë prokurorit - 27/03/12 (me kopjen e dokumentin bashkëngjitur - shih Listën e Provave Nr. 33)	398-413
15	Deklarata e L.Z-M. dhënë prokurorit - 27/03/12	414-430
16	Deklarata e A.Lu. dhënë prokurorit - 06/04/2012	431-446
17	Deklarata e S.H. dhënë prokurorit - 10/04/12	447-466
18	Deklarata e S.M. dhënë prokurorit - 10/04/12	467-485
19	Deklarata e T.G. dhënë prokurorit - 11/04/12	486-508
20	Deklarata e V.L. dhënë prokurorit - 12/04/12	509-529
21	Deklarata e A.L. dhënë prokurorit - 13/04/12	530-553
22	Deklarata e L.K. dhënë prokurorit - 24/04/12	554-571
23	Ballafaqimi ndërmjet V.L. dhe M.N., i datës 29/05/12	594-624
24	Deklarata e A.G. dhënë prokurorit - 28/06/12	625-644

25	Aktvendimet për fillimin dhe zgjerimin e hetimeve, të datave 10/02/2012, 27/03/2012, 12/04/2012, 25/06/2012 dhe 02/07/2012	657-716
----	--	---------

26	Memorandum zyrtar i policisë lidhur me ankesën e P.M., i datës 11/03/11	717-722
27	Kërkesë e P.M. drejtuar Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe Kryeprokurorit të EULEX-it për të marrë lëndën dhe për të përjashtuar N.M. nga lënda PPS. 87/10 i datës 05/10/11	723-728
28	Kërkesë për përjashtimin e N.M., e paraqitur nga A.L., L.K. dhe V.L., e datës 13/02/12	729-734
29	Faturë e përpiluar për G.H. nga R.Z., e datës 10/03/11, në shumën 5000 euro	735-736
30	Pasqyrë bankare e Raiffeisen Bank që vërteton tërheqjet e datës 10/03/11 të bëra nga G.H.	737
31	2 faqe nga blloku i shënimeve i S.K., të datave 20/09/10 dhe 28/03/2012	738-739
32	Dokumentet lidhur me huan/overdraftin prej 3000 eurosh që P.M. mori nga Bank X. më 10/09/10	740-762
33	E-mail i S.M., datë 03/04/12, lidhur me lëndën	763-768
34	Memorandum Zyrtar i datës 23/03/12 bashkë me CD-të (4 - 'Raporti Final') - përmbajtja e nxjerrë nga mobilët që i përkasin X.Z.;	769-777
	<ul style="list-style-type: none"> - NOKIA 7250 - që përmban numrat e N.M., P.M., R.Z. dhe S.M. në bllokun e adresave; - NOKIA 6230i - që përmban numrat e N.M. dhe P.M. në bllokun e adresave dhe foto të N.M. dhe djalit të tij) 	
35.	4 fotografi të N.M. dhe djali të tij të nxjerra nga mobili NOKIA 6230i që i përket X.Z.	778-781
36	Raporti i Ekzaminimit të Provave, datë 14/06/12, bashkë me CD-të (5 - 'Raporti Forensik për Kompjuterët') - përmbajtja e nxjerrë nga pajisjet IT; kompjuteri Acer Power F5, që i përket PSRK-së dhe i përdorur nga N.M.	782-790
	<ul style="list-style-type: none"> - mobili SAMSUNG C5212, që i përket N.M. (që përmban numrat e M.N. dhe R.Z. në bllokun e adresave dhe gjithashtu disa mesazhe SMS rtë shkëmbyera me M.N. në vitin 2012) - mobili NOKIA 1202 që i përket X.Z. 	

	(që përmban numrat e N.M. dhe P.M. në bllokun e adresave dhe gjithashtu një thirrje për N.M.N më 2 prill 2011, 12:14) Gjithashtu: shënimi i Prokurorit të EULEX-it për përmbajtjen e këtij kompjuteri dhe pajisjeve të tjera IT, datë 21/06/12	
37	Listat e lëndëve të kryera në PSRK nga N.M.	791-795
38	Regjistri i hyrjeve në ndërtesën e PSRK-së, i dhënë nga Policia e Kosovës	796-814
39	Regjistri i hyrjeve në ndërtesën e PSRK-së, i dhënë nga 'EURO-SEC'	815-821
40	Memorandum i Agjencisë Mjekoligjore të Kosovës lidhur me pistoletën 'Crvena Zastava', model M-70, e sekuestruar nga N.M.	822-823
41	Kontroll i shtëpisë së R.Z. dhe X.Z. më 15/02/12, përfshirë kërkesën e prokurorit (kopje), urdhrin e gjykatës, proces-verbalin e kontrollit (përfshirë fotot), memorandumet e policisë	940-993
42	Vërtetim për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, datë 20/02/12: Nokia 7250 (plus SIM kartelën), Nokia 6230 (plus SIM kartelën),	994-997
43	Kontroll i shtëpisë së N.M. më 02/04/12, përfshirë kërkesën e prokurorit, urdhrin e gjykatës, proces-verbalin e kontrollit, memorandumet e policisë (plus fotot) pistoletën me fishekë, një fishek veçan, bileta avioni, pasaportën, dokumentin për pistoletën	998-1138
44	Kontroll i shtëpisë së R.Z. dhe X.Z. më 02/04/12 përfshirë kërkesën e prokurorit, urdhrin e gjykatës, proces-verbalin e kontrollit, memorandumet e policisë	1140-1195
45	Kontroll i zyrës më PSRK të N.M. më 12/04/12, përfshirë kërkesën e prokurorit, urdhrin e gjykatës, proces-verbalin e kontrollit, memorandumet e policisë, 1 biletë avioni e Malësia Reisen, letër-njoftimin e N.M., shkresat e lëndës PPS 87/10, kompjuterin Acer Power F5	1202-1301
46	Pasaporta e N.M. [Nr.]	1302
47	Letër-njoftimi i N.M. [Nr.]	1303 (N7)

48	1 biletë avioni e Malësia Reisen, e datës 16/12/11, Prishtinë-Zurich dhe 5 bileta avioni të përdorura	1304 (EV. D#6)
49	Dokumentet e datës 16/08/99 lidhur me pistoletën e N.M.	1305 (EV. D#4)
50	Përgjimi i mesazheve SMS të R.Z., X.Z., N.M. dhe P.M. në periudhën 01/06/10 - 01/04/11, bashkë me kërkesën e prokurorit dhe urdhrin e Gjyqtarit të procedurës-paraprake (përfshirë CD-të)	1306-1390
51	Regjistrimet telefonike të mobilëve të N.M., R.Z., X.Z. dhe P.M. në periudhën 01/06/10 - 01/04/11 bashkë me kërkesën e prokurorit dhe urdhrin e Gjyqtarit të procedurës-paraprake (përfshirë CD-të)	1391-1673
52	Përgjimi i telekomunikimeve të telefonave të R.Z. dhe X.Z. në periudhën 16/04/11 - 24/04/11 bashkë me kërkesën e prokurorit dhe urdhrin e Gjyqtarit të procedurës-paraprake	1674-1763
53	Rrotull letre që përmban analizën e komunikimeve telefonike ndërmjet N.M., X.Z., R.Z. dhe P.M. në periudhën 01/06/10 - 01/04/11	Bashkëngjitur to files of lënda separately
54	Dokumentet (e nxjerra nga 'dosja e gjelbër' e ZHERKËS) që demonstrojnë problemet financiare të R.Z. ZHERKËS, X.Z. dhe kompanisë së tyre 'R.Z.i Impex': - dokumentet lidhur me kreditë e Raiffeisen Bank - dokumentet lidhur me kreditë e marra nga persona privatë	1764-1900
55	Dokumente të përzgjedhura nga lënda PPS 87/2010, e kryer nga N.M. kundër P.M.: - Kallëzimi penal i Liman Bekës - Vendim i Kryetarit të PSRK-së për marrjen e lëndës nga DPPPO Prishtinë, datë 23/09/10 - Konfirmimi i dorëzimit të vendimit të Kryetarit të PSRK-së - Memorandum zyrtar i policisë, datë 10/01/11 - AFH i datës 24/02/11 kundër P.M. - Autorizimi për të arrestuar P.M.N, datë 24/02/11	1901-2053

	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumentet e policisë lidhur me arrestimin e P.M. - Deklarata e të pandehurit e P.M., datë 28/02/11 - Autorizimi i S.M., datë 02/03/11 - Kërkesa për të urdhëruar paraburgimin e P.M., datë 01/03/10 - Aktvendimi i GJQ Prishtinë për arrestin shtëpiak të P.M., datë 02/03/11 - Letra shtesë e Liman Bekës për Policinë, datë 02/03/11 - Letra Lënieje në besim të N.M., datë 18/03/11 dhe 22/03/11 - Propozim për vazhdimin e arrestit shtëpiak, datë 24/03/11 - Aktvendim i GJQ Prishtinë për vazhdimin e arrestit shtëpiak, datë 31/03/11 - Ankesa e T.G.T, datë 04/04/11 - Aktvendim i Gjykatës Supreme, datë 07/04/11 - Kërkesa e T.G.t për të ndërprerë arrestin shtëpiak, datë 11/04/11 - Fletëthirrja e P.M., datë 13/04/11 - Proces-verbal i dëgjimit të të pandehurit (P.M.), datë 19/04/11 - Kërkesa e N.M. për të ndërprerë arrestin shtëpiak, datë 26/04/11 - Aktvendim i GJQ Prishtinë për të ndërprerë arrestin shtëpiak, datë 27/04/11 - Parashtresë tjetër e Limand Bekës drejtuar PSRK-së më 16/05/11 - Letër Lënieje në besim të N.M., datë 25/05/11 	
56	<p>Dokumente të përzgjedhura nga lënda PPS 64/2010 të kryer nga N.M. kundër H.R. dhe të tjerët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ankesë anonime e datës nëntor 2008 - Ankesë anonime e paraqitur më 19/03/08 	2054-2162

	<ul style="list-style-type: none"> - Memorandum zyrtar i policisë, datë 23/03/09 - Memorandum zyrtar i policisë, datë 27/03/09 - Letër Lënieje në Besim e I.A., datë 12/05/10 (Lënda Nr. PPS 23/09) - Informacion për veprimet që duhen ndërmarrë në lëndën PPS 23/09, datë 23/06/10 - Memorandum zyrtar i policisë, datë 20/07/10 - Memorandum zyrtar i policisë, datë 13/08/10 - AFH i lëshuar nga N.M., datë 21/07/10 - Fletëthirrja e P.M., datë 06/09/10 	
57	<p>Dokumente të përzgjedhura nga lënda PPS 65/2010 të kryer nga N.M. kundër A.G. dhe të tjerët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kallëzimi penal i policisë, datë 28/05/10 - AFH i datës 02/12/11 	2163-2913
58	<p>Dokumente të përzgjedhura nga lënda PPS 02/2012, e kryer nga N.M. kundër P.M.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fletëthirrja e P.M., datë 13/01/12 - Vendim i Kryetarit të PSRK-së për ta transferuar lëndën nga N.M. tek PQ Prishtinë, datë 27/01/12 	2914-2915
59	<p>Dokumente të përzgjedhura nga lënda PPS 68-2/2012 të kryer nga N.M. kundër H.R.T dhe të tjerëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aktvendim për Fillimin e Hetimeve, datë 17/01/12 - Proces-verbal i marrjes në pyetje të të pandehurit P.M., datë 16/02/12 - Aktvendimi për Ndërprerjen e Hetimit i datës 21/03/12 	2916-2945
60	<p>Dokumente të përzgjedhura nga lënda PPS 99/2010 të kryer nga N.M. kundër V.L. e të tjerët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - AFH, datë 04/10/2011 	2946-2953

Deklaratat e marra nga prokurori, por nuk është mbështetur në to:

M.M.
Z.I.
Dr. M.R.
S.M.
S.Ma.
F.S.
L.Z.
Rr.A.

I. Prova relevante për lëndën, por që nuk janë bashkëngjitur për shkak të vëllimit të tyre

1.	Dy dosje që përmbajnë të gjitha mesazhet SMS dhe thirrjet telefonike të shkëmbyera ndërmjet N.M., R.Z., X.Z. dhe P.M.	
2.	Shkresat e lëndës Nr. PPS 68-2/2012 të kryer nga N.M. kundër H.R.T dhe të tjerët	
3.	Shkresat e lëndës PPS 87/2010 të kryer nga N.M. kundër P.M.	
4.	'Dosja e gjelbër' e konfiskuar përkohësisht nga 'R.Z.i Impex', që përmban dokumente që kanë të bëjnë (ndër të tjera) me gjendjen financiare të kësaj kompanie, R.Z. dhe X.Z.	

II. Ekspozite relevante për lëndën, por që nuk janë bashkëngjitur (të ruajtura në polici ose dhomën e provave të prokurorit)

5.	Mobil NOKIA 7250 i R.Z. me SIM kartelë VALA	E#1 dhe E#1.1
6.	Mobil NOKIA 6230i i X.Z. me SIM kartelë Plus	E#3 dhe E#3.1
7.	Kompjuter Acer Power F5 i N.M.	EV.
8.	Mobil SAMSUNG C5212 që i përket N.M.	EV
9.	Mobil NOKIA 1202 që i përket X.Z.	EV.
10.	Pistoletë 'Crvena Zastava', model M-70, kalibri 7.65x17 mm bashkë me një krehër me kapacitet 8 fishekë, dhe 8 fishekë	EV. D#1

	kalibri 7.65x17 mm	
11	Plumb i vetëm pistolete 7.65x17mm	EV. D#3

1	Dokumente të kalimeve të kufirit të R.Z. dhe X.Z. në mars 2011	
2	Dokumente të kalimeve të kufirit të R.Z., X.Z. dhe N.M. gjatë periudhave 1 shtator - 1 tetor 2010, 1 - 31 mars 2011 dhe 1 prill - 31 shtator 2011.	
3	Dy dosje të prokurorit që përmbajnë shkresa bankare, CD-të lidhur me R.Z. R.Z., X.Z. R.Z./R.Z.i Impex	Dosjet I dhe II të të dhënave bankare

1	Evidenca lidhur me vizitat e M.N. në zyrat e PSRK-së	
---	--	--

SHTOJCA III

1. 1 Printer 'Canon'
2. 1 Furrë me mikrovalë (numri serik FAB -10916)
3. 3 sete muzikore 'Delux' (numri serik 080503426C)
4. 1 tastierë 'Shadow' (numri serik MM 935)
5. 1 monitor 'Samsung' (numri serik LXB531TL)
6. 1 makinë larje të teshave 'Beko'
7. 1 televizor 'Panasonic'
8. 1 televizor 'Elkos'
9. 1 enë elektrike gatimi
10. Kompjuter Dell Optiplex GX260, numri serik J63FS0J
11. Kompjuter HP DC7100, numri serik CZC4502SJK
12. 1 mi kompjuteri, monitor, tastierë
13. 3 kuti cigare 'Boss'
14. Një furrë me mikrovalë 'Gorenje'
15. Veturë e X.Z. - Audi B5, [me targa]